

Hëna e Re

Revistë kulturore informative islame



TURQIA GJITHMONË E GATSHME TË NDIHMOJË BFI-në




ISLAMI, NË BETEJA TË NJËPASNJËSHME KUNDËR TË PAVËRTETËS (BATILIT)

14



PRONA TË KTHEHET ME URGJENCË

24




BFIM FTON GRUEVSKIN TË VIZITOJË ÇARSHI-XHAMINË

27



PROBLEMI I DIALOGËVE TË PAFRYTSHËM MIDIS MËSUESIT DHE NXËNËSIT (II)

39



Kur flet funksionari i shtetit Maqedonia po i diskriminon muslimanët

Ditë më parë, drejtorja e Komisionit të Marrëdhënieve me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze të Qeverisë së RM, me vetëdije a pa të, publikisht e zbuloi strategjinë e pushtetit aktual ndaj kërkesave të Bashkësisë Fetare Islame, respektivisht e bëri publik qëndrimin diskriminues ndaj popullatës muslimane në vend.

Çudi, por e vërtetë: strategjia për padrejtësitë ndaj komuniteteve fetare, pikërisht ndaj muslimanëve, vjen nga një funksionar i cili më së shumti duhet të angazhohet që bashkësitë fetare të kenë trajtim të barabartë, jo vetëm në letër, por edhe në praktikë, të angazhohet që në mënyrë të njëjtë t'u kthehet pasuria e nacionalizuar, në mënyrë të njëjtë t'u jepet leja për ndërtimin e objekteve fetare, në mënyrë të njëjtë t'u ndihmohet, etj.

Por, mesazhi i këtij funksionari ishte krejtësisht ndryshe. Nga ajo kuptuam se në të ardhmen, kuptohet "ligjërisht", pronësia e objekteve fetare që kanë status të trashëgimisë historiko-kulturore do t'u merreshka bashkësive fetare (lexojmë: Bashkësisë Fetare Islame), për t'i kaluar, definitivisht, në pronësi shtetit. Kjo, nga shkakku se shteti na paskësh investuar! Po, ama, shtrohet pyetja: ku i mori shteti paratë? E qartë është: nga tatimet e qytatarëve të këtij vendi, pothuajse gjysma e të cilëve janë të përkatësisë muslimane. Me këtë, shteti do të bëjë nacionalizim të ri të pronës së vakëfit, sidomos kur është fjala për komplekset siç është Kapan-Han, Arabati Baba Teqe dhe shumë objekte të tjera të kulturës islame, që janë vakëf i BFI-së.

Zvarritja e denacionalizimit të pronës së vakëfit nuk paraqet elementin e vetëm të diskriminimit të popullatës muslimane në këtë shoqëri. Mosdhënia e lejës për të ndërtuar Burmal-Xhaminë në sheshin e Shkupit, Xhaminë e Çarshisë në Prilep, xhaminë në f. Llazhec të Manastirit, përdhosja sistematike e vakëfit nga ana e pushteteve lokale në Maqedoninë lindore, janë edhe një argument i pamohueshëm se muslimanët në këtë shoqëri po diskriminohen ashiqare.

Aspak nuk pijnë ujë arsyetimet se muslimanët në Maqedoni kanë shumë të drejta në krahasim me muslimanët e disa shteteve evropiane, ngase muslimanët në këtë vend janë autoktonë, janë në shtëpi të tyre, ku gjithnjë po u ngushtohet hapësira në të gjitha segmentet e jetës, edhe atë në mënyrë sistematike.

Nisur nga kjo, çfarë kuptimi ka pjesëmarrja e muslimanëve në pushtet, kur nuk janë të aftë ta mbrojnë vetveten dhe ta mbrojnë popullatën muslimane, e cila njëherit është elektorat i tyre, nga zullumi i shtetit? Çfarë kuptimi ka pjesëmarrja e BFI-së nëpër konferenca për dialog ndërfaqet, kur fare nuk përfillen kërkesat e saj, kur në krahasim me bashkësinë tjetër simotër disfavorizohet, vetëm se ajo i mbron interesat e popullatës muslimane?!



Hëna e re

REVISTË MUJORE
INFORMATIVE
KULTURORE ISLAME



Botues:
Rijaseti i BFI në RM



Kryeredaktor:
Abaz Islami

Redaktor përgjegjës:
Shaban Aziri

Redaksia:

Skender Buzaku
Abas Jahja
Ibrahim Idrizi
Qufli Osmani
Shaban Sulejmani
Ismet Osmani
Driton Dikena
Agron Vojnika



Bashkëpunëtorë:
Valbona Zunçe
Rejhan Neziri



Redaktimi gjuhësor:
Nazif Zejnullahu



Redaktor teknik:
Halil Berisha



Telefonat e Redaksisë:
02 3117 410; 02 3117 412



www.bim.org.mk
e-mail:bim@bim.org.mk
www.henaere.bim.org.mk
e-mail: hena@bim.org.mk



Dorëshkrimet dhe
fotografitë nuk kthehen

Përmbajtja



**BFI NUK LEJON
TË JETË E
DISKRIMINUAR**

6



**PAQJA,
SYNIM I TË
GJITHËVE**

8



**STOP POLITIKËS
DISKRIMINUESE
DHE ISLAMOFUBE**

10



**SHKAQET E
NDARJES DHE
COPËTIMIT TË
BOTËS ISLAME (II)**

28




**A JETOJMË
PËR
ISLAMIN?**

48

- 7 NUK HEQIM DORË NGA XHAMIA BURMALI
- 9 VEPRA TË BËNË TË JESHË GJITHMONË I GJALLË
- 11 TURQIA GJITHMONË ËSHTË E GATSHME TË NDIHMONË BFI
- 12 NJERIU QË MËSOI ME SYTË E ZEMRËS
- 22 PENGUESI E VAZHDON PENGIMIN E DENACIONALIZIMIT
- 30 EDUKIMI I INDIVIDIT FILLON QË NË FOSHNJËRI
- 33 RRUGA SHPIRTËRORE E NJERIUT
- 35 MOS IU AFRO IMORALITETIT!
- 37 QËLLIME DHE DOBI PËR ÇDO KOHË
- 41 MI'RAXHIJE
- 42 FJALË TË URTA NGA LLUKMAN HAKIMI
- 44 BURIMET E BUHARIUT NË LIBRIN "MENAKIB EL-ENSAR"
- 50 SHQIPTARËT, NË VALËT E KRIZËS MORALE
- 52 E KUSH MUND TË JETË MË MIZOR SE SHKATËRRUESIT E TYRE...
- 54 MUSLIMANËT, GJITHNJË ME BUSULL
- 56 XHAMIA DHE ROLI I SAJ NË SHOQËRINË ISLAME
- 58 SHPËRBËRJA E HELMIT
- 60 IRCM AGAINST DISCRIMINATION
- 61 WE ARE NOT ABANDONING THE BURMALI MOSQUE
- 62 PEACE IS EVERYONE'S GOAL
- 62 STOP DISCRIMINATORY AND ISLAMOPHOBIC POLICY
- 63 TURKEY IS ALWAYS READY TO HELP IRCM



Sheshi i qytetit nuk duhet të merret si vend ndarjeje, por si vend që do të bashkojë popujt. Politika nuk duhet të përzihet në marrëdhëniet fetare - kanë thënë gjatë takimit h. Sulejman ef. Rexhepi me z-nj. Maria Angeles Garcia de Lara



Kjo është porosia që doli pas takimit që ka zhvilluar më 9.03.2010 (e martë) kryetari i BFI-së, Reis-ul-ulemaja, haxhi Sulejman ef. Rexhepi, me zv/ambasadorin e Spanjës në Shkup, z-njën Maria Angeles Garcia de Lara.

Në takimin shumë domethënës u bisedua për pozitën e muslimanëve në Maqedoni, zhvillimin e proceseve të marrëdhënies ndërfetare dhe për shqetësimin e fundit me projektin 'Shkupi 2014', ku Xhamia Burmalit është anashkaluar, si dhe për injorimin e kërkesave të BFI dhe Myftinisë së Shkupit lidhur me këtë xhami në sheshin e qytetit. Gjithashtu, është biseduar edhe për objektet fetare si në Prilep, Manastir dhe për pronën e BFI në tërë territorin e Maqedonisë. E gjithë kjo, u tha, ka trazuar shpirtat e qytetarëve muslimanë dhe situata është tensionuar deri në atë masë, sa që mund të shpërthejë edhe ndonjë konflikt ndërfeetar.

Të takuar për Burmalit-Xhaminë, Reis-ul-ulemaja, haxhi Sulejman ef. Rexhepi, i ka shprehur në tavolinë të gjitha problemet me të cilat ballafaqohet institucioni shpirtëror islam në vend, duke i përmendur z-njës Maria de Lara se BFI po diskriminohet deri në skajshmëri nga pushteti qendror dhe lokal.

"Nuk kanë asnjë të drejtë që në Llazhec ende nuk e lejojnë ndërtimin e xhamisë për qytetarët e këtij fshati. Edhe pse pjesa dërrmuese e banorëve janë muslimanë, ata vazhdojnë të jenë të privuar nga e drejta për të pasur objektin e tyre fetar për të kryer obligimet fetare dhe lutjet e përditshme. Problem tjetër është Jeni-Xhamia në Manastir, rindërtimi i së cilës po ashtu nuk lejohet. Që absurdi të jetë më i madh, Jeni-Xhamia vazhdon të jetë e vetmja xhami në botë e cila për pronar ka shtetin. Të drejtën kushtetuese për menaxhimin e xhamive e ka vetëm Bashkësia Fetare Islame në RM. Për

BFI nuk lejon të jetë e diskriminuar



të qenë më e qartë kjo, duhet theksuar që edhe në vendet islame xhamitë i menaxhon Sektori i vakëfit e jo shteti. Në këtë rrafsh, patjetër duhet të përmendet edhe xhamia e Prilepit, e cila edhe pas nëntë vitesh nga djegia vazhdon të jetë dëshmi e gjallë e 'Natës së kristaltë' mbi Islamin. Sipas pushtetarëve, arsyeja është se akoma janë të freskëta kujtimet e Karpallëkut, që është një arsye më se banale", i ka thënë kreu i BFI-së zv/ambasadorit të Spanjës në Shkup, z-njës Maria de Lara. Kështu po veprohet edhe me pronat dhe vakëfin e BFI në tërë vendin. Problem të radhës e kemi Kapan-Hanin, Suli-Hanin, Ibni-Pajkon, etj. Çudia e madhe është se Kapan-Hani i kthehet Myftinisë së Shkupit dhe e njëjta i merret me pa të drejtë. Brenga tjetër, ku edhe u ndal më shumë Reis-ul-ulemaja e BFI, ishte diskriminuar në projektin kontestues nga BFI, projekt i cili, edhe përkundër asaj që në publik implementohet nga Komuna Qendër, ajo vazhdon të mbajë vulën e Qeverisë së Gruevskit. "Ne edhe sot nuk kemi një përgjigje se pse nuk është pjesë e PDU xhamia që njihet edhe si Bukuroshe e Ballkanit, tha ef. Rexhepi, duke i treguar z-njës Maria de Lara të gjitha aktivitetet që ka marrë BFI deri më tani në lidhje me përfshirjen e Burmalit-Xhamisë në PDU-në e Komunës Qendër.

Në këtë takim nga BFI kritika iu adresuan edhe kryeministrit

Gruevski, i cili përkundër faktit që Reis-ul-ulemaja kishte kërkuar hap-tazi thirrjen e një takimi të liderëve fetarë dhe politikë, ai edhe më tej rri heshtur.

Zv/ambasadori i Spanjës në Shkup ka shprehur keqardhje për çështjet që po ndodhin në Maqedoni, duke filluar nga sheshi "Shkupi 2014", pronat e BFI në Shkup dhe në tërë vendin, pastaj rasti i objekteve fetare në Manastir dhe në Prilep, të cilat nuk janë zgjidhur edhe pas kaq kohësh.

"Qeveria e R. Maqedonisë duhet të përfaqësojë në mënyrë të drejtë të gjithë bashkësitë fetare dhe të mos bëjë ndonjë dallim mes tyre, aq më pak diskriminim ndaj ndonjëres prej bashkësive fetare, ngase situata për çdo ditë po tensionohet dhe se e njëjta mund të ketë një të ardhme krejt tjetër - konflikt ndërfeetar", ka porositur z-nja Maria de Lara.

Ajo po ashtu ka shprehur pakënaqësitë e saj me projektin "Shkupi 2014".

"Çështja e këtij projekti ka shqetësuar shumë palë. Sheshi i qytetit nuk duhet të merret si vend ndarjeje, por si vend që do të bashkojë popujt dhe kulturat. Mosmarrëveshjet duhet kapërcyer me dialog dhe vetëm me formën e komunikimit", ka potencuar z-nja Maria de Lara pas takimit me kreun e BFI-së, h. Sulejman ef. Rexhepin, i shoqëruar nga sekretari i përgjithshëm i saj, Afrim ef. Tahiri dhe h. Jakup ef. Selimovski.

Nuk heqim dorë nga XHAMIA BURMALI

Qeveria të marrë vendim për të nisur rindërtimin e Xhamisë Burmali në sheshin e Shkupit dhe me këtë të përfundojë praktika e Qeverisë për prezantimin jokorrekt të vlerave historike dhe njëkohësisht shteti të kujdeset për të gjitha bashkësitë fetare njësoj, ka qenë kërkesa që Reis-ul-ulema Sulejman ef. Rexhepi u paraqiti amerikanëve



Më 09. 03. 2010 (e martë) kreu i BFI-së ka zhvilluar takim edhe me përfaqësues të Ambasadës amerikane në Shkup, David Burger dhe Jenifer Bosworth, të cilëve po ashtu iu shpreh revolta për politikën diskriminuese që po udhëheq shteti. Edhe përfaqësuesit amerikanë shprehën pikëpamjet e tyre në adresë të kësaj politike, e cila, në bazë të vlerësimit të BFI-së, në thelb ka prishjen e marrëdhënieve fetare e etnike në Maqedoni.

Qeveria të marrë vendim për të nisur rindërtimin e Xhamisë Burmali në sheshin e Shkupit dhe të përfundojë praktika e Qeverisë për prezantimin jokorrekt të vlerave historike dhe njëkohësisht shteti të kujdeset për të gjitha bashkësitë fetare njësoj, ka qenë kërkesa që Reis-ul-ulema Sulejman ef. Rexhepi u paraqiti amerikanëve.

Kryetari i BFI-së, Sulejman ef. Rexhepi, ia bëri me dije Ambasadës amerikane në Shkup se nga kryeministri Nikolla Gruevski ka kërkuar të organizojë një takim liderësh partiakë në vend, me qëllim të zbutjes së tensioneve fetare, të cilat janë ringjallur kohëve të fundit. Takimi, sipas kreut të BFI-së, do të ishte mënyra e vetme për të shmangur përshtallëzimet e marrëdhënieve ndëretnike dhe ndërfitare në Maqedoni.

“Mirëpo, ne edhe sot nuk kemi asgjë konkrete nga Qeveria dhe partitë politike”, është shprehur Rexhepi.

David Burger dhe Jenifer Bosworth kanë shtuar se me vë-



mendje po ndjekin situatën aktuale dhe reagimet e ndryshme që vijnë me prezantimin e këtyre projekteve.

“Kemi kërkuar gjithmonë dhe po të njëjtën kërkojmë, që shteti të promovojë trajtim të barabartë ndaj të gjitha religjioneve”, kanë thënë amerikanët, të cilët po ashtu kanë përsëritur qëndrimin e ambasadorit të Amerikës në Shkup, Filip Riker, i cili ka komentuar se “vendimet për projekte të tilla dhe për shfrytëzimin e fondeve të tilla, duhet të merren nga të gjithë qytetarët”.

Derisa kreu i BFI-së vazhdon të takohet me ambasadorët e huaj në vend dhe të alarmojë opinionin për situatën e brishtë të krijuar, në Këshillin e Komunës Qendër punët vazhdojnë të jenë “pesë në dymbëdhjetë” - as në seancën e të

mërkurës nuk u debatua për iniciativën e BFI-së që në qendër të Shkupit të ngrihet Xhamia Burmali. Kjo u bë e ditur nga vetë kryetari i Komunës Qendër, Vladimir Todoroviq, i cili shtoi se kjo iniciativë e vjetër do të vihet në rend dite në një nga seancat e radhës.

“Shumë shpejt do të jetë në rend dite. Njëherë tentova që ta vë, mirëpo këshilltarët e LSDM nuk deshën ta pranonin në rend dite, duke u arsyetuar se nuk kanë qenë të përgatitur dhe kërkuar materiale me shkrim. Unë ju kam thënë se nuk do të ketë materiale të shkruara për një iniciativë të cilën do të duhet ta shqyrtojmë dhe për të cilën do të duhet të debatojmë. Nuk do të jetë nesër, por me siguri në një nga seancat e radhës”, njoftoi ditë më parë Vladimir Todoroviq.

AMBASADORI I IZRAELIT VIZITON BFI-NË



Paqja, synim i të gjithëve



Kreu i Bashkësisë Fetare Islame, Reis-ul-Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi, në kryesinë e BFI-së priti ambasadorin e Izraelit në Shkup, z. David Cohen, me të cilin patën një takim zyrtar. Duke qenë se Ambasadori Cohen është ambasador i emëruar për Maqedoninë, Shqipërinë dhe Bosnjën, i njihte mirë rrethanat e rajonit.

Gjithsesi, Reis-ul-Ulemaja H. Sulejman ef. Rexhepi e njoftoi më nga afër për zhvillimet e fundit në Republikën e Maqedonisë, duke sjellë konstatim të përbashkët se këto zhvillime, që kanë një qasje njëreligjioze dhe njënacionale, ndikojnë negativisht në marrëdhëniet ndërkonfesionale dhe ndërretnike në vendin tonë.

“Edhe përkundër të gjitha veprimeve të deritanishme, që nuk janë në favor të bashkëjetesës, ne si muslimanë dhe Bashkësia Fetare Islame jemi të mendimit dhe qëndro-

jmë thellë në bindjet tona se multietniciteti dhe multikonfesionaliteti i vendit duhen të jetë bereqet-vlerë për ne”, tha mes tjerash Reis-ul-Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi, i cili gjithashtu shprehu pakënaqësinë për problemet me të cilat ballafaqohet populli palestinez në Lindjen e Mesme, duke theksuar se të gjitha ato probleme atje prekin ndjenjat e gjithë muslimanëve, ngase Mesxhid el Aksa është vend i shenjtë për gjithë muslimanët dhe njëkohësisht kërkoi sqarime nga Ambasadori i nderuar lidhur me atë se si mendojnë t’i kapërcejnë të gjitha ato probleme atje.

Nga ana tjetër, Ambasadori David Cohen shprehu keqardhje për situatën e krijuar këtu në Maqedoni dhe theksoi se shteti që ai përfaqëson do të jetë gjithmonë pranë vendit tonë për të ndihmuar në kapërcimin e vështirësive.

Ndërkaq, për sa u përket problemeve në Lindjen e Mesme, Am-

basadori Cohen bëri një prezantim para Reis-ul-Ulemasë për historinë dhe bashkëjetesën e hebrenjve dhe muslimanëve ndër shekuj. Lidhur me problemet që ka shteti i Izraelit me palën palestineze, ambasadori Cohen pranoi se vërtet çështjet janë shumë të ndërlikuara dhe se për këtë duhet shumë angazhim për zgjidhjen e çështjes palestineze, duke theksuar se disa herë që nga vitet nëntëdhjetë e këtej, shumë herë kanë qenë afër marrëveshjes, mirëpo, për fat të keq, paraqiten disa ndodhi dhe e dëmtojnë procesin. Kohëve të fundit shteti i Izraelit ka marrë përsipër që ta ndihmojë procesin e paqes në Lindjen e Mesme, duke synuar që ta ndihmojë Qeverinë legjitime palestineze, sepse në fund të fundit, popullata muslimane gjithmonë ka qenë më e afërt me popullatën hebreje, madje edhe në të kaluarën Islami ka qenë feja më tolerante ndaj Hebreizmit.

Vepra të bënë të jeshë gjithmonë i gjallë

Më 21.03.2010 Myftinia e Maqedonisë Lindore me seli në Shtip në koordinim me tarikatit Melami nën patronatin e Riassetit të Bashkësisë Fetare Islame e R.M, realizoi manifestim tradicional në shenjë përkujtimi të figurës së shquar të botës Islame, Muhammed Sejjid Nurul Arabi në pallatin e kulturës në Strumicë.

Në këtë manifestim morri pjesë Reis ul Ulema i Bashkësisë Fetare Islame, H. Sulejman ef. Rexhepi, Myftiu i Maqedonisë Lindore, Isa ef. Ismaili, Myftiu i Shkupit, Ibrahim ef. Shabani, Dekani i Fakultetit të Shkencave Islame, Drejtori i Medresesë Isa Beu, përfaqësues nga Komuna e Strumicës si dhe qytetarë të shumtë. Fillimisht të pranishmive iu drejtua udhëheqësi i programit Abaz Islami i cili përshëndeti Reis ul Ulemanë e BFI si dhe të gjithë të pranishmit në sallë duke iu dëshiruar mirëseardhje në këtë manifestim. Fjalë përshëndetëse mbajti shehu i Tarikatit Melami, Ramiz efendi Jahja, i cili falënderoi Reis Ulemanë, H. Sulejman ef. Rexhepi për prezencën e tij, Myftiun për Maqedoninë Lindore dhe të Shkupit, përfaqësuesit e komunës së Strumicës, si dhe gjithë pjesëmarrësit. Ramiz efendi para të pranishmive prezantoi jetën dhe veprën e Muhammed Sejjid Nurul Arabi, si dhe autoritetin e lartë që gëzonte në mesin e njerëzve.



Në këtë manifestim të pranishmive iu drejtua Myftiu i Maqedonisë Lindore, Isa ef. Ismaili i cili përkujtoi këtë figurë të shquar të shoqërisë Islame dhe rolin që kishte luajtur ky personalitet për ngritjen e imazhit të shoqërisë islame. Por, assesi nuk duhet harruar veprën e tij në ngritjen e kulturës dhe vetëdijes së shoqërisë, duke thirrur gjithnjë në respektim të kulturave dhe popujve përmes tolerancës dhe dialogut. Reis ul Ulema në këtë manifestim kishte fjalë rasti i cili shprehu falënderime Allahut për këtë rast që iu kishte mundësuar të merr pjesë në manifestimin tani më tradicional që organizohet në shenjë përkujtimi të personalitetit të shquar Muhammed Sejjid Nurul Arabi. Gjithashtu përshëndeti anëtarët e Riassetit, Myftitë, përfaqësuesit e tarikatit Melami, përfaqësuesit e Komunës së Strumicës si dhe të gjithë ata që ishin pjesëmarrës në këtë manifestim. " Më paraqet nder dhe kënaqësi të veçant që Allahu i Gjithëfuqishëm më mundësoi të jem pjesë e këtij manifestimi tradicional në shenjë përkujtimi të personalitetit Shejhut Muhammed Sejjid Nurul Arabi, si vazhdues i lozës së familjes së Muhammedit a.s, andaj ky qytet na paraqet mundësi të vetme këtu në Ballkan,

ku dikush nga pasardhësit e Muhammedit a.s jetoi dhe ndërroi jetë në të njejtin qytet."

Ai më tej shtoi se: " Ky është vitë jubilar për të gjithë myslimanët, ngase shënojm 14 shekuj gjegjësisht 1400 vjetorin ku me urëdhër të Allahut f.p, meleku Xhibril iu paraqit Muhammedit a.s dhe e përkujtoi se leximi, studimi dhe kuptimi janë mjete të fuqishme për njohjen e Allahut xh.sh,...Tani Ne përmes leximit të Kuranit burimor, ilahî, kaside dhe poezi e përkujtojm veprën dhe misionin e Muhammedit a.s"-shtoi H. Sulejman ef. Rexhepi.

Në vazhdim të këtij manifestimi u kënduan ilahi nga grupe të ndryshme që morrën pjesë në mesin e të cilëve edhe kori i Medresë Isa Beu nën udhëheqje të Mr. Abaz ef. Jahja.



STOP politikës diskriminuese dhe Islamofobe

Më 26.03.2010 Myftinia e BFI- Shkup mbajti press-konferencë për mediat e shkruara dhe elektronike tek Ura e gurit më saktësisht tek Mihrabi, para një numri të madh të mediave zëdhënësi i Myftinisë Skender Buzaku deklaroi:

Të nderuar mjete të informimit sot Muftinia e Shkupit nuk është rastësisht në këtë vend, sepse këtu afër neve është Mihrabi i shenjtë të cilin e kanë ngritur parardhësit tonë mysliman.

Mirëpo, para një kohe ky element islam në mënyrë vandale ishte rrënuar nga struktura antiislame duke u arsyetuar se nuk e kanë pasur me dije se çka janë duke bërë.

Sot i njëjti edhe pse është kthyer ai më tepër i ngjan një SPOMENIKI qeveritar me elemente sllave, se sa Mihrabit të vërtetë që u ndërtaua së bashku me urën e gurit.

Në pjesën e majtë të lumit Vardarit kemi vakufin e Ibni Pajkos për të cilin jemi ende në procedurë gjyqësore për kthimin e së njëjtit. Mirëpo edhe pse për të njëjtin kemi vendim pozitiv nga gjykata administrative e vendit qeveria me një vandalizëm të thellë dhe duke mos respektuar edhe gjykatën e vendit, uzurpoi pjesën më të madhe të kësaj toke dhe tani ndërton Filharmoninë Maqedone.

Kryeministri para pak ditëve deklaroi se “askush nuk ka të drejtë të ndërtoj diçka në tokën e huaj”, andaj pyesim: Se si ai i dha vetës të drejtë që të filloj me ndërtime të Filharmonisë Maqedone në vakufin e Muftinisë së BFI Shkup?

Kurse, sa i takon ndërtesës së Ibni Pajkos kemi një vendim shumë kontraverz sepse në të njëjtin thuhet se na kthehet vetëm kati i parë, kurse katet tjera në të



cilat ka banesa nuk na kthehen, me arsyetimin se të njëjtat u janë shitur personave fizik nga shteti.

Pyesim çfarë shteti juridik merr të drejtën që të shet pronën dhe pasurinë e huaj?

Kujdes, se ata që bëjnë eksperimente me vakufe, që padrejtësojnë popullin i gjenë mallkimi i Zotit por dhe dënimi i njerëzve.

Në pjesën e djathtë të lumit Vardar ka qenë xhamia e Burmalisë, tani ajo është vetëm në zemrën dhe mendjen e popullit, zëri i të cilëve po has në veshin e shurdhër të Kryetarit të Komunës Qendër mentor i të cilit është Kryeministri Gruevski.

Prandaj, pyesim kryeministrin si mundet që Çarshia e Vjetër e Shkupit të konsiderohet si vlerë për mbarë qytetarët e Maqedonisë, për të cilën kanë kompetenca edhe institucione dhe organe shtetërore përkrah që ka


Komuna e Çairit, për te pra duhet të pyeten edhe qytetarët që jetojnë jashtë komunës së Çairit, kurse për sheshin e kryeqytetit që quhet “Maqedonia” për të të vendosë vetëm komuna e Qendrës-Shkup.

Kryeministër ne dita ditës jemi duke iu afruar xhamisë së Burmalisë, andaj obligimi yt i menjëhershëm është që sa më parë të kthesh pronën e Muftinisë së BFI Shkup.

Ta bëjmë me dije se ky është njëri prej hapave të parafundit të Muftinisë së BFI Shkup me të cilën bëjmë thirrje që t’i thuhet STOP politikës diskriminuese dhe Islamofobe e cila po dridh themelet e shtetit multifetar dhe multietnik.

Andaj, edhe një herë ju bëjmë thirrje publike që të prononcoheni për të gjitha këto probleme të cilat lindën si rezultat i politikës suaj hipokrite. Ballafaqohuni me të vërtetën.

Turqia gjithmonë është e gatshme të ndihmonë BFI



Më 26.03.2010 në lokalet e BFI, Reis ul Ulema, H. Sulejman ef. Rexhepi zhvilloi takim me Ministrin e Punëve të Jashtme të Turqisë, Z. Ahmet Davutoglu, të cilin e informoi në mënyrë burimore lidhur me gjithëçka që po ballafaqohet BFI dhe myslimanët e Maqedonisë. H. Sulejman ef. Rexhepi e njoftoi Ministrin, Davutoglu për diskriminimin që po ushtron Qeveria aktuale ndaj të vetmit institucion shpirtëror fetar në Maqedoni si dhe favorizimin e Kishës Ortodokse Maqedone nga vetë Kryeministri, Gruevski. "Ne nuk kërkojmë nga pushteti të jemi të privilegjuar, por të jemi të



barabartë me tjerët, kushtetuta na flet se feja është e ndarë nga shteti, ndërsa pushteti aktual favorizon dhe privilegjon KOM.” Rexhepi e njoftoi për punën e pronës së BFI, objektet fetare në Shkup, Manastir, Prilep, Maqedoninë Lindore etj., ky është diskriminim që nuk mund ta pranojë, shembull eklatant në botë është Maqedonia duke i menaxhuar xhamitë.

Ai mbi të gjitha dënoi Projektin ‘Shkupi 2014’ ku është anashkaluar Xhamia Burmali dhe se sheshi i Shkupit i quajtur ‘Makedonija’ po prezentohet sikur të jetë shesh vetëm i një shoqërie që është në kundërshtim me normat kushtetuese dhe principeve të demokracisë. Maqedonia është shtet multietnik dhe multifetar dhe se këtë karakter duhet ruajtur, kurse politika që po ushtron Kryeministri kontribuon në prishjen e marrëdhënieve ndërjetare dhe ndërretnike në Maqedoni.

Kryetari i BFI-së, Sulejman ef. Rexhepi, ia bëri me dije Ministrit, Davutogllu se për problemet me të cilat po ballafaqohet BFI dhe myslimanët është i informuar i gjithë kori diplomatik në vend. BFI është e dëmtuar

nga politika aktuale, këtë e vërteton edhe Raporti i State Departamentit Amerikan.

Në anën tjetër Ministri, Davutogllu shprehi shqetësimet për këtë që po i ndodh BFI dhe myslimanëve të Maqedonisë, ku ai ishte dëshmitarë i padrejtësive pasi që kishte vizituar disa qytete në vend, në mesin e të cilave kishte theksuar mbylljen e Jeni xhamis në Manastir, me çrastë Ministri nuk kishte mundur të hyjë brenda e të shoh këtë xhami. Edhe për kundër gjithë kësaj ai “porositi se duhet të ekzistojë tolerancë ndërshoqërore ngase ajo është edhe tolerancë shtetërore”. Gjithashtu theksoi se Turqia gjithmonë është e gatshme të ndihmonë BFI në kërkesat e saj legale drejtuar institucioneve, kurse borxh i saj historik është që të mbrojtë trashigiminë kulturore të periudhës Osmane.”


Reis ul Ulema me Ministrin Davutogllu këmbyen nga një dhuratë ku këtij të fundit iu dha një kornizë me xhaminë Burmali në shenjë nderi dhe respekti që iu bë Reis ul Ulemasë, BFI dhe myslimanëve të Maqedonisë.

**KA NDËRRUAR JETË
HFZ. REFIK AJETI**

Njeriu që mësoi me sytë e zemrës


Pa dyshim u takon njerëzve të historisë. E, punëtorët e historisë, ata që e kanë ndërtuar të ardhmen, nuk llogariten prej atyre që i vret vdekja, por nga grupi i njerëzve që asnjëherë nuk i prek vdekja. Dhe, vërtet, e ardhmja dhe historia e Hfz. Refikut ishte Kur’ani, trashëgimia e një plejade hafëzësh dhe shumë të tjerë që përvetësuan leximin e tij. Ai vdiq për të mbetur përgjithmonë gjallë, për të mos u shuar asnjëherë

*Çdo gjë do ta shijojë vdekjen,
pastaj do të ktheheni tek Unë
(El-Ankebutë, 57)*



Më 18 mars 2010, në orët e hershme të mëngjesit, pushoi së rrahuri zemra e teologut, mësuesit, respektivisht kandilit dhe rojtarit të njohur të fjalëve të Kur’anit, hfz. Refik Ajeti, i lindur në fshati Likovë të Kumanovës më 1930 në një familje të nderuar e me tradita fetare e kombëtare. Ndjenjat fetare e ushqyen atë që në fëmijëri, kështu që si i ri u pajis me një kulturë të shëndoshë islame e qytetare dhe që nga ajo kohë ai e përcakttoi rrugën e vet të një militanti e të një shërbyesi të vendosur të Islamit.





PARA SE TË VERBOHEM, DUA TA PËRVETËSOJ KUR'ANIN...

Hfz. Refik Ajeti do të mbahet mend gjatë për profilin e tij të veçantë publik. Ai qysh si i ri kishte dëshirë të zjarrtë që librin e Allahut – Kur'anin ta përvetësonte përmendsh, të cilën gjë e kishte filluar me një entuziazëm të madh, mirëpo ndërkohë ai u ballafaqua me probleme shëndetësore, respektivisht me sëmundjen e syve, kështu që me kalimin e ditëve rrezikonte të humbte të parit, gjë që fatkeqësisht edhe ndodhi.

Janë të paharruara fjalët e tij derisa ishte gjysmë i verbër: “Dua që sa më shpejt ta mësoj Kur'anin përmendsh, para se të më kaplojë verbimi”. Dhe, vërtet, Hfz. Refik Ajeti që në moshë të re e humbi të parit, mirëpo Allahu i dhuroi atij të parit e zemrës, të parit e shpirtit dhe, kështu, te sytë e tij shpirtërorë një numër i madh njerëzish të të gjitha grupmohave gjetën sytë e jetës a të vërtetën e saj.

Hfz. Refik Ajeti shquhet si krijues i një plejade hafëzësh, meshkuj e femra, të cilët kudo që u paraqitën nëpër gara vendore dhe ndërkombëtare nuk mbahet mend që ndon-

jëherë të ishin kthyer pa u shpërblyer me njërin nga vendet e para.

Ai ndër popullatën vendase, por edhe shumë më gjerë, shquhej me veprime si iluminist i rrallë në përpjekje të përhapjes së diturisë, kulturës, arsimit, përparimit dhe zhvillimit. Ai ishte dhe një veprimtar i palodhshëm në luftë kundër prapambeturisë dhe injorancës ndër popullatën e kësaj ane.

Ky lloj qëndrimi, ndërkaq, nuk i pëlqente diktaturës së kuqe, prandaj dy herë gjatë jetës e arrestuan, e burgosën dhe e torturuan pa asnjë argument ligjor. Ai në mungesë të fakteve u lirua nga burgu i dobësuar, i stërlodhur, sa nuk qëndronte dot në këmbë. Pas lirimit ai edhe më fuqishëm vazhdoi veprimtarinë e një mësuesi të palodhshëm, duke e shtuar edhe më shumë kapacitetin e nxënësve, të cilët si blea pas nekarit, thithnin mësimet e tij.

VDIQ, PËR TË MOS U SHUAR KURRË...

Hfz. Refik Ajeti pa dyshim u takon njerëzve të historisë. E, punëtorët e historisë, ata që e kanë ndërtuar të ardhmen, nuk llogariten prej atyre që i vret vdekja, por nga grupi i

njerëzve që asnjëherë nuk i prek vdekja. Dhe, vërtet, e ardhmja dhe historia e Hfz. Refikut ishte Kur'ani, trashëgimia e një plejade hafëzësh dhe shumë të tjerë që përvetësuan leximin e tij. Ai vdiq për të mbetur përgjithmonë gjallë, për të mos u shuar asnjëherë.

Lirisht mund të themi që hfz. Refik Ajeti i takon kategorisë së njerëzve për të cilët i Dërguari i Allahut thoshte:

“Shuarja e një populli është më e lehtë se vdekja e një dijetari” (hadith)

“Bëhu dijetar, që të mos vdesësh; sepse, njerëzit vdesin, por dijetarët nuk vdesin kurrë” (Aliu r.a.)

Ne si punonjës, nxënës dhe bashkëpunëtorë të tij, jemi ende në kërkim të fjalëve për të shprehur dhimbjen e madhe që na ka mbërthyer në këto orë, andaj pikëllimi e loti le të jenë mëshirë për të. Shprehja më e mirë do të ishte ajo që i Dërguari i Allahut tha me rastin e vdekjes së djalit, Ibrahimit:

“Syri po loton e zemra po vajton. Ne themi vetëm atë që është i kënaqur Zoti ynë. Ibrahim, ne nga ndarja jote me të vërtetë jemi të pikëlluar”.

SH. A.

KONFERENCA E LARTË PËR ÇËSHTJE ISLAME NË KAJRO TË EGJIPTIT

Islami, në beteja të njëpasnjëshme kundër të pavërtetës (batilit)



Muslimani pesë herë në ditë në fund të faljes së namazit i drejtohet gjysmës së botës nga ana e djathtë duke i përshëndetur me selam (paqe); më pas i drejtohet nga ana e majtë gjysmës tjetër, gjë që simbolizon se muslimanët lutën për paqe për mbarë botën. Në këtë fe nuk ka vend për dhunë, ekstremizëm, racizëm, terrorizëm, frikësimin e atyre që jetojnë në siguri e as sulm ndaj jetës dhe pasurisë së njerëzve



I nderuar President Muhamed Husni Mubarek, kryetar i Republikës Arabe të Egjiptit. I nderuar Imamu-l-ekber, Shejhul-Az'har, dr. Muhamed Sejid Tantavi. Shkëlqesia Juaj, Ministër i Vakëfit, njëkohësisht dhe Kryetar i Këshillit të Lartë për Çështje Islame, dr. Mahmud Hamdi Zakzuk. Vëllezër, zotërinj të nderuar, anëtarë të kësaj konference të përgjithshme, e 22-ta me radhë, të Këshillit të Lartë për Çështje Islame, zotërinj të nderuar dhe ju që jeni prezent, motra dhe vëllezër - shpëtimi, paqja, mëshira dhe bekimi i Allahut qofshin me ju... - tha në fillim të

fjalimit të tij në Konferencën e Kajros, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame në Republikën e Maqedonisë, h. Sulejman ef. Rexhepi.

Falënderimi i takon Zotit të botëve, mëshira e Allahut e kaploftë Pejamberin tonë, Muhamedin alejhis-selam, shokët dhe të gjithë ata që ndoqën rrugën e tij deri në Ditën e Llogarisë.

I lutem Allahut të jetë i kënaqur në këtë Konferencë të sotme me të gjitha përgjegjësit e pjesëtarëve të

komunitetit musliman, të na mundësojë prezantimin e diskutimeve (studimeve) të përgjithshme që janë të rëndësishme, në atë mënyrë që participimi ynë të jetë pozitiv në prezantimin e asaj që është më e vlefshme, që është rrugë më e suksesshme në sqarimin e botëkuptimeve islame, në mënyrë që të mund të ndalemi në atë e cila është reale, përmes prezantimit të tyre (diskutimeve) të mund t'i diskutojmë botëkuptimet e gabuara, të fiksojmë atë që është reale, duke bërë krahasime me atë të botëkuptimeve që dominojnë në qarqet e institucioneve botërore islame dhe botëkuptimet që kanë përfunduar institucionet ndërkombëtare botërore, me qëllim që të jemi në rrugë të drejtë. Në këtë kontekst, do të fillojmë me krahasimin e botëkuptimeve që Islami i ka miratuar, me botëkuptimet që institucionet internacionale kanë konkluduar dhe me restaurimet e zhvillimeve të botës së moderuar, të cilat ndërlidhen me tendencën e institucioneve tona islame.

Vërtet, tema e hulumtimit (studimit) tim "Ruajtja e fesë dhe liria e besimit", për të cilën i lutem Allahut që është i vërtetë të më mundësojë shpjegimin, përkatësisht, sqarimin në mënyrë të shkurtuar të komponentëve të botëkuptimeve të aksit të parë;

Koncepti i besimit fetar,

Liria e besimit midis Sheriatit dhe dokumentit ndërkombëtar,

Dyshimet rreth lirisë së besimit në Islam,

Aventurat (rreziqet) që i kanosen Islamit.

Fillimisht qasja ime do të përqendrohet në shpjegimin e verifikuar të botëkuptimit të besimit fetar dhe dyshimet rreth lirisë së besimit në Islam. Ashtu që, kur përmendet liria e besimit në Islam, në mënyrë të drejtpërdrejtë abuzimet që janë kundër Islamit, të gjitha ato, ndërkohë, janë edhe kundër njerëzimit. Prandaj, do të demonstroj, përkatësisht, do të

shfaq në të njëjtën kohë, paralelisht dy komponentë.

Shumë shkencëtarë kanë dhënë formulime (të ndryshme) lidhur me përkufizimin e besimit. Ashtu që të gjithë nuk kanë dalë pa e prekur çështjen e botëkuptimit të besimit, mirëpo shumica e tyre nuk kanë sjell ndonjë përkufizim të plotë dhe tërësor. Nëse ka folur për natyrën "el-fitre", përkufizimin e vetë logjikës e ka lënë në rolin dhe komentimin e tij. Prandaj, në mënyrë të detajzuar do të paraqes shpjegimin e botëkuptimit të besimit fetar. Të gjithë ne e dimë se nuk mund të kishte zhvillim dhe përparim në sferat e jetës përderisa të mos kishim ide për jetën, ekzistencën e njeriut dhe për marrëdhëniet e tij me të gjithë komponentët që i përkasin para jetës së kësaj bote dhe asaj që do të pasojë. Për faktin se, mendja ose intelekti është ai që zbulon botëkuptimet e gjërave. Njeriu i përshtat (akomodon) sjelljet e tij në jetë sipas botëkuptimeve të tij ndaj saj. Sjellja njerëzore është e lidhur me botëkuptimet e njeriut. Aspiratat tona për të ndryshuar sjelljen e paqëndrueshme të njeriut në sjellje të avancuar, imanente është ndryshimi i botëkuptimit të tij për faktin se "Allahu nuk e prish (ndryshon) gjendjen e një populli (nuk ua largon të mirat), përderisa ata ta ndryshojnë veten e tyre." (Kur'an, 13 : 11)

RRUGA E EMOCIONEVE NUK KA PËRFUNDIM TË GARANTUAR

Intelekti ose opinionin për të cilin po flas, për marrëdhëniet e njeriut me jetën dhe ekzistencën, nuk mund të ishte produktiv përderisa të mos zbulojmë marrëdhëniet e parajetës, të ekzistencës, të njeriut dhe asaj që pason, siç është credoja (besimi). Dimë shumë njerëz që janë mbështetur vetëm në "fitre – natyrshmëri" në interpretimet e tyre. Si pasojë, ata u ballafaquan me rrugë pa krye. Ngase, tek ata ka munguar bindja, respektivisht, besimi në Allahun, në Krijuesin e asaj natyre të lindur te çdo njeri.

Kjo bindje, përkatësisht besimi nga ajo natyrë e lindur, vjen ose arrin nga rruga e emocioneve, rrugë e cila nuk ka përfundim të garantuar dhe është jopërçuese deri në fiksion nëse lihet vetëm. Për faktin se, emocioni shpeshherë e përcjell atë që u beson gjërave që nuk janë të vërteta. Mirëpo, emocionet i braktisin tiparet që janë të domosdoshme të asaj që i besohet dhe gremisen në mosbesim ose humbje. Idhujtaria, devijimet, gënjeshttrat nuk janë asgjë tjetër përveçse si pasojë e gabimeve të emocioneve. Bie fjala, besimet që i përkasin budizmit, bindjeve të tjera dhe ato që i referohen vetëm logjikës, u ndeshën me natyrën dhe satisfaksionet e tyre, sikurse që është komunizmi. Prandaj, Islami nuk i la emocionet rrugë të vetme për besimin, vetëm e vetëm të mos i atribuohen Allahut tipare ose cilësi që bien ndesh me karakterin hyjnor ose vetëm e vetëm që të mos mundësohet materializimi me gjëra ose sende që i përkasin materies e që çojnë në mosbesim (qufër). Mu për këtë, Islami ka kërkuar, përkatësisht ka urdhëruar, që mendja të shfrytëzohet paralelisht me emocionet. Ka kërkuar nga muslimani të shfrytëzojë mendjen në rastin kur i beson Allahut. Nga ana tjetër, e ka ndaluar imitimim në çështje besimit ose bindjeje: "Është fakt se në krijimin e qiejve e të tokës, në ndërrimin e natës e të ditës, të anijes që lundron në det që u sjell dobi njerëzve, në atë shi që e lëshon Allahu prej së larti e me të ngjall tokën pas vdekjes së saj dhe përhap në të nga çdo lloj gjallese, në qarkullimin e erërave dhe të reve nënshtruar qiellit e tokës (në të gjitha këto), për një popull që ka mend, ka argumente". (Kur'an, 2: 164) Islami ka paraqitur zgjedhje reale, e cila plotësisht përputhet me natyrën e lindur dhe mbush mendjen plotë bindje, zemrën plotë qetësi, duke mundësuar futjen në të me kushtëzimin e miratimit të atij solucioni, miratim i cili buron nga mendja. Prandaj, konstruksioni i Islamit ishte i

ndërtuar në një bazë të vetme e ajo është credo-ja (besimi), i cili thërret në atë se pas kësaj gjithësie, pas njeriut dhe jetës, ekziston një Krijues që i ka krijuar të gjithë.

Dhe, ka krijuar çdo gjë. E ai është Allahu i lartësuar. Krijuesi gjërat i ka shpikur nga mosekzistimi dhe Ai domosdo të ekzistojë. Ai nuk është krijesë (I krijuar), sepse nuk do të ishte krijues. Cilësimi i Tij si jo i krijuar gjykohet se Ai nuk është i krijuar. Gjithashtu, gjykohet se ekzistimi i Tij është i patjetërsueshëm, sepse ekzistimi i të gjitha gjërave mbështetet tek Ai, ndërkohë Ai nuk ka nevojë për mbështetjen e askujt. Të gjitha gjërat janë të krijuara dhe duhet të kuptohet se duhet të kenë krijues, të cilin mund ta perceptojë logjika e ai është njeriu, universi dhe jeta. Të gjitha këto gjëra karakterizohen me cilësi që janë të detyrueshme për ta dhe ato janë të kufizuara, jo të plota, jo të efektshme që kanë nevojë për faktorë të jashtëm. Njeriu është i kufizuar, për shkak se rritet në çdo gjë në një masë të caktuar që nuk mund ta tejkalojë. Ai është i kufizuar siç është dhe jeta e kufizuar, sepse paraqitja e saj është individuale dhe përjetimi përmes ngacmimeve përfundon tek individi dhe universi i kufizuar, sepse i përkasin grupit suplementar të trupave. Secili trup në tërësinë e tij është i kufizuar, siç janë të kufizuar edhe vetë toalet e ndryshme në intuitë. Universi është i kufizuar, në kontekst të kësaj edhe njeriu është i kufizuar. Kur shikojmë në atë që është e kufizuar, vërejmë se ai kufizim nuk është i përhershëm. Po të ishte ashtu, nuk do të ishte e kufizuar në kohën kur vetë kufizimi është gjë e krijuar. Ndërkaq, qenie jo e krijuar është Krijuesi i universit, i njeriut dhe i jetës, ekzistimi i të Cilit është i domosdoshëm. Në shumë vende Kur'anit Famëllartë ka sinjalizuar për vëzhgim (perceptim) në çdo manifestim nga manifestimet e jetës. Nga vetë fakti se mendja është ajo e cila i percepton (manifestimet) me



shfaqjen e gjërave, të cilat i nënshtrohen vrojtimit (prekjes) dhe flasin për atë se ato kanë Krijues i Cili i ka krijuar. Për vetë faktin se të gjithë gjërat janë të kufizuara, kanë mangësi dhe janë jo të afta. Ashtu që ato janë të varura nga faktori i jashtëm. Një gjë e këtillë vërtetohet me argumente të prera (decide) për atë se ekziston Allahu i madhërishtëm. Në këtë kontekst, ajetet janë të shumta: “Është fakt se në krijimin e qiejve e të tokës, në ndërrimin e natës e të ditës, të anijes që lundron në det që u sjell dobi njerëzve, në atë shi që e lëshon Allahu prej së larti e me të ngjall tokën pas vdekjes së saj dhe përhap në të nga çdo lloj gjallese, në qarkullimin e erërave dhe reve të nënshtuar qiellit e tokës (në të gjitha këto), për një popull që ka mend, ka argumente”. (Kur’an, 2: 164) Në kaptinën Er-rum është theksuar: “Nga argumentet e Tij është krijimi i qiejve e i tokës, ndryshimi i gjuhëve tuaja dhe i ngjyrave tuaja. Edhe në këtë ka argumente për

njerëz.” Ndërkaq, në kaptinën El-Gashije, theksohet: “A nuk i shikojnë devet sesi janë krijuar? Edhe qiellin sesi është ngritur lart! Edhe kodrat sesi janë vendosur! Edhe tokën sesi është shtruar!” Në kaptinën Et-tarik gjithashtu është përmendur: “Le të shikojë njeriu se prej çkahit është krijuar! Ai është krijuar prej një uji që hidhet fuqishëm, e që del nga kurrizi i shpinës dhe dërrasa e gjoksit.” Këto janë disa nga shumë ajete kur’anore që e ftojnë njeriun të vëzhgojë thellë, duke mos qenë i njëanshëm ndaj gjërave që e rrethojnë, në atë mënyrë që përmes atij vëzhgimi të arrijë në argumentimin, përkatësisht vërtetimin e ekzistimit të Krijuesit. Me qëllim që, bindja (besimi) e tij të ishte e rrënjësuar thellë nga mendja dhe dëshmitë (faktet).

LIRIA E BESIMIT MIDIS SHERIATIT DHE DOKUMENTIT NDERKOMBËTAR

Liria e besimit në legjislacionet pozitive bashkëkohore lidhur me

të drejtën e njeriut të përqafojë fenë që ai dëshiron dhe ndërrimin e tij në fe tjetër.

Kur flitet për akuzat e pavenda drejtuar Islamit lidhur me lirinë e besimit islam, mund të flitet nga disa aspekte:

“Islami nuk njeh liri të besimit, ngase përhapja e tij është bërë me tehun e shpatës në llogari të të gjitha besimeve të tjera, që njerëzit të heqin dorë nga besimet e tyre dhe ta pranin atë; ky besim (Islami) është përhapur me shpatë dhe se nuk ka mundësuar pozicion për të debatuar rreth besimeve të tjera, në atë mënyrë që njerëzit të kishin mundësinë e zgjedhjes së besimit të tyre që u përgjigjej. Për atë se, nuk i lejohet muslimanit të lërë fenë e vetë, sepse po të bëjë një gjë të tillë, do të ballafaqohej me ndëshkime të rënda, pra do të ndëshkohej me vdekje.” Është fakt se të gjitha format e këtilla të akuzave janë të pavërteta, të paargumentuara me argumente të qarta, të përcjella nga dijetarët në këtë kontekst, për faktin se çështja e besimit nuk ndërlihet me diç tjetër përveç se me bindjen.

Çështja e credos (e besimit) ka të bëjë me marrëdhëniet e njeriut me Zotin, të cilën e pranin si të vërtetë bindja e plotë dhe me atë plotësisht njeriu i dorëzohet Krijuesit të vetë. Ashtu që bindja e tillë nuk mund të arrihet me dhunë, ngase për këtë në Kur'an theksohet: “Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota.” (Kur'an, 2: 256) “Ti (Muhamed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit.” (Kur'an, 16:125)

Gjithashtu, në Kur'an gjejmë fakte që i nxisin njerëzit të shikojnë në mbretërinë e qiejve dhe të tokës në atë mënyrë që të ndërtojnë besimin e tyre në bazë të mendjes dhe të menduarit e jo thjesht kjo të ishte si rezultat i trashëguar. “... në

gjithë këtë ka fakte për njerëzit që thellë mendojnë.” (Kur'an, 13:3) Shumë orientalistëve dhe mendimtarëve perëndimorë iu është vërtetuar gënjeshtria në deklarimet e tyre se Islami është përhapur me tehun e shpatës. Në librin *Mbrojtja e Islamit*, të autores Laura Veccia Vaglieri, veç tjerash thuhet: “Islami e ndalon rreptësisht armiçësinë në shumë tekste të qarta që janë theksuar në Kur'an dhe Sunnet, ku lufta shikohet në cilësinë e zjarrit që duhet të shuhet sa më shpejt që është e mundur, ngase sa më tepër që të shpërthejë, ngacmon. Islami i ka mohuar të gjitha veprimet luftarake dhe ashpërsinë, duke vënë grumbuj rregullash dhe zakonesh që të mund të arrihet bërja e luftës njerëzore. Allahu muslimanëve u ka lejuar që të luftojnë në mbrojtje të ndërgjegjes (vetëdijes) të miratimit të paqes dhe sistemit. Islami luftën e sheh si nevojë të lemerishme në këtë jetë, që sa më pak të ishte e ashpër. Autorja më andej ka argumentuar që Islami është përhapur në shtetin më të madh islam pa u futur asnjëherë ushtria, siç është Indonezia, pastaj Malajzia dhe Kina. Ashtu që, ka konstatuar që askush nuk mund të pretendojë se shpata ka qenë shkak për çlirimin që i ka hapur rrugën (përhapjes) së Islamit. Përkundër kësaj, në shumë vende islame autoritetet qeverisëse janë joislame duke u mundësuar, përkatësisht, duke u lejuar organizatave misionare të shumta që të përhapin krishterimin në shtetet islame. Mirëpo, asnjëherë nuk kishte sukses, në asnjë ritëm në shkaktimin e lëkundjes së Islamit në jetën e popujve të atyre trojeve. Në librin e Tomas Karlit të njohur *Të guximshmit dhe devocioni i heroizmit* theksohet se padia ose akuzimi që Islami është kujë (ulërimë) e shpatës që i ka detyruar njerëzit t'i përgjigjen ftesës së tij, është marrëzi dhe çështje e pakuptueshme, për faktin se nuk ekziston diç në të që mund të kuptohet se mprehja e shpatës me të cilën do të ishin vlarë njerëzit

ose që t'i përgjigjeshin thirrjes së saj i ka bërë muslimanë. Nëse do të ishte për të besuar, kjo do të mund të shërbente për të luftuar kundër armiqve të atyre që kanë besuar në të, duke qenë të nënshtruar dhe të sigurt. Të tillët u ndeshën me luftën e armiqve para se të mundeshin prej saj. Gjithashtu, do të kishim theksuar këtu atë që është theksuar në librin e Gustaf Lebonit *Gënjeshttrat e armiqve lidhur me përhapjen e Islamit me tehun e shpatës*: “Fuqia, përkatësisht, forca nuk ka qenë faktor vendimtar në përhapjen e Islamit; arabët, ata që ishin të pafuqishëm, përkatësisht që nuk mund të ndihmonin veten, i lanë të lirë në fenë (besimet) e tyre”. Një gjë e këtillë shkaktoi që disa komunitete të krishtera të përqaфонin (pranonin) Islamit dhe gjuhën arabe ta marrin si gjuhë të tyre zyrtare, për atë se arabët u cilësuan me mesazhe drejtësie, të cilën gjë ata nuk e kishin parë më parë, duke vërejtur, përkatësisht, duke gjetur lehtësime të cilat nuk i kishin njohur fetë e tjera më herët. Ka qenë e mundur, ndihmuesit e çlirimeve të para të arabëve të verbëroheshin dhe të bënin krime ashtu siç bëjnë zakonisht fituesit kur fillojnë t'i keqtrajtojnë të pushtuarit dhe t'i detyrojnë ata që të pranojnë fenë e tyre, që është aspiratë e tyre që ajo të përhapej në gjithë rruzullin tokësor. Nëse do të kishin bërë një gjë të tillë, do t'iu ishin përgjigjur thirrjes së tyre të gjithë popujt, të cilët iu ishin nënshtruar atyre më vonë. Do të kishte ndodhur ajo që u ndodhi të krishterëve me rastin kur u futën në Siri. Mirëpo, kalifët me aftësitë gjeniale të tyre e kuptuan se sistemi dhe fetë nuk imponohen me dhunë. Mu për këtë ata me popullatën e trojeve të çliruara u sollën shumë tolerantë, respektivisht me butësi madhore, duke u mundësuar atyre të kishin sistemin, ligjet dhe besimet e veta, por duke kërkuar prej tyre që të paguanin tatime të vogla, si kompensim për mbrojtjen e tyre dhe si arsyeje për sigurinë në mesin e tyre. Në të vërtetë, popujt

nuk kishin njohur çlirues të mëshirshëm dhe tolerantë sikur arabët. Në këtë kontekst, mund të prezantojmë shkurtimisht rezultatet e përgjithshme nga studimet e bëra të dijetarëve të mëdhenj të argumentuara me argumente reale në jetë:

Islami të gjithë njerëzit i trajton njësoj, pa dallim lloji, ngjyre dhe feje përsa u përket të drejtave dhe obligimeve.

Të drejtat dhe liritë që i ka caktuar Islami janë të drejta dhe liri përgjegjësie, që praktikohen në kuadër të sistemit shoqëror, që caktohen në shërbime për individin nga ana e shoqërisë.

Islami siguron mbrojtje të mjaftueshme përsa i përket jetës, lirisë së shprehjes dhe mendimit të lirë. Të drejtën e njeriut për ruajtjen e pasardhësve, të mendjes dhe fesë. Por, duhet përkushtuar parimeve dhe bazave të cilat janë prezantuar në këtë kontekst në dobi të njerëzimit në formë globale.

Islami ka kontribuar shumë në sferën e ekonomisë dhe të sociologjisë, duke prezantuar parime dhe baza që garantojnë solidaritetin njerëzor midis njerëzve. Duke pamundësuar të pasurit t'i përdorin të varfrit dhe atë që nuk mundet. Gjithashtu, Islami ka vënë parime dhe baza përsa i përket pasurisë shtetërore: ajo të mos ishte vetëm në duart e të pasurve, por dobia të ishte në sistematizimin e marrëdhënieve midis atyre që posedojnë dhe atyre që nuk posedojnë. Islami i ka dhuruar skamnorit dhe nevojtarit të drejtën materiale të cilën ia garanton shteti nga arka shtetërore, "bejtul mali" e muslimanëve, e cila mjafton për mbulimin e shpenzimeve (nevojave) dhe nevojat që motivojnë ose nxisin për punë dhe prodhim.

Në fushën e shprehjes së lirë, Islami ka vënë kritere dhe norma që e mbrojnë shoqërinë nga mendimet e dëmshme që i shkaktohen popullit d.m.th. një grup shkencëtarësh, të cilët do të merreshin me urdhërimin për të

mirë dhe ndalimin nga e keqja, me qëllim të ngritjes së njëllor kujdestarie ndaj praktikimit të të drejtave, edukimi nga zbatimi i obligimeve, largimi nga ndalesat në të gjitha segmentet që janë kundër parimeve fetare dhe morale të shoqërisë.

Islami ka miratuar lirinë e besimit duke i mundësuar çdo individ të drejtën e përcaktimit fetar që dëshiron. Sa i përket çështjes së braktisjes së fesë etj., si barriera që e pengojnë një gjë të këtillë nuk është çështje konsensusi dhe nuk lidhet me atë 'a ta këndet fiku'.

Islami e pranon përkatësinë joislame, përkatësisht kategorinë e njerëzve që janë jomuslimanë. Nuk shpreh armiqësi ndaj tyre, por i konsideron si pjesëtarë të shoqërisë islame përderisa ata i kanë pranuar dispozitat e Kushtetutës islame, respektivisht dispozitat që burojnë nga Kushtetuta islame.

Kur flasim për rolin e ligjit islam (Sheriatin) dhe dokumentet ndërkombëtare, ne muslimanët nuk mund të pretendojnë se ligji i Sheriatit islam është ligj pozitiv ndërkombëtar për shkak të marrëdhënieve ndërkombëtare, për shkak se komuniteti ndërkombëtar sot nuk është vetëm bashkësi islame, por është një shoqëri që i përfshin të gjitha fetë sikurse Islamin, Krishterimin, Judaizmin dhe Budizmin. Është një shoqëri që i përfshin të gjitha komunitetet, nacionalitetet dhe popujt e racave dhe llojeve të ndryshme. Ndoshta mund ta teprojmë nëse shprehemi publikisht se roli i Islamit në fushën ndërkombëtare ka rënë nga roli që kishte më herët përsa u përket marrëdhënieve të popujve në të kaluarën.

Është fakt që Jurisprudenca Islame (Sheriati) është burim kryesor i Legjislacionit të një numër i madh shtetesh; ai numër sot sillet diku 40 shtete. Mirëpo, në ato shtete ka vazhduar të sundojë deri në një kohë të afërt si ligj pozitiv. Sikurse që shumë rregulla

dhe dispozita të cilat i praktikojnë ato shtete, pasi që i referohen jurisprudençës fetare në formën e autoriteteve të shtetit si instrument për t'i miratuar rregullat e nevojshme të nxjerra nga Jurisprudenca Islame (Sheriati) për shoqëritë tona. Prandaj, kjo jurisprudenca llogaritet burim objektiv kryesor historik edhe për ligjet e atyre shteteve. Pra, komuniteti ndërkombëtar e pranoi Sheriati islam si një nga sistemet juridike kryesore në botë dhe rëndësia e tij duket në thënien se ai duhet të përfaqësojë formimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe kështu edhe burimet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me sisteme të tjera të mëdha ligjore.

PËR NJË KULTURË TË QETË MIDIS NJERËZVE

Si përfundim nga ajo që prezantuar, burimi kryesor i ligjit islam në thelb ka domosdoshmërinë e përhapjes së thirrjes islame, për të shtjerë në mend të vërtetën që të ndriçojë edukimin e njerëzve dhe për të promovuar një kulturë të qetë dhe të menduar në mes tyre, por kjo liri duhet të jetë përgjegjëse për të shmangur çdo gjë që e dëmtojnë komunitetin, vlerat e tij dhe anëtarët e tij. Gjithçka që shkon kundër ligjit në aspektin negativ dhe pozitiv, duhet të përfshijë të mirën për njerëzit dhe interesat e tyre, ajo që u sjell dobi, arsimimin dhe edukimin e tyre. Sa i përket haditheve të Pejgamberit sal-lallahu alejhi vesel-lem, të cilët e bëjnë të qartë dhe i konfirmojnë çështjet në vazhdim:

Tirrja në të mira, në mirësjellje dhe reforma midis njerëzve,

Shfaqja e të vërtetës dhe publikim haptazi, edhe nëse është në llogari të thënësit, në kontekst të asaj se është xhihad,

Komuniteti që nuk i ndalon të këqijat, që nuk urdhëron në të mirë, që i lë ankimet dhe që nuk u kundërvihet të pavërtetave, për të shkatërrimi është fundi i tij në këtë

botë, ndëshkimi në botën tjetër.

Domosdoshmërisht të merren masa pozitive ndaj atij që bën padrejtësi ndaj njerëzve dhe që ata i tradhton, që është garantuar për mbrojtje nga padrejtësia, realizimin e të drejtës dhe kthimin e saj te pronarët e vetë.

Pengimi i padrejtësisë dhe amoralitetit, duke përlloritur atë si krim drejt njerëzimit. Vepra në esencë, edhe pse është krim i turpshëm ose është një nga veprat penale, duhet të ketë dënim publik vetëm, vetëm që të mbillet frika te të tjerët që të mos përhapet turpi në fenë që i kanë besuar, ashtu që për çdo individ të pengohen afrimi me krimet që i ka ndaluar Allahu. Kjo karakteristikë është e qartë: ka një pasqyrim në lidhje me të shprehurit në Sheriat dhe në ligjet pozitive.

Nga ana tjetër, shohim që Islami e ndalon bisedën lidhur me jetën e veçantë të njerëzve. Mirëpo, meqë nuk është konform Kodit penal për ndëshkim, i mbështetur në ndodhi reale që do të konsiderohej krim sipas kuptimit të Sheriatit për faktin se krimet sipas fesë duhet të zbulohen, të pengohen dhe shqiptimi i dënimit përkatës të japë rezultat, sepse është nga lloji (i veprave) të neveritshme që duhet vazhdimisht të ndalohet dhe të mos mundësohet një gjë e tillë, duke e bërë publike për njerëz. Një gjë e tillë duhet të ishte në kuadër të kriterëve vijuese:

Veprimi të ishte i mbështetur tek individ i caktuar dhe që veprimi paraqet kundërvajtje sipas Sheriatit, të ishte i qartë dhe publik, siç është kryerja e krimeve dhe ndalesave të Sheriatit.

Vepra e kryer, përkatësisht krimi të ishte aktual, i pavjetruar dhe të fillojnë njerëzit ta harrojnë, për faktin se më nuk lejohet publikimi, për ç'gjë ekzistojnë ajete kur'anore që flasin lidhur me këtë dispozitë.

Vepra (krimi) të ishte bërë në mënyrë publike, sepse ajo që kryhet fshehurazi ndalohet të publikohet dhe të nxirret sheshazi. Lidhur me këtë në Kur'an theksohet: "Allahu nuk do

publikimin e shprehjeve të këqija, përveç (publikimit) të atij që i është bërë padrejtësi. Allahu është dëgjues, i dijshtëm." (Kur'an, 2:148)

Jurisprudenca Islame (Sheriati) në mënyrë të fuqishme e mbron nderin dhe në asnjë mënyrë nuk lejon që ai të atakohet, pavarësisht miratimit të domosdoshmërisë së zbulimit të krimeve.

Nga vlerat kryesore në mendimin islam është vlera e drejtësisë, barazisë, favorizimit (interesit), lirisë etj. Gjëra këto që kanë pozicionin kryesor në mendimin islam, ashtu që nuk kanë shok pas mendimit perëndimor me të cilat lidhen parimet e mendimit perëndimor, duke hulumtuar diç që i ngjason asaj në Sheriatin Islam.

Pasionet e shumta nga urrejtësit drejtuar Islamit janë të tilla, të paargumentuara, por që e ngacmojnë temën e të drejtave të njeriut në Islam. Realisht, ne po trajtojnë çështjen e të drejtave të njeriut në Islam për shumë arsye:

Me qëllim të koncentrimit dhe thellimit të studimeve bashkëkohore, të cilat shprehin interesim për të drejtat e njeriut dhe liritë e tij, duke bërë të qarta argumentet e Jurisprudencës Islame ku bazohen ato të drejta, me të vetmin qëllim që të përfitojnë fuqi më të madhe. Siç dihet, shkelja e rregullave fetare dhe ndëshkimi fetar i paraparë për kundërvajtje, ndërkohë, është ndëshkim i botës së amshuar. Si bazë, krahas asaj, ngërthen edhe dënim të kësaj bote. Dënimi nëse influencohet nga besimi (bindja) e njeriut dhe nga gjymtyrët e tij, është më i efektshëm dhe përballohet vetëm me ndikimin e dënimit të kësaj bote.

Ekzistojnë të drejta distante të njeriut, të cilat nuk janë përmendur as nuk janë shpallur në kodet e të drejtave të njeriut, krahas aspekteve materiale, morale dhe kulturore. Mbështetja e aspekteve të lirisë është në konflikt të vazhdueshëm midis saj dhe autoriteteve që i mbështesin të drejtat e njeriut dhe asaj i japin

garanci të qarta. Domosdo, të pranojmë që nga ky moment liderët (udhëheqësit) e shteteve islame nuk i respektojnë shumë të drejta të njeriut, favorizojnë keqtrajtimin duke e keqpërdor autoritetin (pozitën) në ballafaqimin me të bëjnë veprime kundër aksioneve të opozitës për liritë e tyre dhe të drejtat e tyre politike. Rrebeshi i këtyre të drejtave me veprime të arrestimeve, burgimeve arbitrare, limitimi i të drejtave të gjitha këto veprime bien ndesh me parimet fetare, morale dhe ligjore.

Përgjigja ndaj atyre që ushtrojnë dhunë në emër të të drejtave të njeriut dhe lirisë së tyre për interesa të veta, duke ushtruar dhunë me kriteret e dyfishta gjatë bashkëpunimit me shtete dhe popuj mbi parimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, shfrytëzimi i boshllëqeve që shfaqen midis fjalëve dhe veprave, vijnë nga ata sundues (të shtetit islam) të cilët kanë për qëllim që diskreditohet Islami njësoj sikurse ai që është kundër të drejtave dhe lirive të njeriut. Pothuajse çdo ditë jemi dëshmitarë të rasteve reale të këtilla në shtetet islame e më gjerë.

Islami bazohet në sistemin e të urdhëruarit në të mirë dhe ndalimi nga e keqja dhe e shëmtuara. Ngaqë shihet se me këtë vepër madhore duhet të merret një grup kulmor nga radhët e muslimanëve. Prandaj Islami ka ngritur gjykata dhe institucione për shqyrtimin e padrejtësive dhe arritjen e drejtësisë.

Që nga shekulli i kaluar jemi dëshmitarë të një zgjimi islam, i cili thërret në atë, në rikthimin të rrënja ose të zanafilla. Ndërkohë, thërret në aplikimin e Sheriatit islam në jetën e muslimanëve, që i përket çështjes së besimit dhe çështjes juridike. Mirëpo, kjo thirrje shumë herë kontestohet me pretekstet amerikane dhe evropiane, të cilat aspirojnë që e gjithë bota t'i ndjekë. Angazhohen duke bërë përpjekje të eliminojnë çdo botëkuptim dhe qytetërim që i kundërvihet. Ashtu që krijuan

vlerat e veta në gjithë botën. Shkaktuan atë siç e cilësuan Islamin *fundamental* si armik të atyre vlerave. Jo për diç tjetër, por për shkak të përpjekjeve të dominimit, veprimeve dominuese dhe shkaktimit të fatkeqësisë ndaj pasurisë së shteteve islame.

Jurisprudenca islame, përkatësisht, Sheriati islam, thërret në tolerancë, në mirësi dhe drejtësi me të tjerët, përkatësisht ndaj atyre që kanë fe ndryshe prej tonës. Një gjë e këtillë është në kundërshtim me atë që e etiketojnë Fenë Islame si fe terroriste.

Duke u stolisur ne me këto vlera dhe mirësi në bashkëveprim me të tjerët. Mirëpo, kjo nuk do të thotë që ne të zhvishemi ose të dalim nga besimi ose bindja dhe fundamentet e jurisprudencës sonë. Në asnjë mënyrë, absolutisht nuk do të thotë kjo që ne t'i ndjekim ata njerëz në çdo gjë që ata bëjnë. Për atë se nevojitet që ne të ruajmë veten, të ruajmë fenë, besimin, jurisprudencën, trashëgiminë dhe qytetërimin tonë. Ngase, ndarja jonë nga gjërat e tilla do të thotë vdekje. Ndërkohë, kjo do të thotë humbje për gjithë njerëzimin i parimeve, i eksperiencave, i vlerave produktive që u adresohen mendjeve të botës, të cilat qëndrojnë përballë egoizmit, keqtrajtimit gjatë realizimit të së drejtës, që bëjnë të pavlefshme gjërat e kota, duke mbrojtur kështu njeriun nga çdo e keqe dhe punë e dëmshme.

ISLAMI NUK THËRRET NË RADIKALIZËM

Nga gjërat e dyshimta kundër Islamit, me të cilat ndeshemi sot, është se Islami gjoja thërret në radikalizëm dhe dhunë, mirëpo e kundërta e gjithë kësaj është e vërtetë.

Islami është fe e urtësisë dhe e tolerancës. Ajo thërret në drejtësi dhe paqe, si dhe mbron jetën dhe dinjitetin e njeriut. Këto nuk janë vetëm parulla që i ngre Islami, por janë parime themelore të thella, mbi të cilat është ngritur Islami.

Allahu xh.sh. e dërgoi Muhamedin a.s., mëshirë për të gjitha botët, ndërsa Muhamedi a.s. e ka cilësuar mesazhin e tij duke thënë: "Jam dërguar që t'i plotësoj virtytet e larta morale". Gjithashtu, Islami i dhuroi njeriut të drejtën e zgjedhjes, qoftë edhe në çështjet e besimit. Allahu xh.sh. thotë: "...kush të dojë, le të besojë; e kush të dojë, le të mohojë..." El-Kehf: 29

Thirrje për në Islam mbi urtësinë, këshillimin me të mirë dhe polemizimin me të mirë e jo mbi dhunë dhe imponim. Po ashtu, Islami urdhëron në bamirësi dhe drejtësi dhe ndalon nga imoraliteti, nga gjërat e neveritura, dhuna dhe shkatërrimi mbi tokë. Ai kërkon që e keqja të përballohet me të mirë. Përkundër asaj që përjetoj i Dërguari i Allahut dhe shokët e tij nga banorët e Mekës, duke ushtruar mbi ta dhunë, vrasje, maltretime etj., prapëseprapë ai në ditën e çlirimit të Mekës atyre u tha: "Shkoni, se jeni të lirë".

Ka një lidhshmëri të ngushtë midis Islamit dhe paqes. Fjala Islam në origjinë rrjedh nga e njëjta fjalë që rrjedh prej saj edhe fjala selam (paqe). Allahu i Madhërishtëm në Kur'anin Famëllartë e ka cilësuar veten se është Selam (paqe). Përhëndetja e muslimanëve është selami (paqja), me qëllim që vazhdimisht t'ua përkujtojë muslimanëve se selami (paqja) është pikësynim kryesor që nuk duhet harruar.

Muslimani pesë herë në ditë në fund të faljes së namazit i drejtohet gjysmës së botës nga ana e djathtë duke i përshëndetur me selam (paqe); më pas i drejtohet nga ana e majtë gjysmës tjetër, gjë që simbolizon se muslimanët lutën për paqe për mbarë botën.

Nga e gjithë kjo, shihet qartë aspekti paqësor i Islamit. Në këtë fe nuk ka vend për dhunë, ekstremizëm, racizëm, terrorizëm, frikësimin e atyre që jetojnë në siguri e as sulm ndaj jetës dhe pasurisë së njerëzve. Pikësynimet e Sheriatit përfshihen në mbrojtjen e të drejtave elementare të njeriut, e në veçanti mbrojtjen e fesë,

mendjes, familjes dhe pasurisë. Për këtë, Islami ka ndaluar dëmtimin e të tjerëve me të gjitha format, deri në atë shkallë saqë dëmtimin e një individi e ka llogaritur si dëmtim të mbarë njerëzisë. Allahu thotë: "...kush e mbytur një njeri (pa të drejtë), pa pasë mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa pasë bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si t'i kishte mbytur gjithë njerëzit. E kush e ngjall (bëhet shkak që të jetë i gjallë), është si t'i kishte ngjallur (shpëtuar) të gjithë njerëzit" El-Maide: 32. Çdo individ përfaqëson njerëzimin në personalitetin e tij.

Ky njerëzim, për të cilën Islami është përkujdesur ta mbrojë, përfshin respektimin e çdo individi ndaj të tjerëve: respektimin e lirisë, dinjitetit dhe të gjitha të drejtave të tij. Transmetohet në një hadith se Muhamedi a.s. ka thënë: "I tërë muslimani për muslimanin është haram: gjaku, pasuria dhe nderi i tij". Në një hadith tjetër thuhet: "Nuk lejohet që muslimani ta frikësojë muslimanin".

Gjithashtu, Islami thërret për bashkëjetesë paqësore mes popujve dhe thërret në sjellje ndaj jomuslimanëve me drejtësi. Allahu xh.sh. thotë: "Allahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja; Allahu i do ata që mbajnë drejtësi". El-Mimtehine: 8. Përgjegjësia e përkujdesjes për sigurinë e qytetarëve është përgjegjësi e përbashkët e gjithë njerëzve. Bartja e kësaj përgjegjësie është rrugë për sigurim përballë rreziqeve të korrupsionit dhe gjakderdhjeve.

Përgjigja jonë ndaj atyre që akuzojnë Islamin se është fe terrorizmi dhe racizmi përfshihet në këto pika:

Islami është fe që absolutisht nuk njeht racizmin. Në bazë të kësaj, ai nuk thërret ithtarët e tij në racizëm. Burimet islame të përfshira në Kur'an dhe Sunnet nuk përfshijnë diç të tillë. Thirrja për në Islam, siç e potencon edhe Kur'ani, ngrihet mbi bazën e urtësisë, këshillimit

me të mirë dhe polemizimit me të mirë. Këto metoda janë plotësisht larg çdo lloji prej llojeve të racizmit. Muhamedi a.s. u thoshte banorëve të Mekës pasi refuzuan thirrjen e tij për në Islam, siç e potencon Kur'ani: "Ju keni fenë tuaj, e unë kam fenë time". El Kafirun: 6.

Sa u përket feve qiellore të mëhershme, duhet ditur se Islami besimin në Pejgamberët e mëhershëm e llogarit element bazë të besimit të muslimanit. Këtë e potencon Allahu xh.sh. në Kur'anin Famëlartë: "Ju thuani: Ne i besuam Allahut, atë që na u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe pasardhësve, atë që i ëshë dhënë Musait, Isait, dhe atë që iu është dhënë nga loti i tyre Pejgamberëve; ne nuk bëjmë dallim të asnjërit prej tyre dhe ne vetëm atij i jemi bindur" El-Bakare: 136. Qëndrimi i Islamit ndaj gjithë pejgamberëve është se nuk bën dallim mes asnjërit prej tyre. Kjo është një tolerancë fetare e pashoqe tek ithtarët e asnjë feje prej feve. Andaj, a ka hapësirë për racizëm në çfarëdo forme në mësimet e fesë islame?!

Islami thërret gjithë njerëzit për afërsi dhe njohje mes vetie, krahas dallimeve që ekzistojnë mes tyre. Allahu xh.sh. thotë: "O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete..." El Huxhurat: 13. Gjithashtu, Islami qartë i thërret muslimanët për bashkëjetesë paqësore me jomuslimanët. Allahu xh.sh. thotë: "Allahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja; Allahu i do ata që mbajnë drejtësi". El Mimtehine: 8

Islami është fe që thërret për falje. Allahu xh.sh. thotë: "...e nëse falni, ajo është më afër devotshmërisë..." El Bakare: 237. Islami thërret që të keqes t'i kundërvihet me të mirë, me

qëllim që armiku të shndërrohet në mik. Allahu xh.sh. thotë: "Nuk është e barabartë e mira dhe e keqja. Andaj, (të keqen) ktheje në mënyrën më të mirë, se atëherë ai, me të cilin kishit njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt" Fussilet: 34. Në hadith thuhet: "Lehtësoni e mos vështirësoni, përgëzoni e mos largoni". Kjo është një thirrje për të lënë racizmin, sepse largimi lind nga racizmi, ndërsa përgëzimi lind nga toleranca. Nëse Islami refuzon racizmin, ai me këtë refuzon edhe terrorizmin, ekstremizmin, frikësimin e njerëzve të sigurt dhe vrasjen e të tjerëve.

Bazuar në gjithë këtë që u tha më lart, mund të thuhet se akuzimi i Islamit me racizëm nuk mban fare dhe nuk ka asnjë mbështetje. Nëse në mesin e muslimanëve gjenden disa ekstremistë, kjo në asnjë mënyrë nuk ka mbështetje në mësimet islame, por mbështetet në të kuptuarit e gabuar dhe komentimin e pabazë të mësimëve islame. Islami nuk e bart këtë faj. Andaj, duhet bërë dallim mes mësimëve islame tolerante dhe sjelljeve të gabueshme të disa muslimanëve. Nga ana tjetër, vërejmë se racizmi ekziston te disa grupe në gjitha fetë. Terrorizmi është bërë një dukuri botërore, me të cilën nuk veçohen ithtarët e njëres fe nga fetë tjera. Ky është një realitet që e shohin të gjithë në botën bashkëkohore. Vallë, a Islami është ai që e solli këtë dukuri botërore në mesin e ithtarëve të të gjitha feve?!

Në fund, për të gjithë është e qartë se Islami është duke zhvilluar betejat të njëpasnjëshme kundër batilit (të pavërtetës), i cili bën përpjekje për të shlyer të gjitha shenjat e të vërtetës, të cilat i solli Muhamedi a.s. me mesazhin islam dhe shpalli para gjithë njerëzve se fjala e fundit mbi tokë është e fesë së Allahut, pa mohuar asnjërin nga pejgamberët e Allahut e as librat

që u janë shpallur atyre, si dhe pa detyruar asnjë nga ithtarët e feve qiellore që të pranojnë Islamit. Islami nuk ka mjaftuar vetëm me këtë, por ka bërë besimin në gjithë pejgamberët dhe librat e tyre bazë se besimi i çdo muslimani nuk pranohet pa to. Ky qëndrim tolerant i Islamit ndaj feve të tjera duhet të përballet me tolerancë të ngjashme nga ana tjetër dhe të zvogëlojë numrin e atyre që kundërshtojnë Islamit. Mirëpo, ajo që ndodh është e kundërta e kësaj. Vërejmë se Islami gjatë tërë historisë së tij është sulmuar ashpër nga të gjitha anët. Nuk ka në botë sot ndonjë fe që sulmohet siç sulmohet Islami në mjetet e informimit, duke i bërë padrejtësi dhe shpifje të rrejshme.

Atë që e shohim sot te të gjitha shpifjet dhe dilemat ndaj Islamit, janë po ato, të njëjtat dhe të përsëriturat prej më herët dhe nuk dallojnë mes vete përpos në metoda dhe forma ose duke bërë përpjekje që t'u mvishet forma shkencore. Por, duke falënderuar Allahun, shumë prej mendimtarëve islamë në periudha të ndryshme iu kanë kundërvënë këtyre të pavërtetave, secili me formën dhe metodën që mendon se është më e drejtë, tha në fund të Konferencës së Kajros h. Sulejman ef. Rexhepi, Kryetar i Bashkësisë Fetare Islame në Republikën e Maqedonisë.


Literatura:

- 1-قرآن الكريم
2- صحیح البخاری ومسلم
3- الإسلام وحقوق الإنسان للدكتور جعفر بن عبد السلام
4- الإسلام في مواجهة الإرهاب - رابطة الجامعات الإسلامية
5- الإسلام وحقوق المرأة للدكتور جعفر بن عبد السلام
6- حقائق إسلامية للدكتور محمود حمدي زقزوق

(Fjalimi i Reis ul Ulema i Bashkësisë Fetare Islame, H. Sulejman ef. Rexhepi në Konferencën e Lartë për Çështje Islame të mbajtur prej 22 deri më 25. 02. 2010, në Kajro të Egjiptit).

Penguesi e vazhdon pengimin e DENACIONALIZIMIT

Kjo ofertë e Qeverisë për të dalë nga kriza duke ndryshuar Ligjin e denacionalizimit, duke i dhënë shpesh vetes nota triumfaliste, në thelb nuk mund të jetë asgjë tjetër përveçse një cinizëm ordiner maqedonas dhe mjerim i tejskajshëm i politikës shqiptare që bashkëqeveris Maqedoninë. Prej kësaj nuk mund të amnistohen edhe bashkëqeveritarët turq, romë, torbeshë, të gjithë që i përkasin thirrjes islame




DRITON DIKENA

Ndonëse në masat e fundit antikrizë të Qeverisë Gruevski ishte propozuar për ndryshim, në parim, edhe Ligji për denacionalizim, hartimi i dobët i vetë masës së propozuar dhe ndeshja që krijohet me Kushtetutën dhe disa ligje të tjera, pa dyshim se kërkon karton të kuq para se të fillojë punën Komisioni funksional i ngarkuar për shqyrtimin e kësaj mase për ta shndërruar në një draft-version, të cilin do t'ua çonin 'selam' deputetëve të Maqedonisë si propozimligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për denacionalizim.

Masa parashikon "Ndryshimet në Ligjin e denacionalizimit; në fakt, shkurtimin e procedurës, si dhe procedurat e tjera administrative të fitojnë plotfuqishmëri me vendim të Komisionit të denacionalizimit të shkallës së dytë".

Kjo do të thotë që Komisioni i denacionalizimit i shkallës së dytë, që funksionon në kuadër të Qeverisë së Maqedonisë, të thotë 'aminin' përfundimtar për të gjitha, me qindra, kërkesa të Bashkësisë Fetare Islame, e cila kërkon kthimin e 3.869.806,00 m2 tokë (përfshi këtu livadhe, ara, kullota, male etj.) dhe të 41.258 m2 objekte (përfshi banesa, shtëpi dhe dyqane).



Një "leges specialis", siç është Ligji për denacionalizim, që rregullon një materie esenciale të marrëdhënieve pronësore – juridike, në kontekst të kompetencës së caktuar, ndërmerr veprime me qëllim të mbrojtjes së qytetarëve, aplikohet procedura administrative për shqyrtimin dhe vendimmarrjen, fjalën e fundit pa dyshim se duhet ta ketë Gjykata Administrative, kompetente për këto çështje, duke zbatuar drejtpërdrejt normat në raste konkrete, me çka nga njëra anë realizon mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të qytetarëve dhe subjekteve të tjera, kurse nga ana tjetër mbron interesin publik.

Nëse kjo është një rregull e përgjithshme, e cila, si e tillë, është pranuar që nga Kodifikimi i Justinianit e këtej dhe në bazë të saj janë ndërtuar të gjitha sistemet juridike, pavarësisht provinencës, përfshi këtu edhe sistemin juridik maqedonas, atëherë të çudit fakti sesi Qeveria e Maqedonisë po merr timonin e ndërtimit të sistemeve të reja juridike. Absurditet i llojit të veçantë!

Nëse Qeveria Gruevski do të dëshironte që denacionalizimi të mos rëndonte buxhetin e shtetit, atëherë mjafton që të "kapet për veshi" Sekretari i përgjithshëm i Qeverisë, i cili njëkohësisht është edhe këshilltar i kryeministrit, por edhe kryetar i Komisionit të shkallë së dytë, dhe prej tij të kërkohet që të vendosë për çështjet e denacionalizimit duke pasur për bazë dëshminë dhe arsyen e jo islamofobinë e subjektivitetin.

Deri tani organi për denacionalizim i Qeverisë thuhet fare nuk u është përmbajtur dhe nuk i ka respektuar afatet për marrjen e vendimit sipas kërkesave të paraqitura. Ky komision deri tani ka qenë dëshmi joefektiviteti, joracionaliteti, jofunksionaliteti dhe e moskryerje me kohë të punëve, me tendencë të theksuar për pengimin e realizimit të të drejtave dhe interesave të drejtpërdrejta ligjore të BFI-së. Komisionerët, një dyzinë dirigjentësh, muzikologësh, artistësh, profesorësh me në krye politikologun pa asnjë ditë përvojë pune në çështjet ju-

ridike, me punën e tyre deri tani kanë treguar një avashllëk, burokraci të theksuar dhe shkallë të lartë të subjektivitetit gjatë procesit të denacionalizimit, kanë treguar një sjellje jokoooperative dhe joprofesionale me BFI-në, që ka shkaktuar pasoja të dëmshme për vetë vakëfin.

Atëherë, nëse ky komision duhet të thotë 'aminin' e fundit për kërkesat e BFI-së dhe të mbetet instanca e fundit në këtë procedurë administrative, BFI nuk do të mund t'i mbrojë të drejtat e veta shekullore mbi pronën përpara Gjykatës Administrative dhe në instancat më të larta dhe me këtë përsëri do të ndodhë të kryhet edhe një nacionalizim i pronës së muslimanëve në vend. Ndryshimi i propozuar nuk mund të ketë arsye juridike, por politike.

Nëse kjo juridikisht nuk shkon, atëherë cila është prapavija e një qëndrimi të këtyllë që merret si masë antikrizë? Cilin ka kapur kriza - juristët e Qeverisë apo kryeministrin Nikolla Gruevski? Pavarësisht, dikush ka nevojë për terapi mjekësore!

Nëse aspekti juridik bie në ujë, atëherë si rregull në eterin e këtij shteti vjen në shprehje aspekti politik i kësaj mase antikrizë, që mëton të nxjerrë kriza o të fut në krizë shtetin e vogël të Ballkanit që 'e ka humbur rrugën në oborrin e vet' me politikën e vet të përdalë.

Kjo ofertë e Qeverisë për të dalë nga kriza duke ndryshuar Ligjin e denacionalizimit, duke i dhënë shpesh vetes nota triumfaliste, në thelb nuk mund të jetë asgjë tjetër përveçse një cinizëm ordiner maqedonas dhe mjerim i tejskajshëm i politikës shqiptare që bashkëqeveris Maqedoninë.

Në politikë gjysmë të vërtetat kanë rol parësor në krijimin e të ashtuquajturës provinencë politike. Politikanët janë virtuozë në krijimin e një teorie politike mbi bazë të gjysmë të vërtetave, për të mos thënë të gënjeshtrove. Në këtë rast Qeveria këto ndryshime të Ligjit të denacionalizimit i bën me vetëdije cinike, me tendencë të qartë që të manipulojë me opinionin, ndërkaq shqiptarët, participantë në pushtet,

këtë e bëjnë për shkak të mungesës së informatave, injorancës a edhe të natyrave të tjera, të cilat gjithsesi i përkasin nivelit të ulët të vetëdijes kolektive. Prej kësaj nuk mund të amnistohen edhe bashkëqeveritarët turq, romë, torbeshë, të gjithë që i përkasin thirrjes islame. Te këta të fundit dhe te shqiptarët kohëve të fundit në politikë shpesh është treguar një gatishmëri e pafat për t'i toleruar me vetëdije gjysmë të vërtetat

(enciklopedia, 'Shkupi 2014', gjuha maqedonase për shqiptarët, evidenca pedagogjike) apo ndonjë gënjeshtër optimiste (do të ketë edhe përmendore të personaliteteve shqiptare në Sheshin e Shkupit), me qëllim që të qetësojnë shpirtat nga dyshimet vrastare.

Motivet politike të kësaj mase antikrizë synojnë qartë të ngrenë kredibilitetin politik të një partie apo të një qeverie që ka filluar të humbë toruan në hapësirë dhe kohë.

Në fakt, edhe Ligji i denacionalizimit, kështu siç është, nuk e ka as formën e ligjit, meqë më shumë përhap konfuzion sesa rregullon një materie që tani e 10 vjet është bërë burim fërkimesh.

Guximi i Qeverisë së Gruevskit për të përhapur bindjen se me ndryshimet e fundit të Ligjit të denacionalizimit, si masë antikrizë, Maqedonia do të dalë nga recesioni ekonomik që ka e kapluar vendin nga pavarësimi e këtej, flet për mospërfillje arrogante të aftësisë së popullit për të kuptuar gënjeshtërën e saj dhe vetë pasojat. Nuk duhet shumë mend që të kuptohet se edhe me këtë ligj Bashkësisë Fetare Islame nuk është duke iu kthyer prona e nacionalizuar nga shteti, mirëpo ndryshimet që planifikon Qeveria t'i bëjë në vete ngërthejnë shpirtngushtësi edhe më të madhe, që është dhe strategji e palës maqedonase, lidhur me kërkesat e BFI-së.

E përballur me kërkesat e arsyeshme të BFI-së, e vetëdijshme që nuk mund t'i ikë plotësisht të tyre, ajo ka zgjedhur mënyrën se si të ofrojë zgjidhje cinike, që në realitet do të thotë moszgjdhje.

INTERVISTË ME SEKRETARIN E MUFTINISË SË BFI SHKUP
SKENDER BUZAKUN DHËNË RADIO SHKUPIT MË 19-03-2010

Prona të kthehet me urgjencë



“Nuk mund të ketë revitalizim të Çarshisë së vjetër të Shkupit, derisa nuk përfundon denacionalizimi total i pronave të BFI-së në RM të cilat gjenden në territorin e Çarshisë së Vjetër të Shkupit”



1. z. Buzaku jeni anëtar i Komitetit për revitalizimin e Çarshisë së Vjetër të Shkupit pranë Ministrisë së Kulturës, prej sa anëtarë përbëhet ky komision dhe cili është roli i tij?

Së pari dëshiroj të theksoj se duke patur parasysh se BFI është Institucioni që posedon pjesën dërmuese të pronave të Çarshisë së Vjetër të Shkupit nëse bazohemi në realitetin objektiv, mund të themi se në asnjë mënyrë Institucioni jonë nuk është e drejtë që në këtë komitet të përfaqësohet vetëm me një përfaqësues, d.m.th jemi të barazuar me Kishën Ortodokse Maqedone e cila në Çarshinë e Vjetër të Shkupit ka një objekt fetar dhe dy apo tre lokale tjera.

Në Komitetin për revitalizimin e Çarshisë së Vjetër të Shkupit përveç Institucionit të Bashkësisë Fetare Islame në RM participon edhe Kryetari Komunës së Çairit, Kryetari i Komunës së Qendrës-Shkup, Kryetari i qytetit të Shkupit, përfaqësues nga sektori civil, përfaqësues nga Qendra për konzervim, përfaqësues nga Drejtoria për ruajtjen e trashëgimisë kulturore pranë Ministrisë së Kulturës, si dhe përfaqësues nga Kisha Ortodokse Maqedone.

Ky komitet i formuar pranë Ministrisë së Kulturës do të ketë disa role duke filluar nga ajo se do të sintetizon ide në nivel lokal, do të miratojë plane akcionale, do të monitorojë zhvillimin e aktiviteteve dhe punëve nëpër tri fazat, do të bisedoj për plane dhe buxhetin me Ministrinë e Kulturës, do t'i bëjë raport Ministrisë së Kulturës, dhe krejt në fund do të nominoj projekt lider dhe anëtarët e këshillit për implemetim.

2. Problemet më të mëdha paraqiten te pronat e BFI-së në RM. çfarë ndërrmerni ju për zgjidhjen dhe evitimin e këtyre pengesave?

Po është e vërtetë kjo dukuri në lidhje me pronat e Bashkësisë Fetare Islame në RM, mirëpo kjo nuk është si pasojë e fajëve tona, por si pasojë e interesave të qarqeve të ndryshme të cilat me çdo kusht tentojnë që të bëjnë çmos për asgjësimin dhe grabitjen e të njëjtave pa kurrsyer asnjë mjet dhe metodë.

Padrejtësitë të cilat në një kohë i bëri pushteti serb e më pastaj ai komunist, tanimë vazhdojnë të bëhen nga një pushtet i ashtuquajtur demokratik i cili jo vetëm që bënë opstrukcione më tepër se dhjetë vite në kthimin e pronave tona, por edhe dëshiron që nëpërmjet mekanizave të ndryshëm të bllokujë, pro-

longojë dhe nëpërkëmbë pronat e myslimanëve të cilët paraardhësit-vakëflënësit tonë mysliman me plotbesimin ia kishin besuar institucionit të BFI-së në RM. mirëmbajtjen dhe menaxhimin e tyre.

Në këtë aspekt vlen të theksohet se forma e ligjit për denacionalizimin e pronave tejmasë dëmton Institucionin e BFI-së në RM, duke patur parasysh se shumë objekte për të cilat jemi në proces të denacionalizimit sot shërbejnë si objekte që i shërbejnë interesit të përgjithshëm të shtetit dhe se sipas ligjit të njëjtat shteti mund nuk mund t'i kthejë, por mund të ofrojë kompenzim maksimalim prej 2.000 (dy mijë denarë) për 1m². Domethënë, është një absurditet i dukshëm dhe grabitje moderne që po u bëhet pronave tona sepse pesëdhjetë vite të njëjtat janë shfrytëzuar nga ana e shtetit pa asnjë kompenzim, kurse tani ofrohet një kompenzim qesharak që nuk përbush as 1% të vlerësimit dhe kompenzimit real të të njëjtave.

Në këtë drejtim vlen të theksohet edhe ajo se partia politike shqipatare e cila ka participuar në pushtet në kohën kur është sjellur ky ligj nuk ka qenë sa duhet e kujdesshme për të cilën gjë e themi me keqardhje se në mënyrë direkte apo indirekte, me vetëdije apo pa vetëdije ka kontribuar në sjelljen dhe implemen-

timin e këtij ligji shumë të dëmshëm për Institucionin e Bashkësisë Fetare Islame në RM.

Ne si Institucion i Bashkësisë Fetare Islame në RM në kohë të duhur kemi bërë kërkesë me dokumentacion të kompletuar për të gjitha lëndët të cilat nga pushteti i atëhershëm monist ishin marrur dhe grabitur në mënyrë të paligjshme.

Si pakënaqësi e neglizhencës së organeve shtetërore në kthimin e pronave, Institucioni ynë ka njoftuar faktorët e jashtëm dhe të brendshëm si dhe ka organizuar disa press konferenca përmes së cilave ka informuar opinionin e gjërë.

3. Denacionalizimi i pronave duhet të bëhet sa më parë. Sipas jush, si janë duke rrjedhur punët dhe a mendoni se ka obstrukcione në lidhje me këtë gjë?

Denacionalizimi i pronave të Bashkësisë Fetare Islame në RM është proces që ka filluar para shumë viteve dhe nuk dinë se si të përfundoj, jo nga fakti se subjektet kompetente në lidhje me këtë gjë janë shumë të brengosura por, mundohen që me prolongimin e afateve të gjejnë ndonjë zbrazëti juridike apo moment politik i cili do të ishte në favor të pushtetit Maqedon duke mos marrë parasysh se dëmtohet pala e cila është pronarë shekullor i këtyre pronave.

Prandaj, kur është fjala për denacionalizimin e pronave të BFI-së në RM, institucionet qeveritare këtë gjë menjëherë e paraqesin si çështje të dhimbshme dhe problematike duke bërë arsyetime të ndryshme që nuk kanë asnjë bazë juridike e morale.

Problemi tjetër qëndron në atë se tani në lidhje me denacionalizimin e pronave veprojnë dy komisione, komisioni i shkallës së parë dhe komisioni i shkallës së dytë.

Komisioni i shkallës së parë mund të themi se është një komision më transparent dhe më i pavarur në sjelljen e vendimeve, kurse komisioni i tanishëm i shkallës së dytë përbën një komision tjesht që ka ndikim direkt nga Qeveria dhe se i njëjti më tepër përbëhet nga njerëz të politikës se sa prej ekspertëve të cilët në mënyrë të pavarur do të punonin dhe merrnin vendime të pavarura në lidhje me lëndët e denacionalizimit të pronave të Bashkësisë Fetare Is-

lame në RM.

Pengesë tjetër që me vite të tëra po e zvarrit procesin e kthimit të pronave të Institucionit tonë fetar është ajo se pas çdo vendimi pozitiv të komisioneve, pason ankesa e avokatit të shtetit dhe lëndët i kthenë në rishqyrtim.

Prandaj kemi shumë raste kur për një lëndë komisioni i shkallës së parë na kthen vendim pozitiv, pas ankesës së Avokatit të shtetit lënda kalon te komisioni i shkallës së dytë, më pastaj ne si institucion ankohe mi te gjykata administrative dhe nga e njëjta gjykatë kjo lëndë na kthehet pozitive dhe ashtu pra kjo procedurë dhe sistem i punës së organeve tona ka kontribuar që lëndët tona të denacionalizimit të zvarriten disa vite me rradhë.

Pra vlen të theksohet fakti se subjekti i cili më së shumti dëmtohet në këtë vonesë pa dyshim se është Institucioni i Bashkësisë Fetare Islame në RM

4. Cilat prona duhet t'i kthehen BFI-së dhe a i posedoni të gjitha dokumentet e duhura?

Pronat të cilat Bashkësisë Fetare Islame duhet t'i kthehen me proceset e denacionalizimit në Çarshinë e Vjetër të Shkupit janë: Suli Hani, Kapan, Hani, Bezisteni, Teatri i fëmijëve, si dhe një pjesë dërmuese e lokaleve afariste të cilat gjenden në Çarshinë e Vjetër të Shkupit.

Sa i takon dokumentacionin në lidhje me këto lëndë kuptohet se ne si Institucion disponojmë me tërë dokumentacionin e duhur duke filluar prej Tapive dhe vendimeve me anë të të cilave të njëjtat i janë marrur institucionit tonë me formën e nacionalizimit.

Prandaj, edhe raporti i komisionit European i shpallur për vitin 2009 e që flet për përparimin e Maqedonisë drejt proceseve evrointegruese, në mënyrë direkte flet për shumë ngecje dhe anashkalime që bëhen nga institucionet dhe organet gjyqësore të vendit në lidhje me kthimin e pronave.

Në të me theks të veçantë thuhet se pjesa dërmuese e pronave të BFI-së nuk i janë kthyer këtij Institucioni, dhe çka është më e keqja ky proces ende vazhdon të prolongohet dhe zvarritet nga organet shtetërore me

anë të së cilës bëhen cenime serioze në mosrespektimin e të drejtave dhe lirive elementare të njeriut dhe qytetarit, për të cilën gjë BFI shumë herë ka shprehur shqetësimet e veta faktorit të brendshëm dhe atij të jashtëm.

5. Çarshia e Vjetër e Shkupit konsiderohet si shesh i të gjithë qytetarëve, ndërsa sheshi i Shkupit i takon komunës Qendër-Shkup. Si e vlerësoni një gjë të tillë a ka diskriminim në Maqedoni?

Pikërisht këtu dëshiroj që të ndërlihem me faktin që me ligjin për revitalizimin e Çarshisë së Vjetër të Shkupit përpos komunë së Çairit janë të përfshira edhe komuna Qendër-Shkup, qyteti i Shkupit si dhe institucione dhe organe tjera.

Nëse shikojmë më hollësisht do të vërejmë se Projekti 2014 është një projekt qeveritar monoetnik, momofetar dhe monokulturor i financiar nga Qeveria aktuale e cila me çdo kusht tenton që të anashkalojë përfshirjen e rindërtimit të Xhamisë së Burmalisë në vendin ku ka qenë pesëqind vite

Qeveria e vendit jo vetëm që favorizon Kishën Ortodokse Maqedone duke i dhënë asaj hapësirë prezentimi në çdo solemnitet dhe eveniment por e njëjta merr të drejtën që t'i falë tokën në qendrën e Shkupit e cila asnjëherë nuk ka qenë pronë e KOM-it (që dikush vetëm pse ka parë ëndërr), kurse në anën tjetër së bashku me Komunën Qendër të Shkupit mundohen që të përjashtojnë çdo element fetar dhe kombëtar në këtë projekt famoz.

Mirëpo sido që të jetë me këto hapa që janë duke u bërë në lidhje me Projektin Shkupi 2014 Maqedonia po thellohet në një krizë të tellë me të cilën dukshëm ka përkeqësuar mardhëniet ndëfetarë dhe ndëretnike të cilat mund të eskalojnë në çdo moment.

Bashkësia Fetare Islame në RM me një transparencë mjaft të hapur ka treguar qëndrimet dhe ndikimin e saj në të gjitha organet dhe subjektet brenda dhe jashtë vendit duke iu bërë me dije gjithë faktorëve relevant se Maqedonia mund të ekzistojë vetëm si shtet multifetar, multikulturor dhe multietnik, dhe se çdo koncept tjetër që josh dhe stimulon projekte monoetnike, monofetare

dhe monokulturore paraqesin tendencë serioze për rrënimin e themeleve të këtij shteti multietnik dhe multifetar.

Nëse merret parasysh edhe raporti i State Department para disa ditëve në të cilin thuhet se në Maqedoni në mënyrë drastike nuk respektohen të drejtat dhe liritë fetare dhe se Qeveria e vendit në mënyrë të hapur është duke favorizuar Kishën Ortodokse Maqedone përkundër Bashkësive tjera Fetare, gjë e cila është në kundërshtim me kushtetutën e vendit dhe me të gjitha parimet dhe normat ndërkombëtare.

Ne si Institucion fetar kemi reaguar me kohë të të gjithë faktorët politik në vend dhe jashtë vendit përfshirë këtu edhe partitë tona Shqiptare në pozitë dhe në opozitë, kurse sa ato i kanë kryer obligimet e veta do këtë gjë do ta tregojë koha dhe natyrisht edhe populli.

6. Disa nga objektet Fetare në Çarshi të Vjetër të Shkupit, Ministria e Kulturës tenton që t'i mbrojë si monumente kulturore për të cilën gjë me sa kemi informata ju nuk jeni kundër. Ku paraqitet problemi?

Po është e vërtetë se disa prej monumenteve Islame janë të mbrojtura me ligj nga Ministria e Kulturës këtu bëjnë pjesë, xhami siç (Murat Pasha, Allaxha, Mustafë Pasha, Hatunxhiku, Jahja Pashës, Isa Beut etj, Hane siç (Kapan Hani Suli Hani, Kurshumli Hani), Hamame siç (Daut Pasha, Çifte Hamami) etj.

Mirëpo, duhet ditur një gjë se mbrojtja e këtyre monumnteve Islame nga Ministria e Kulturës nuk e përjashton të drejtën e menaxhimit të të njëjtave nga Bashkësia Fetare Islame në RM. Këtë e themi sepse na është e njohur shumë mirë se xhamitë të cilat janë në këtë kategori menaxhohen ekskluzivisht nga Institucioni i Bashkësisë Fetare Islame në RM, dhe se të njëjtat janë objekte funksionale.

Fakti që shteti dëshiron që disa prej këtyre objekteve të ngelin nën qeverisje të Ministrisë së Kulturës qëndron në atë se këto objekte vitale e me peshë të veçantë shfrytëzohen nga persona dhe individ të cilët kanë interese personale e materiale, dhe se të njëjtit kanë lidhje të ndryshme miqësore dhe farefisnore.

Duhet të kemi parasysh se paraardhësit tonë mysliman kur kishin filluar të ndërtonin një qytet objektet e para të cilat i kishin ndërtuar kanë qenë Xhamia, Hani dhe Hamami.

Kjo është bërë me të vetmin qëllim që të tregohet pastërtia dhe sistemi imoderuar i Islamit ngase kur ndonjë udhëtar apo mysafir kishte vizituar Shkupin ai së pari ishte strehuar dhe pushuar në Han, pastaj kishte vajtur që të pastrohet në Hamam e krejt në fund ka pasur mundësi që të shkojë në xhami dhe të kryej lutjet në gjendje të pastër.

Pra, edhe kur flasim për revitalizimin e Çarshisë së Vjetër të Shkupit duhet të kemi parasysh se ne nuk jemi kundër revitalizimit të Çarshisë së Vjetër të Shkupit apo riaktivizimit dhe funksionimit të këtyre objekteve vitale me peshë, mirëpo, kërkojmë me çdo kusht që të njëjtave t'i kthehet pamja autentike, dmth Hamami të shërbej për pastërti, kurse Hani të shërbejë për pushim, por gjithnjë duke patur parasysh faktin se të njëjtat do të menaxhoheshin dhe administroheshin ekskluzivisht nga Institucioni i Bashkësisë Fetare Islame në R.M, ashtu siç ishin menaxhaur pesë shekuj me rradhë.

7. Çfarë dëmsh u ka sjellë ligji i vitit 2008 për Çarshinë e Vjetër të Shkupit?

Sa i takon ligjit të vitit 2008 i cili ka të bëjë për shpalljen e Çarshisë së Vjetër të Shkupit si një vlerë e veçantë e trashëgimi kulturore, mund të themi se ne si Institucion fetar aspak nuk jemi konsultuar apo pyetur.

Me vetë faktin që ky ligj prej në atë kohë e deri më tani nuk është jetësuar apo implementuar në praktikë, e kemi të njohur parimin e përgjithshëm të jurisprudencës se veprimi i retroaktivitetit të ligjeve lejohet vetëm në rast se ajo është në të mirën dhe dobinë e përgjithshme të qyteatrëve të vendit.

Meqenëse në këtë rast nuk shohim se nga veprimi retroaktiv i këtij ligji kemi dobi të përgjithshme ngase përveç gjërave tjera, me të njëjtin parashihet edhe revitalizimi i Çarshisë së Vjetër të Shkupit d.m.th pa mos u përfillur procedura e denacionalizimit.

Me ligjin në fjalë si dhe planin për

revitalizimin e Çarshisë së Vjetër të Shkupit parashihet që të fillojë revitalizimi pa mbaruar procesi i denacionalizimit detal i pronave tona të cilat gjenden në Çarshinë e Vjetër të Shkupit.

Prandaj, pa kthimin në pronësi të pronave vitale siç janë Kapan Hani, Suli Hani, Bezisteni, Teatri i fëmijëve, si dhe një pjesë e madhe e lokaleve afariste të cilat janë në Çarshinë e Vjetër të Shkupit për fat të keq nuk do të mund të fillojë procesi i revitalizimit të Çarshisë së Vjetër të Shkupit.

Ministria e Kulturës dhe organet tjera pranë Ministrisë së Financave e dinë shumë mirë për të gjitha procedurat të cilat jemi duke i zhvilluar në lidhje me denacionalizimin e pronave të BFI-së, andaj çdo aktrim apo naivitet i shfaqur nga ana e tyre nuk do t'i kontribuojë zhvillimit pozitiv të proceseve demokratike në vendin tonë.

8. z. Buzaku çfarë keni për të shtuar në fund?

Po shikoni ne si Institucion i vetëm fetar këtu në Maqedoni i cili është i thirrur për kultivimin dhe promovimin e vlerave fetare brenda dhe jashtë vendit, do të jemi shumë të kujdesshëm për të gjitha zhvillimet të cilat janë duke ndodhur dhe të cilat në të ardhmen do të ndodhin në Maqedoni, çdo herë duke patur parasysh se nuk do të lejojmë asnjëherë që Institucioni jonë apo besimtarët mysliman të diskriminohen në mënyra dhe forma të ndryshme.

Ne pra, sa i takon kësaj që u tha më lart do t'i qëndrojmë me besnikëri të plotë dhe në asnjë mënyrë nuk do të lejojmë që në Çarshinë e Vjetër të Shkupit të luajmë rolin e një shfaqje teatrale në të cilën si pjesë e kësaj shfaqje do të luanim rolin vetëm të spektatorit dhe nuk do të kishim asnjë role kyq.

Pra, kuptohet objektet vitale të cilat me shekuj kanë qenë pronë dhe janë menaxhaur nga Bashkësia Fetare Islame në RM, do të vazhdojnë të njëjtat të menaxhohen nga ne, në të kundërtën do të detyrohemi që t'i përdorim të gjitha mjetet e duhura në mënyrë që t'i realizojmë dhe jetësojmë të drejtat tona primare si Institucion fetar.

BFIM fton Gruevskin të vizitojë Çarshi-Xhaminë

Nëse Gruevski akoma nuk paskërka arritur ta njihte problemin e Prilepit, të cilin në mënyrë të vazhdueshme e kemi diskutuar jo vetëm me të, po edhe në prani të disa ministrave, kërkojmë që kësaj xhamie t'i bëjmë një vizitë të përbashkët, që ai drejtpërdrejt të shohë se për çfarë bëhet fjalë dhe ç'dëshmon vetë gërmadha e Xhamisë, thekson sekretari i përgjithshëm i saj, Afrim Tahiri

DRITON DIKENA

Kryeministri i Maqedonisë, Nikolla Gruevski, duket se do të ketë gënjyer opinionin kur në një televizion nacional kishte thënë se "nuk ka shumë njohuri për xhaminë e Prilepit". Sekretari i përgjithshëm i Bashkësisë Fetare Islame, Afrim Tahiri, ka thënë për gazetën "Fakti" se ajo çfarë tha kryeministri lidhur me Çarshi-Xhaminë e Prilepit nuk ishte tjetër, pos edhe një nënçmim i radhës nga ana e tij që po u bën muslimanëve në Maqedoni.

"Ai është hollësisht i njoftuar me rastin e Prilepit dhe është turp jo vetëm për të, por edhe për Qeverinë, pse jo edhe për mbarë shoqërinë, që një kryeministër i cili kishte informacione edhe për çështje jashtëzakonisht të imëta dhe qesharake lidhur me disa 'investime' në rajone të caktuara shqiptare, të mos jetë në rrjedha për një problem për të cilin diskutohet edhe në institucionet ndërkom-bëtare", thekson Tahiri.

Sipas tij, nëse Gruevski akoma nuk paskërka arritur ta njihte problemin e Prilepit, të cilin në mënyrë të vazhdueshme e kemi diskutuar jo vetëm me të, po edhe në prani të disa ministrave, kërkojmë që kësaj xhamie t'i bëjmë një vizitë të përbashkët, që drejtpërdrejt të shohë se për çfarë bëhet fjalë dhe ç'dëshmon vetë gërmadha e Xhamisë.

"Ç'është e vërteta, BFI vazhdimisht mëson se në qytetin e Prilepit struktura të partisë së kryeministrit dhe të pushteti lokal (gjithashtu nga partia e tij) po



ushtrojnë presion ndaj popullatës muslimane të Prilepit, në veçanti ndaj popullatës rome. Atje po bëhen manipulime përmes peticioneve për të penguar ndërtimin e xhamisë", sqaron Tahiri.

Ai habitet se si për Çarshi-Xhaminë, e cila është pronë e BFI-së, ente, drejtori e ministri pa fije turpi japin propozime se për çfarë duhet të përdoret eventualisht xhamia - për muze, për galeri etj.

"Është absurde kjo. Kujt po i pengon që xhamia të ndërtohet dhe të funksionojë si xhami, të shërbejë për atë që është ndërtuar që në shekullin XV? Me keqardhje po themi - mirëpo ky është realiteti - se kryeministri është fort mirë në

rrjedhat e Çarshi -Xhamisë së Prilepit, por në dëm të saj. Janë pikërisht strukturat e tij ato që e pengojnë fillimin e punëve në rindërtimin e xhamisë", sqaron Sekretari i përgjithshëm.

Ai nënvizon se Çarshi-Xhamia e Prilepit, si një monument kulture, para syve të botës për çdo ditë e më tepër po dëmtohet. Për dëmet e shkaktuara pa dyshim se dikush duhet të përgjigjet edhe para drejtësisë.

"Kjo sa nuk është bërë vonë, pasi edhe zonja Xhahangir tha se nëse nuk reagohej në kohë, pastaj mund të jetë tepër vonë. Kur mungesa e tolerancës fetare del nga kontrolli, është e vështirë të bëhet kthesa.


Është koha për veprime konkrete nga Qeveria e Maqedonisë, sepse edhe durimi po humbet më”, theksoi sekretari i përgjithshëm i BFIM, Afrim Tahiri.

Vetë përfaqësuesja për liritë fetare në OKB, Asma Xahangir, gjatë qëndrimit të saj në Maqedoni, ku zhvilloi takim edhe me Reis-ul-Ulema h.Sulejman ef.Rexhepin, një ditë më vonë, në Prilep, enkas për Çarshi-Xhaminë pati deklaruar: “Nuk shoh probleme të mëdha, por shoh shenja ashpërsimi. Nëse nuk reagohet në kohë, pastaj mund të jetë tepër vonë. Kur mungesa e tolerancës fetare del nga kontrolli, është e vështirë të bëhet kthesa”

Arsyetimet e Qeverisë së Maqedonisë dhe institucioneve kompetente shtetërore se mosekzistimi i kushteve politike dhe arsyeja se ende janë të freskëta kujtimet e Karpalëkut, për BFI-në janë të pabaza, ngase, siç thonë edhe vetë, qyteti i Prilepit asnjëherë nuk ka qenë i kyçur direkt në konfliktin e vitit 2001 dhe si i tillë duhet të trajtohet. Në të njëjtën kohë u dogj edhe kisha e Leshkës (Tetovë), mirëpo pas mbarimit të konfliktit të vitit 2001, kur u ndanë mjete për meremetimin e kishës në Leshkë - edhe pse nuk e dogjën muslimanët, por vetë maqedonasit - kisha përfundoi meremetimin dhe u vizitua nga përfaqësuesi special i BE, ndërkaq Xhamia e Prilepit jo vetëm që e filloi meremetimin, por shteti ua ndalon muslimanëve faljen edhe në vetë oborrin e saj, ashtu, nën qiell të hapur, duke vepruar me avazin e vjetër komunist që në këto vende, në qendrat e qytetit, xhamitë të mbyllën ose të shndërrohen në muze, ndërkaq muslimanët të shkonjë në periferi a në mjedise rurale.

Shkaqet e ndarjes dhe copëtimit të botës islame* (II)

“Për të gjithë që e ndajnë bashkërisht një atdhe, krijohet një lidhje midis tyre. Këtë mund ta quajmë si “lidhje vëllazërore atdhetare”. Pra, çdo vendas është vëlla i tjetrit. Ky vëllazërim e obligon të drejtën juridike që t’i ndihmoje dhe t’i kontrolloje individët e atij vendi. Ka nga ata që këtë “vëllazërim” janë duke e kundërshtuar, duke pohuar se vëllazërimi mund të jetë vetëm “vëllazërim fetar” dhe assesi nuk mund të konsiderohet vëllazërim jashtë feje.”



PROF. DR. JUSUF EL-KARADAVI

Si mund të realizohet bashkimi i ummetit/popullit musliman? Islami në aspektin e bashkimit dhe bashkëpunimit të muslimanëve është shumë i ndejshëm dhe i gatshëm. Por, si do të jetë kjo e mundshme? A ka ndonjë kornizë, e cila është përcaktuar lidhur me realizimin e këtij bashkimi? Apo, ky kurs u është lënë muslimanëve sipas vendeve dhe kohëve të tyre?

Profesori rreth kësaj çështjeje thekson se nuk është përcaktuar ndonjë kornizë e qartë dhe e dukshme. Thotë se një model i këtillë ka ekzistuar në periudhën e Hulefâi’r Râshidînëve. Në kohën tonë, ndërkaq, lidhur me këtë ka shumë vështirësi. Mirëpo, nuk është e pamundur që këto vështirësi të kapërcehen. Ka mundësi që të përdoret dhe të praktikohet një metodë graduale (dalëngadalë). Si pikë e parë, mund të bëhet një hap për afrimin



e kulturave, ka mundësi që të përmirësohen raportet ekonomike, apo në fushën e mediave, ka mundësi që të ofrohen informata të shëndosha për njëri-tjetrin. Në çdo fushë, vetëm përmes bashkëpunimit ka mundësi që të krijohen lidhje të forta. Të gjitha këto lloje në të ardhmen mund të ofrojnë bashkëpunim dhe afërsi me njëri-tjetrin.

A janë pengesë forcat e jashtme për bashkimin e botës islame?

Janë duke u theksuar një sërë pengesash për bashkimin e botës islame, si fetare, politike apo ekonomike. Një shumicë e madhe janë duke pohuar se kriteret dhe nevojat internacionale nuk e lejojnë këtë. Sistemi, koniuktura... e një ndërtimi të një bote të re nuk është e gatshme për këtë... Vizita e botës islame një shteti të huaj do të ishte e penguar nga sistemi dhe

forca internacionale, por një gjë të tillë as vetë ajo nuk mund ta pranojë.

Si mund të jenë muslimanët të bashkuar në një rreth të këtillë kaq të vështirë?

Shtetet islame, në krye me ato arabe, e dinë fort mirë se edhe pse tani ato e kanë vështirë të krijojnë një bashkësi ndërmjet vete, tregojnë dhe janë të bindura se kjo (ndarje) nuk do të vazhdojë përgjithmonë. Sipas asaj, i forti nuk do të mbetet gjithmonë i fortë dhe as i dobëti nuk do të mbetet gjer në pafundësi i dobët. Lidhur me këtë, Allahu i Madhërisëm thotë: *“Ne këto ditë i ndërrojmë (u japim në përdorim) mes njerëzve (fitoren, ndonjëherë ia mundësojmë një populli e ndonjëherë një populli tjetër)...”* (Âli İmrân, 3/140). Nëse ne sot jemi të dobët, nesër do të forcohemi. Bashkimi Sovjetik ishte forca e dytë më e madhe e botës. Çka ndodhi? Për këtë shkak, nuk duhet që menjëherë të dorëzohemi. Duhet që të mundohemi dhe të sakrifikojmë shumë për ta ndryshuar këtë gjendje, sepse si nga Kur’ani, ashtu edhe nga sunneti kemi paralajmërimet dhe myzhdet se të ardhmen duhet ta shikojmë me shpresë.

“Vëllazërimi atdhetar”

Rreth kësaj çështje, Prof. dr. El-Karadavi ka mendime të ndryshme. Si shkak që ndikon në ndarjen e botës islame, thotë ai, është atdhetarizmi dhe mentaliteti i asaj që bëhet ndaj pakicave. Për këto, el-Karadavi si për muslimanët, të krishterët apo edhe për të gjitha etnitë e ndryshme jep një përkufizim: *“Vëllazërim atdhetar”*. Profesori thekson se njerëzimi nuk është i njëjtë a i njëlllojtë. Ka shumë lloje dhe ndryshime, si familjare, fshatare, krahinore, atdhetare, popullore dhe fetare. Pastaj thekson se jeta dhe ekzistimi i këtyre në një vend nuk sjell asnjë pengesë për paqe dhe lumturi në vend. *“Për të gjithë që e*

ndajnë bashkërisht një atdhe, krijohet një lidhje midis tyre. Këtë mund ta quajmë si *“lidhje vëllazërore atdhetare”*. Pra, çdo vendas është vëlla i tjetrit. Ky vëllazërim e obligon të drejtën juridike që t’i ndihmojë dhe t’i kontrollojë individët e atij vendi. Ka nga ata që këtë *“vëllazërim”* janë duke e kundërshtuar, duke pohuar se vëllazërimi mund të jetë vetëm *“vëllazërim fetar”* dhe assesi nuk mund të konsiderohet vëllazërim jashtë feje. Mirëpo, unë jam i mendimit se ajeti *“Besimtarët janë vëllezër”* (Huxhûrât, 49/10) dhe hadithi *“Muslimani është vëllai i muslimanit”*, nuk janë pengesë e asaj se mund o nuk mund të ketë vëllazërim atdhetar. Kur e kam theksuar unë këtë mendim timin, një vëlla musliman nga Egjipti më kundërshtoi, duke thënë se vëllazërimi është vetëm nga feja, midis muslimanëve, dhe më pati pyetur se si mund të jemi vëllezër me koptët egjiptianë. Atëherë atij i thashë: Nëse ata nuk janë vëllezërit tanë nga feja, ata i kemi vëllezër nga atdheu, sepse jetojmë në një atdhe dhe ai neve na bashkon. Pastaj ai mua më pyeti se a kam ndonjë argument lidhur me këtë se jo. Unë atij i lexova këto ajete nga Kur’ani: *“Edhe tek (populli) Adi (dërguar) vëllanë e tyre, Hudin, i cili tha: ‘O populli im, ju nuk keni zot tjetër pos Atij; ju vetëm po hutoheni me trillime’”* (Hûd, 11/50), *“Kur vëllai i tyre, Hudi, u tha: ‘A nuk frikësoheni?’* (Shuarâ, 26/124), *‘Edhe te (populli) Themud e patëm dërguar vëllanë e tyre, Salihun’* (Hûd, 11/61), etj. Të gjithë këta popuj nuk u patën besuar pejgamberëve që u janë dërguar. E, edhe përkundër kësaj, Kur’ani Fisnik për të krijuar një lidhje midis tyre, i cilësoi si vëllezër. Sepse, këta të dërguar ishin nga mesi i tyre - nga ai popull. Nuk ishin të huaj për atë popull. Vëllazëria atdhetare ishte ajo që ata i ndërlidhte midis vete. Për këtë shkak, vëllazëria nuk mund të jetë gjithmonë vetëm fetare.

Përktheu:

Mr. Zymer Ramadani

EDUKIMI I INDIVIDIT FILLON QË NË FOSH NJËRI

Dialektika e botës rinore është e pasur dhe e ndërlikuar. Rinia nuk e ka përvojën e duhur jetësore dhe mund të mos e dallojë të renë e vërtetë nga ajo false. Mund të “joshet” nga “molla e ndaluar” e të ndikohet nga desinformacioni. Prandaj, nuk ka përse të trembemi për t’u dhënë fëmijëve njohurit e nevojshme mbi pasionin seksual, duhet edukuar fëmijët se si t’i frenojnë epshet dhe pasionet e tyre, duhet informuar mbi pasojat e kurvërisë. Më mirë është që fëmija të marrë njohuri nga prindi se sa nga “mësuesit e rrugës”.



SHKRUAN: SHABAN AZIRI

Faja islame është për zhvillim të ekuilibruar me qëllim që njeriu të formohet në harmoni me instinktet e tija natyrore të cilët Allahu i krijoi në njeriun. Për t’u aritur ky ekuilibrim, ndihmon shumë edukata e cila siç thuhet fillon që me qumështin e nënës, respektivisht që në moshën e foshnjërisë, kohë kur fillojnë të formohen dhe të zhvillohen disa veti kryesore të personalitetit të fëmijës si anëtarë i ardhshëm i shoqërisë. Prandaj, për të përfituar fëmijë me edukatë të shëndoshë, me moral të lartë, me vullnet të fortë, me aftësi për të frenuar e drejtuar dëshirat dhe për të përmbajtur veten, fëmijë të cilët nuk i jepen eksitimit të parakohshëm seksual dhe ngacmuesve erotizues, rol të rëndësishëm dhe thuajse vendimtarë luan familja, e cila, nëse drejtohet dhe organizohet drejtë, sipas principeve të edukatës islame dhe porosive të Zotit, me siguri do të përfitojmë të rinj të shëndoshë dhe me karakter të plotë.

FILLONI ME KOHË

Prindërit si institucioni i parë në edukimin e fëmijës, bartin përgjegjësinë më të madhe në orientimin e drejtë të fëmijëve të tyre. Nëse fëmijës nuk i jepet edukata e drejtë në vitet e para të fëmijërisë, ai në moshën madhore do të jetë i çorientuar, dhe për këtë, fajtorë janë edukatorët e tij të parë. Këtu nuk nënkuptojmë vetëm edukatën

familjare, por edhe atë seksuale, e cila është edhe esenciale për një zhvillim stabil dhe të drejtë të njeriut, e që, mjerisht, në mesin tonë i kushtohet shumë pak rëndësi.

Edukimi seksual është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e plotë dhe të shëndoshë të personalitetit të brezit të ri. Pedagogjia thotë se edukata fillon që me lindjen e fëmijës dhe se në edukatë nuk ka “vogëlsira”. Dihet gjithashtu se në moshat e fëmijërisë hidhen bazat kryesore të formimit të personalitetit dhe të karakterit të njeriut të cilat përbëjnë themelin e jetës së tij të ardhshme.

Qysh në vogëli fillojnë të formohen pikëpamje të caktuara të cilat luanë rol të madh në edukimin e mëvonshëm, përfshirë edhe atë seksual. Prandaj, edhe puna për edukimin seksual duhet të fillojë më parë se sa të formohen e rrënjosen pikëpamjet e gabuara dhe shpesh të dëmshme për jetën e ardhshme.

Edukata seksuale për moshën fëmijërore deri në fillim të pjekurisë përfshinë një radhë problemesh, por si më kryesorët janë:

Të edukohen fëmijët me parimet e moralit të lartë, me aftësinë për të frenuar e drejtuar dëshirat dhe për të përmbajtur veten;

Të ruhet psikika e fëmijëve;

Të parandalohen veset e këqija dhe eksitimi i parakohshëm seksual;

Edukimi i marrëdhënieve dinjitoze midis dy gjinive.

Të mbështetet fëmija dhe të nxitet për t’u ndjerë krenar si dhe të kuptoj vlerën e tij;

Prindërit duhet të kultivojnë vetëbesimin tek fëmija.

Këto elemne të edukimit meritojnë vëmendje të veçantë sepse siç sqaruam më parë, del e nevojshme t’u kujtojmë edhe njëherë prindërve se ato janë shkolla e parë prej të cilëve fëmija i merr mësimet e para. Nëse kjo shkollë organizohet drejtë, drejtë shkon edhe edukimi i mëtejshëm. Shpeshherë dëgjojmë nga disa prindër duke thënë se fëmija është i vogël dhe nuk kupton gjë. Ky qëndrim është me pasoja për edukimin e instinktit seksual tek fëmija. Nuk duhet harruar se sytë e fëmijës kapin çdo gjë dhe veshët i kanë në përgjim, fëmija çdo gjë e “fotografon” dhe e ruan në kujtesën e tij dhe kjo mund t’i shërbejë në të ardhmen si ngacmues.

Periodha e adoleshencës është ndër periudhat më të rënda dhe të rrezikshme për fëmijën dhe me të drejtë thuhet se, nëse kjo moshë e të riut kalohet me sukses edhe pjesa tjetër e jetës do të jetë e lumtur dhe pa rreziqe. Mbi prindërit bie një përgjegjësi e madhe në drejtim të inspektimit të sjelljes së fëmijut brenda shtëpisë dhe jashtë saj. Ato kanë për obligim që fëmijëve t’ua mësojnë rregullat e sjelljes sipas parimeve islame duke i nxitur që të sillen në harmoni me to. Ndër këto rregulla mund të përmendim:

Kur djali t’i mbushë 10 vjetë nuk



duhet të hyj në vendet ku ekskluzivisht sillen vetëm femrat, e posaçërisht nëse ato janë të veshura në mënyrë provokuese dhe të pahijshme;

Fëmijët nuk duhet lejuar që të flejnë në një krevat edhe nëse janë të njëjtës gjini;

Fëmijët duhet mësuar se cilat pjesë të trupit lejohet e cilat jo të shikohen tek personi tjetër;

Fëmijëve duhet rekomanduar se çfarë mund të përcjellin në televizion, sepse është bërë thuajse e pamundur të shikohet qoftë edhe një film vizatimor e të mos sulmohen vlerat morale islame;

Fëmijët duhet orientuar që të shoqërohen me të rinjë të cilët posedojnë vlera morale dhe fetare.

Fëmijët musliman me rastin e daljes nga shtëpia shpesh krahasohen me ushtarët të cilët janë nisur në një betejë përplotë sakrificë. Ndër problemet me të cilat do të ndeshen janë:

Rreziku i kinemasë dhe teatrit, skenat e të cilëve shpeshherë janë me përmbajtje amorale;

Rreziku nga provokimet e femrave të pamoralshme;

Rreziku nga shtëpitë publike dhe prostitutave.

Të gjitha këto norma të lartpërmendura, kanë si qëllim të ndihmojnë e të përgatisin fëmijët për një të ardhme të lumtur. Për arritjen e këtij qëllimi, edukata kërkon që prindërit të marrin në dorë që herët edukimin e bashkëshortëve të ardhshëm, duke ndjekur me viggjilencë të fëmijët çdo veprim të mirë ose të keq. Nuk duhet falur djalit fjala më e vogël cinike ose mungesa e mirësjelljes dhe e delikatesës ndaj motrës apo gruas. Fatkeqësisht disa baballarëve nuk u bën ndonjë përshtypje të veçantë qëndrimi i dajlit që komunikon ashpër me anëtarët tjerë të familjes. Akoma më keq kur ndonjë e quan këtë si qëndrim "burri" Të kalosh lehtë dhe pa mbajtur qëndrim ndaj këtyre dukurive, do të thotë të rritësh një brez të pakontrolluar dhe të paedukuar mirë.

Në fëmijëri formohen stereotipet

dinamikë bazë që përbëjnë format ose "kallëpët" sipas të cilave më vonë njeriu reagon ndaj ngacmuesve të botës së jashtme. Në këtë periudhë formohen edhe mekanizmat kryesor të emocioneve. Shumica e tipeve të reaksioneve përkatëse formohen pikërisht në moshat e reja dhe ruhen gjatë gjithë jetës. Madje edhe foshnja kur nuk është në gjendje të flas, të mendoj, apo të zotëroj lëvizjet e veta, ndjenjat dhe emocionet i kupton dhe i ndien. Këto shprehen edhe në dëshirën e fëmijës për të vendosur kontakte me gjithçka që e rrethon, për të fituar emocione, përshtypje e mbresa të reja, për të lëvizur, për të marrë "informacion" etj. Këto kërkesa të natyrshme me përgjegjësi duhen plotësuar nga prindërit që fëmija të zhvillohet normalisht e të mos vuaj nga "uria emocionale". Disa psikolog thonë se i gjithë zhvillimi i njeriut, gjatë jetës së tij i ngjanë një ndërtesë dhjetëkatëshe nga të cilat tetë katet e parë të saj ngrihen mbrenda moshës 3 – 6 vjeç. Edhe pse njeriu konsolidohet, rristrukturohet, humbet dhe fiton gjatë gjithë jetës së tij, puna dhe kujdesi i prindërve me fëmijët ka rëndësi shumë të madhe. Prindërit duhet të kuptojnë se për çfarë interesohen fëmijët e tyre dhe të jenë të parët që t'u japin atyre shpjegimet e nevojshme e të dobishme ashtu siç na udhëzon dhe porosin Allahu Mëshirëmadh.

STADET E EDUKIMIT SEKSUAL SIPAS MOSHËS

Ashtu sukur që fëmija kalon përmes stadeve të ndryshme zhvillimore edhe edukata e tij seksuale duhet të planifikohet dhe çdo leksion duhet të jetë përkatës varësisht nga mosha e fëmijut. Sipas pjekurisë së fëmijës ekzistojnë katër stade kryesore përmes të cilave fëmiju kapërcen:

7-10 vjetë, vitet e ndryshimit. Në këtë moshë, fëmiju duhet të dijë se në çfarë kohe dhe mënyre mund të hyj në dhomën e prindërve, duhet të mësohet për mirëmbajtjen e pastërtisë si psh. pas përdorimit të

toaletit. Djali shtatë vjeçar mund të vërej se nëna e tij herë-herë gjatë muajit nuk e falë namazin dhe ai do të interesohet për këtë. Fëmijut të kësaj moshe duhet t'i përgjigjemi se Allahu ndonjëherë e liron femrën nga falja e namazit;

10-14 vjetë, koha e adoleshncës. Në këtë moshë fëmiju duhet të dijë se si t'u shmanget shtytjeve seksuale dhe si të mbrohet prej tyre. Në këtë periudhë fëmiju mund të informohet me problemin e menstruacioneve. Temat mbi seksualitetin mund të preken derisa fëmiju është duke lexuar Kur'an, respektivisht versetet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet seksuale, menstruacionet apo homoseksualizmin, nocione këto të cilat mund t'ia shpjegojmë aty për aty;

14-16 vjetë, koha e pubertetit. Në këtë moshë fëmiju duhet të mësoj etikën e marrëdhënieve seksuale. Ai duhet të informohen me rregullat e pastrimit obligativ "guslit", në cilat raste ai aplikohet (pas marrëdhënieve seksuale, menstruacioneve, polucioneve etj);

16 vjeç e më lartë, mosha e pjekurisë. Djali dhe vajza e pamartuar, në këtë moshë duhet të dijnë për rregullat e marrëdhënieve seksuale, për rrezikun e prostitucionit si dhe pasojat e jetës amorale si dhe të parapërgatiten për martesë.

VITET E NDRYSHIMIT

Fëmija kryesisht kohën e kalon në shtëpi dhe ai zakonisht sillet shumë i lirë, hy ku të dojë dhe kur të dojë. Mirëpo, ekzistojnë kufizime për fëmijët paksa më të rritur, të cilët në periudha të caktuara duhet të kërkojnë leje nga prindërit për të hyrë në dhomën e tyre të fjetjes.

Pedagogu ynë, Muhamedi alejhiselam, ka caktuar rregulla dhe norma të cilat prindërit duhet t'ia mësojnë fëmijëve të tyre me qëllim që të përfitojmë fëmijë të njerëzishëm dhe të sjellshëm.

Duhet kërkuar leje kur të hyet në dhomën e prindërve.

Fëmija është i obliguar që sidomos në tri periudha kohore të kërkoj leje për të hyrë në dhomën e

prindërve:

- para namazit të sabahut,
- gjatë pushimit të mesditës dhe,
- pas namazit të jacisë.

Këto janë periudha kohore kur prindërit pushojnë dhe gjenden në dhomë të tyre.

Të shohim se si Kur'ani, flet detajisht për këtë çështje:

"O ju të cilët besuat, ata të cilët i keni në pronësinë tuaj (shërbetorët) dhe ata që nuk e kanë arritur moshën e pjekurisë, duhet të kërkojnë leje prej jush (për të hyrë te ju) në tri kohë: para namazit të sabahut, në kohën e drekës kur i hiqni rrobat tuaja (për të pushuar) dhe pas namazit të jacisë, që të tria këto kohë janë kur ju nuk jeni të veshur. Pos atyre tri kohëve nuk është mëkat as për ju as për ata, të vizitoni njëri - tjetrin. Kështu Allahu ua sqaroi argumentet e veta. Allahu është i dijshti i urti". (En-Nurë: 58)

Kur fëmiju të arrijë moshën e pjekurisë, duhet t'i bëhet me dije se është i obliguar të kërkojë leje për të hyrë në dhomën e prindërve në çdo kohë. Ligjëdhënësi i Plotëfuqishëm thotë:

E kur fëmijët tuaj ta arrijnë moshën e pjekurisë, le të kërkojnë leje (për hyrje) ashtu si kërkuan ata para tyre. Allahu ju shpjegon dispozitat e veta, sepse Ai di më së miri dhe është më i urti" (En-Nurë: 59).

Fëmijët të mësohen dhe të ushtrohen që t'i ndalin shikimet e tyre (prej haramit) dhe t'i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre.

Pra, fëmijët duhet të mësohen që t'i ndalin shikimet e tyre (nga harami), mos t'i shikojnë pjesët e turpshme të trupit tek të tjerët me qëllim që të mos nxiten pasionet e tyre dhe të mos eksitohen parakohe.

Fëmijët të flejnë të ndarë.

Lidhur me këtë, Pedagogu ynë i dashur Muhamedi alejhiselam thotë:

"Urdhëroni fëmijët e juaj që të falen kur t'i mbushin shtatë vjet, kurse rrahni kur t'i mbushin dhjetë dhe le të flejnë të ndarë".

Të mësohen fëmijët që të flejnë në krahun e djathtë dhe t'u tërhiqet vërejtja që mos të flejnë barkas.

Shmangia e përzierjes së gjinive dhe ngacmimeve seksuale.

T'i mësohen fëmijëve farzet dhe sunetet e guslit.

Fëmijëve të cilët e kanë arritur moshën e pjekurisë, t'u shpjegohet kaptina kur'anore (En-Nurë) dhe të kërkohej prej tyre që ta mësojnë përmendësh.

Haptas me ta të flitet mbi pasionin seksual dhe t'ju tërhiqet vërejtja prej prostitucionit dhe jetës amorale (ziansë).

Dialektika e botës rinore është e pasur dhe e ndërlikuar. Rinia nuk e ka përvojën e duhur jetësore dhe mund të mos e dalloj të renë e vërtetë nga ajo false. Mund të "joshet" nga "molla e ndaluar" e të ndikohet nga desinformacioni. Prandaj, nuk ka përse të trembemi për t'u dhënë fëmijëve njohurit e nevojshme mbi pasionin seksual, duhet edukuar fëmijët se si t'i frenojnë epshet dhe pasionet e tyre, duhet informuar mbi pasojat e kurvërisë. Më mirë është që fëmija të marrë njohuri nga prindi se sa nga "mësuesit e rrugës".

Allahu i Plotëfuqishëm me mëshirën e Tij, neve na e ka treguar rrugën e drejtë dhe zgjidhjen e të gjitha problemeve me qëllim që në ne, gjithmonë të triumfoj njerëzia dhe që ta mbërrimë shpëtimin dhe rehatinë në këtë dhe në botën e amshueshme. Krijuesi i Plotëfuqishëm di për pasojat e tmerrshme të prostitucionit dhe jetës së shfrenuar dhe imorale të njerëzve. Jeta e tillë tanimë, deri sot, ka rrënuar themelet e shumë shtëpive, ka shkatërruar shumë familje dhe i ka përcjell në barkun e tokës shumë e shumë të rinj në kohën më të bukur.

Virtytshmëria njerëzve gjithmonë u ka sjell vetëm lumturi kurse imoraliteti dhe prostitucioni fatkeqësi. Prandaj, Feja islame porositi për pastërti morale dhe virtutshmëri për ithatret e saj.

T'i dëgjojmë fjalët e shenjta kur'anore të versetit tridhjetë e dy të kaptinës El - Israë:

"Dhe mos iu ofroni amoralitetit, (zianasë), sepse vërtetë ai është vepër e shëmtuar dhe është një rrugë shumë e keqe"

" Zoti ynë bëne të sotmen tone më të mire se të djeshmen, ndërsa të nesërmen tone më të mire se të sotmen ".

Hadith kudsijë:

Allahu xh.sh thotë: "Unë jam në mendimin e robit tim kur ai më kujton Mua, Unë jam me të kur ai më përmendën Mua, nëse më përmendën Mua në veten e tij, e përmendi Unë atë në Vetën Time, nëse me përmendën në një masë, e përmendi Unë atë në një masë më të mirë se ajo, nëse afrohet nga Unë një shpull, afrohem kah ai një krahë" (transmeton muslimi)

Rruga shpirtërore e njeriut

"Të dish diçka, të duash diçka dhe të praktikosh atë që di dhe që do, janë tri elemente që nuk mund të gjenden te çdokush."

MIXHIT OSMANI

Pa dyshim, është Kur`ani libri i fundit i shpalluar nga ana e Allahut xh.sh. për udhëzimin e njerëzve në rrugën e drejtë. Ndërkaq, sa i përket njeriut, ai është një krijesë që disa vlera të veçorisë siç janë: trupi, shpirti, nefsi, mendja, zemra etj. Këto veçori i përmban vetëm njeriu, sepse ai është një kombinim mes asaj trupore, shpirtërore dhe pasionuese. Metoda e vetme për të mbajtur baraspeshën e këtyre kombinimeve është praktikimi i urdhrave fetarë ashtu siç kërkohen. Për këto thënie kemi ajetin kur`anor: "Thuaj: 'Ai është që ju krijoi, ju dhuroi të dëgjuarit, të parit dhe mendjen, ndërsa pak po falënderoni.'" (Mulk, 23)

Ajo që njeriut i jep më së shumti vlerë në skenën njerëzore është aspekti shpirtër e jo ai fizik, se në botë kemi shumë njerëz që janë të zhvilluar fizikisht, mirëpo logjika



e tyre është shumë e dobët, ndërkaq ata që kanë logjikë në një nivel të shëndoshë janë të rrallë. Për këtë duhet të mundohemi maksimalisht edhe ne ta mbajmë këtë baraspeshë, ashtu që të jemi pjesëtarë të saj.

Fakti që njeriun e dirigjon sipas dëshirave të tij është *pasioni*, dirigjimi sipas mençurisë dhe logjikës së shëndoshë është *mendja e shëndoshë*, ndërkaq ndriçimi i intuitës bëhet vetëm me anë të *zemrës ndriçuese*. Nëse japim një kronologji të shkurtër për njeriun e sotëm, do të shohim se për të arritur aspiratat e veta mundohet vetëm përmes rrugës materiale-fizike, ndërkohë që e ka anashkaluar rrugën shpirtërore, e cila është solucioni i vetëm për zbërthimin e problemeve. Për këtë, edhe Islami i jep më shumë përparësi (kuptimore) anës shpirtërore. Kjo nuk do të thotë që nuk e merr parasysh anën materiale-fizike. Në shumë versete kur anore kemi fakte se shpirti është ai që i dirigjon çështjet që kanë të bëjnë me njeriun. Ky shpirt nuk është pasioni, por zemra që i mbanë baraspeshë lidhjet e njeriut.

RRUGA E SHPIRTIT

Andaj edhe nuk është e rastësishme që qelizat e trurit dhe të zemrës nuk ripërtërihen ashtu siç ripërtërihen qelizat e tërë trupit. Kjo do të thotë se kodet njerëzore janë të fshehura në këto dy organe. Faktikisht, trupi në këtë botë është vetëm një kallëp që udhëhiqet nga shpirti. Kjo tek ata njerëz që kanë mendje dhe logjikë të shëndoshë. Tek ata që janë në një nivel më të ulët të mençurisë dhe të logjikës, udhëheqja bëhet përmes pasionit.

Për këtë, edhe njëra ndër disiplinat të pandashme të Islamit është edhe *tasavvufi - misticizmi*, i cili është shërim i shpirtit pasionues. Nuk është e rastësishme që njerëzit i kanë respektuar shumë ata që janë marrë me frymën e tasavvufit: vërtet këta kanë qenë shembull për ne, ngaqë kanë ndriçuar me një dritë shpirtërore. Duke mos u thelluar dhe duke mos komentuar

fare atë se çka do të ishte bërë me ata që nuk kanë mundësi të merren me këtë disiplinë, ne jemi duke sqaruar vlerën e rrugës shpirtërore e cila arrihet përmes disa rrugëve, ku njëra ndër rrugët më të rëndësishme është edhe rruga e misticizmit. Përmes kësaj njeriu zhytet në thellësitat e oqeanit të urtësisë dhe të butësisë shpirtërore. Andaj, personalisht e shoh këtë mungesë në shoqërinë tonë, shoqëri kjo e cila është e mbushur përplot fakte të panevojshme, të cilat i kemi marrë pa i analizuar fare.

ISLAMI FE SPIRITUALE

Krahas kësaj, kemi njerëz në mesin tonë që mundohen ta ngrenë nivelin e arritjes së të vërtetës njerëzore duke i fajësuar gjithë ata që nuk u përgjigjen kërkesave të



tyre. Këta persona nuk e kanë të qartë ende faktin se vetëm me atë të mjekrës apo shkurtimit të pantalloneve...apo edhe të veshurit me "veshjen Islam" (duke mos bërë dallim mes asaj arabe dhe islame), janë duke bërë përçarje në mesin e popullatës, pa fije argumeti të shëndoshë, që kanë kaluar nëpër logjika superiore të dijetarëve eminentë të botës, edhe atë me të vetmin qëllim - "arritjen e të vërtetës". Të dish diçka, të duash diçka dhe të praktikosh atë që di dhe që do, janë tri elemente që nuk mund të gjenden te çdokush. Ndërkaq, këto grupacione të prapambetura mundohen ta mbrojnë tezën së këto elemente i kanë të gjithë, gjë që është e pamundur.

Kjo është, njëherit, edhe kataklizma e gjithë atyre që merren me këtë injorancë. Fatëkeqësisht, ata ende nuk janë të vetëdijshëm se e përfaqësojnë shkallën më të ulët të nivelit intelektual në mesin tonë. Mund të paramendoni që këta persona të thirrin në Islam me këtë nivel të intelegjencës! Këtë vetëm mund ta barazojmë me thënien e një dijetari bashkëkohor për këta persona: "Kasapët na janë bërë kardiologë". Nuk është edhe e rastësishme që neve na sundon një grup shtetasish që ende nuk kanë historinë e tyre. Kjo është kështu sepse jemi të ndarë me probleme që nuk janë diskutuar nga njerëzit asnjëherë.

Dhe, si konkluzion i gjithë kësaj që thamë është se Islami është një fe e cila ia ka bërë të qartë krijesës njeri gjithë atë që duhet ta ketë të qartë. Nuk është mesazhi i Islamit që t'i jepet përparësi anës shpirtërore ose asaj fizike-materiale, përkundrazi, mesazhi i tij është mbajtja e baraspeshës, me kombinim, por gjithnjë duke e pasur parasysh se karakteri njerëzor përcaktohet përmes anës shpirtërore.

Dëshiroj që Allahu xh.sh. të na japë shumë pak urtësi nga urtësia e Tij e pafundshme, me të vetmin qëllim që ta kuptojmë mesazhin e Islamit ashtu siç kërkon vetë Islami që të kuptohet mesazhi i tij.

Mos iu afro



IMORALITETIT!

Pejgamberi a.s. thotë: “Me pesë gjëra do të sprovohen njerëzit dhe Zoti ju ruajt që të mos i arrini! Nuk ka popull ku përhapet imoraliteti dhe veprohet haptazi, veçse Zoti do t'i ndëshkojë me epidemi, sëmundje dhe dhimbje që nuk ekzistonin te brezat e mëparshëm...”

SEMI AJETI

Jemi duke jetuar në një kohë të ligë, në një kohë ku janë shtuar haramet dhe mëkatet. Dukuritë negative si vjedhja, alkooli, kamata, bixhozi, imoraliteti etj. janë bërë pothuajse krejtësisht normale.

Që të gjitha këto dukuri janë të rrezikshme për një individ, mirëpo kjo e fundit, pra imoraliteti, është edhe më i rrezikshëm, pasi që pos që ndikon negativisht tek individi, ndikon edhe te mbarë shoqëria, duke sjellë përçarje mes njerëzve,

ngatërron lidhjet farefisnore dhe shton urrejtjen mes palëve. Këtu fillojnë edhe mënyrat e ndryshme për t'u liruar nga fëmijët e padëshiruar. Nëna të shumta abortojnë fëmijët e tyre dhe, në raste të shumta, edhe pas lindjes mjaft fëmijë lihen rrugëve dhe hidhen sikur të ishin mbeturina të pavlefshme.

Fatkeqësisht, edhe përkundër rreziqeve të mëdha që i sjell ky ves i keq, sot jemi dëshmitarë që shumë institucione përpiqen dhe ia kanë arritur që amoralitetin ta konsiderojnë diçka normale.

MORALI DHE KULTURA

Njëherë Profeti a.s. iu drejtua banorëve të Mekës që kishin emigruar në Medine dhe u tha: “O ju muhaxhirë! (banorë të Mekës) Me pesë gjëra do të sprovohen njerëzit dhe Zoti ju ruajt që të mos i arrini! Nuk ka popull ku përhapet imoraliteti dhe veprohet haptazi, veçse Zoti do t'i ndëshkojë me epidemi, sëmundje dhe dhimbje që nuk ekzistonin te brezat e mëparshëm...” Nga kjo fjalë e shenjtë e Pejgamberit a.s. kuptojmë se kurdo që përhapet shthurja morale dhe kjo konsiderohet kulturë,

Allahu xh.sh. do t'i ndëshkojë me sëmundje dhe epidemi të ndryshme.

Ky paralajmërim i Pejgamberit a.s. shohim se është duke u shfaqur kohëve të fundit, ku sida dhe shumë sëmundje të tjera, të cilat transmetohen kryesisht në rrugë seksuale, janë duke u përhapur me të madhe.

Në raportin vjetor të programit të OKB-së për luftë kundër sidës tregohet që numri i viktimave vitin e kaluar ishte dy milionë, përkatësisht dyqind mijë më pak se në vitin 2006. Organizata botërore konstaton se numri i të vdekurve nga sida ende është në nivel të lartë. Çdo ditë infektohen 7.500 persona të rinj nga virusi i sidës. Në botë numri i të prekurve nga kjo sëmundje arrin në 33 milionë. 67 % e tyre jetojnë në Afrikë, në vendet në jug të shkretëtirës së Saharës. Pikërisht atje vitin e kaluar janë regjistruar 72 % e të vdekurve nga sida. Ky është numri i rasteve që janë vërtetuar se mbajnë këtë virus.

A thua e gjithë kjo na e bën të ditur hidhërimin e Allahut xh.sh. ndaj njerëzimit, i cili nuk e lejon thyerjen e ligjeve të Tij?

DOBËSIMI I NDJESHMËRISË FETARE

Vallë, sa duhet të jetë numri i vërtetë i të infektuarve që njeriu të ndalet ta reklamojë amoralitetin dhe ta konsiderojë si diçka normale, posaçërisht rinia të cilët nuk mjaftohen me veprimin e një gjynahu apo vepre të ulët, por e bëjnë atë pa iu skuqur fytyra. Madje, ata ndihen krenarë dhe i deklarojnë haptazi të metat dhe gjynahet që i bëjnë. Atyre nuk u vjen turp nga vetja, as nga familja, as nga shoqëria dhe, ç'është më e keqja, as nga Allahu xh.sh.

Por, cilët janë faktorët për përhapjen e kësaj dukurie negative? Pa dyshim se faktorët janë të shumtë.

Një, duke filluar nga dobësimi i ndjeshmërisë fetare mes të rinjve dhe të rejave. Jemi dëshmitarë që të rinjtë tanë pothuajse janë larguar nga xhamitë, vendi i vetëm prej nga fitohet edukata islame. Pastaj, duke

mos pasur me çka ta mbushin kohën e lirë, i riu dhe e reja kërkojnë alternativa të tjera, duke vizituar bare dhe klube të ndryshme, koncerte të ndryshme, po bile bile edhe shtëpi publike, duke harruar fjalën e Pejgamberit a.s., i cili thotë: *"Shtatë persona do të strehohen nën hijen e Arshit të Allahut xh.sh. atë Ditë që nuk do të ketë hije tjetër pos saj..."* dhe e cek një të ri që është rritur dhe edukuar me adhurim dhe bindje ndaj Zotit.


Pa dyshim se një kontribut të tillë e japin edhe prindërit, të cilët nuk i kushtojnë kujdes edukimit të tyre, siç thotë një dijetar (Muhamed Rida Beshir): „ Nëse prindërit nuk kanë ambientin e përshtatshëm në shtëpi dhe nuk kanë komunikim të mirë me fëmijët e tyre, kjo do t'i shpie fëmijët që të veçohen dhe të largohen nga shtëpia dhe familja e tyre. Ky veçim (largim) nga shtëpia sjell fatkeqësi për një adoleshent. (Pasi që) në shumë komunitete muslimane në Perëndim shtëpia është ku të rinjtë së pari përjetojnë Islamin, si p.sh. faljen e namazit dhe obligimet tjera fetare”.

Gjithashtu, edhe mjetet e informacionit kanë ndikim të madh te të rinjtë. Një numër i madh i mediave përmes emetimit të

materialeve të shumta me të madhe marrin pjesë në devijimin e të rinjve duke i nxitur në krim, amoralitet dhe sjellje problematike të individëve. Filmat përplot dhunë, vrasje, amoralitet dhe skena të ndryshme të pashembullta për çdo ditë tregohen në shumicën e kanaleve televizive. Shohim revista me përmbajtje lakuriqësie sesi nxisin në këtë, duke bërë gara se cila prej tyre do të jetë shkatërruesi më i madh i moralit.


Duke qenë të ndërgjegjshëm se ndikuesit dhe faktorët janë të shumtë, duhet të kuptojmë se kjo dukuri nuk është diçka që duhet nënvlerësuar, por, përkundrazi, duhet kushtuar vëmendje të veçantë dhe të gjithë pa përjashtim duhet të këshillojmë njëri-tjetrin dhe të ndihmojmë njëri-tjetrin që të shmangim këtë fenomen që vërtet përbën një nga sëmundjet e çdo shoqërie.

Në fund falënderojmë Allahun xh.sh. që na ka udhëzuar në këtë drejtim dhe si për çdo punë tjetër, edhe për këtë vepër të shëmtuar na ka treguar rrugëdaljen duke thënë: **“Dhe, mos iu afroni imoralitetit (zināsë), sepse vërtet ai është vepër e shëmtuar dhe është një rrugë shumë e keqe.”** (Isra, 32)



Qëllime dhe dobi për çdo kohë

Rrëfimet kur'anore kanë përmbajtje edukative dhe, si të tilla, aspirojnë formimin e personalitetit të lartë të njeriut, me të gjitha cilësitë humane, të cilat janë rezultat i fatit dhe i mirëqenies ndërnjerëzore. Ky është, njëherit, ndër parimet kryesore të feve qiellore pas besimit në Allahun xh.sh. dhe ditës së mbramë



SHABAN IDRIZI

Pre shembujve të cituar më parë, pamë se si realizohen dhe kumtohen qëllimet fetare nëpërmjet rrëfimeve kur'anore dhe, në të njëjtën kohë, pamë se si me ndihmën e tyre mund të përfshihen dhe të shprehen qëllime dhe dobi të llojllojshme, të tejpamshme e që nuk kuptohen lehtë, herë-herë dhe këshilla të thella e në shikim të parë të fshehta dhe të paqarta. Mirëpo, duke i analizuar dhe duke menduar që për bazë merr frymën e të menduarit kur'anor, do të shohim se në to përfshihen qëllime dhe dobi të larta universale të cilat kanë shërbyer, shërbejnë dhe do të shërbejnë si këshilla dhe mësim për besimtarët dhe njerëzit në përgjithësi, pa marrë parasysh kohën. Këtë e shohim edhe nga fjalët e Allahut xh.sh. ku thotë:

“Të gjitha këto që t'i rrëfyem ty nga lajmet e pejgamberëve, janë që të forcojnë zemrën tënde, dhe në to ka ardhur e vërteta e këshilla, si dhe përkujtime për besimtarët.” (Hud: 120).

Qëllimet dhe dobitë nga rrëfimet e Kur'anit janë të shumta dhe të pashtershme, mirëpo ne do të mundohemi t'i paraqesim vetëm ato që janë më kryesore dhe që më tepër tërheqin vëmendjen e intelektualëve, të masës dhe të cilat gjithmonë shndritin me aktualitetin e tyre. Pra, me anë të këtyre rrëfimeve kur'anore koncipohen dhe nxirren këto qëllime:



1. NJËSIA E ALLAHUT XH.SH.

Nga rrëfimet e ndryshme të Kur'anit famëlartë na del në shesh qëllimi kryesor i frymës që e përshkon Kur'anin, e ai është themelimi i besimit në një fuqi të vetme – besimi në Allahun xh.sh. si krijues i gjithçkasë që ekziston dhe sundues i të gjitha botëve. Dhe, si i tillë, i vetmi meriton adhurim. Si shembull e marrim rrëfimin mbi Jusufin a.s., i cili edhe në burg shfrytëzoi rastin të thirrë në besimin e Allahut xh.sh.:

“O ju dy shokët e mi të burgut, a është më mirë të adhurohen zota të ndryshëm ose Allahu, i vetmi ngadhënjimtar?”

Ata që adhuroni përveç Allahut, nuk janë tjetër vetëm se emra që pagëzuar ju dhe prindërit tuaj. Allahu nuk shpalli ndonjë fakt për ta, vendimi (në çështjen e adhurimit) nuk i takon kujt, pos Allahut, e Ai urdhëroi të mos adhuroni tjetër vetëm Atë. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.” (Jusuf: 39-40).

2. VËRTETIMI I SHPALLJES DHE I PEJGAMBERISË

Ndër qëllimet kryesore të rrëfimeve kur'anore është të vërtetuarit e shpalljes dhe pejgamberisë, e cila e ndoqi njerëzimin gjatë historisë duke ia trasuar rrugën e zhvillimit kulturor në të gjitha fushat e aktivitetit të tij.

Posaçërisht na bien në sy fryma tjetër, e cila vërteton profetizmin e pejgamberit të fundit, Muhamedit a.s.

Po ashtu, rrëfimet mbi popujt e ndryshëm me të cilët është ballafaquar Shpallja janë argument se Shpallja është vetëm vepër e Allahut xh.sh., e kurrsesi vepër e Muhamedit a.s., i cili ka qenë ummijj, që do të thotë: nuk ka ditur shkrim-lexim. Mbi këtë Kur'ani flet kështu:

“Por Ne krijuam popuj (mes Musait e teje Muhamed), e koha ka zgjatur (ndaj, të dërguam ty). Dhe ti nuk banove në mesin e popullit të Medjenit e t'ua lexosh këtyre argumentet Tona (lajmin për Musain, për Shuajbin, për vajzat e tij), por Ne të dërguam (dhe të njoftuam). Dhe ti nuk ke qenë pranë kodrës Tur kur Ne e thirrëm (Musain), por (tregimi ynë) është mëshirë nga Zoti yt, për t'ia tërhequr vërejtjen një populli të cilit para teje nuk i kishte ardhur ndonjë pejgamber, dhe kështu ata të marrin mësim.” (El Kasas : 45-46).

3. VËRTETIMI I LIDHJES SË PËRBASHKËT IDEORE DHE METODËS SË NJËJTË TË PROFETIZIMIT

Rrëfimet kur'anore japin shenjë në një lidhje të përbashkët ideore, e cila lidh fenë që ka predikuar Muhamedi a.s. dhe të dërguarit para tij. Gjithashtu, japin shenjë se thirrjen në Allahun xh.sh nga të gjithë të dërguarit

e ka karakterizuar po e njëjta metodë. E gjithë kjo do të thotë thirrje në

besimin e një Allahu dhe në praktikimin e një feje si rrugë e jetës njerëzore.

Ja disa versete kur'anore në lidhje me këtë:

“Ne e patëm dërguar Nuhun te populli i vet, e ai i tha: “O populli im, adhurojeni Allahun, nuk keni zot tjetër pos Tij...” (El-E'raf: 59).

“Edhe te (populli) Ad-i (dërguam) vëllain e tyre Hudin, e ai tha: O populli im, adhurojeni (një Zot) Allahun; ju nuk keni zot pos Tij; a nuk po frikësoheni?!” (El-A'raf: 65).

“A ishit ju (ithtarë të librit) dëshmitarë kur Jakubit iu afrua vdekja, e ai bijve të vet u tha: “Çka do të adhuroni pas meje”? Ata thanë: “Do të adhurojmë Zotin tënd, dhe Zotin e prindërve tu: Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Një të Vetmin Zot dhe, ne, vetëm Atij i jemi dorëzuar!” (El Bekaretu : 133).

4. PËRFORCIMI I ZEMRËS SË MUHAMEDIT A.S. DHE UMMETIT TË TIJ

Rrëfimet kur'anore po ashtu kanë detyrë të shpjegojnë ndihmën e Allahut xh. sh. që ua ka dhënë pejgamberëve kur ata ishin përbuzur e nënçmuar nga popujt e tyre, të cilët nuk besonin të vërtetën nga Allahu xh.sh., e ky mosbesim i dërgoi ata drejt shkatërrimit nga Allahu xh. sh.

Përshkrimi i këtyre ndodhive historike paraqet përforcuesin e zemrës dhe

dhënies së kurajos për Muhamedin a.s. në praktikimin e misionit të tij profetik, si dhe për ummetin e tij. Ja se si rrëfen Kur'ani për këtë:

“E në Medjen (dërguam) vëllain e tyre, Shuajbin dhe ai u tha: “O populli im, adhurojeni Allahun dhe kijani frikën ditën e fundit, e mos e teproni si shkatërrues në tokë! Por, ata e përgënjështuan, andaj i përfshiu tërmeti dhe aguan të shtangur (të ftohur e të vdekur) në shtëpitë e tyre.” (El-Ankebut: 36-37)

EDUKIMI DHE HUMANIZMI I INDIVIDIT DHE I SHOQËRISË

Rrëfimet kur'anore kanë përmbajtje edukative dhe, si të tilla, aspirojnë formimin e personalitetit të lartë të njeriut, me të gjitha cilësitë humane, të cilat janë rezultat i fatit dhe i mirëqenies ndërnjerëzore. Ky është, njëherit, ndër parimet kryesore të feve qiellore pas besimit në Allahun xh.sh. dhe ditës së mbramë. Këtë e shohim nga ky ajet: *“E në Medjen (dërguam) vëllain e tyre Shuajbin. Ai tha: “O populli im, adhurojeni Allahun (një); ju nuk keni zot tjetër pos Tij. Juve ju erdhi mrekullia nga Zoti juaj. Zbatoni drejtmatjen dhe peshoren, e mos u bëni padrejtësi njerëzve në sendet e tyre, dhe mos bëni çrregullime në tokë pas përmirësimit të saj. Këto janë më të dobishme për ju, nëse jeni besimtarë. Mos zini pusi në çdo rrugë e të kërcënoheni dhe të pengoni nga rruga e Allahut atë që i ka besuar atij (Shuajbit), e të kërkoni shtrembërimin e asaj (e rrugës)...”* (El-A'raf : 85-86).


(Vazhdon)



Problemi i dialogëve të pafrytshëm midis mësuesit dhe nxënësit (II)

“Kush i pajton njerëzit duke e hidhëruar Allahun, Allahu e le në duart e njerëzve, ndërsa kush i hidhëron njerëzit për ta pajtuar Allahun, Allahu ia kryen problemet e tij prej njerëzve”- thënie e Muhamedit a.s.

DR. MUHAMED SAID RAMADAN EL BUTI



NEVOJA PËR BESIMIN

Mbetet që ta dimë obligimin e palës e tjetër në zgjidhjen e këtij problemi, d.m.th. obligimin e dijetarit që interesohet për udhëzimin e njerëzve dhe thirrjen e tyre për në rrugë të Allahut.

Obligim i dijetarit që merret me këtë punë është që në veten e tij të realizohen tri gjëra:

E para: Të posedojë dituri të plotë rreth besimit islam dhe dispozitave të tij, rregullat e da'ves dhe metodologjinë shariatike, në të thirrurit për kah e mira dhe ndalimi nga e keqja e mandej t'u përmbahet këtyre rregullave.

Është e ditur se fjala dijetar ose këshilltar sot është bërë një rrobë e

gjerë që përfshin lloje të ndryshme njerëzish. Midis tyre ka dijetarë të vërtetë, injorantë, gjysmë dijetarë dhe persona të tillë që marrin arsimin si profesion për të realizuar qëllimet e kësaj bote.

E dyta: Të jetë i sinqertë në thirrjen e tij për në rrugën e Allahut. Nuk duhet që të ekzistojë tek ai dëshira për pasuri, famë, udhëheqje, pozitë etj. Në këtë detyrë duhet të mos e udhëheqë frika, përpos frikës së Allahut e as shpresa, përveç shpresës së Tij. Për të, duhet të jetë i barabartë zullumi i udhëheqësve dhe kritikant e njerëzve.

Është realitet se sinqeriteti është një sekret që Allahu xh.sh. e vendos në zemrën e kujt të dojë prej njerëzve, e nuk mund të arrihet me

komplimente. Sinqeritetin mund ta arrijë njeriu vetëm atëherë kur ta shtojë dhikrin, kontrollin e Allahut ndaj tij, përluljet dhe lutjet e vazhdueshme.

E treta: Të përdorë metodën e urtësisë në çdo çështje dhe me gjithë njerëzit. Urtësia është përdorim i rrugës më të afërt për realizimin e qëllimeve, me kusht që kjo rrugë të jetë e lejuar dhe jo haram. Kjo d.m.th. se urtësia nuk është e kufizuar vetëm në mënyrat e buta, sikur që nuk është në kundërshtim gjithnjë me mënyrën e ashpërsisë. Por, duhet të merret parasysh ajo metodë që përputhet me qëllimin e synuar. Dihet se Muhamedi a.s. ka qenë i urtë në thirrjen e tij paqësore duke qenë në Mekë, po ashtu ka

qenë i urtë në xhihadin e tij luftarak kur është vendosur në Medine.

Është me rëndësi të dimë se urtësi në da'Ve - pas përmbajtjes së kritereve dhe rregullave të saj - nuk lind prej rregullave të kufizuara e as bazave të caktuara. Në bazë të kësaj, ajo nuk i nënshtrohet mundësisë së dialogut rreth kritereve të saj e as mënyrës së përdorimit të tij. E gjithë ajo që kërkohet, është se hapësira që lëvizë kah da'Veja duhet të jetë e pastër prej haramëve dhe se puna duhet të jetë e rregulluar me parimet fetare. Prej këtujve, dialogjet që ngriten shpeshherë prej shumë grupeve rreth ndonjë qëndrimi se sa është i qëlluar ose jo, janë dialogje të pafrytshëm. Nga ky dialog nuk mund të pritët as një për qind, sidomos kur në njërin palë është personi i rëndomtë e në palën tjetër dijetari i drejtë. Në këtë rast, nuk ka rrugë tjetër për ndërprerjen e këtij diskutimi, përpos që injoranti t'i nënshtrohet dhe të pranojë me plot bindje atë që e sheh dijetari i drejtë.

Kur të plotësohen këto tri kushte te dijetarët si këshillues dhe thirrës për në rrugë të Allahut, atëherë ai ka për obligim që të largohet prej afshi dhe dëshirat e njerëzve, pa i kushtuar rëndësi asaj që e dëshirojnë ata. Nuk ka dyshim se ai nuk do të korrë - nëse u dorëzohet epsheve të tyre - asgjë tjetër përpos përçarje mes tyre, përveç asaj që është edhe më e rrezikshme, që d.m.th. ta shesë pajtimin e Allahut për pajtimin e njerëzve.

Ai person sado që të përpiket të përfitojë afrimin e njerëzve dhe pëlqimin e tyre, nuk do të arrijë asgjë, madje do të bie mes atyre që e duan dhe atyre që e urrejnë dhe, më në fund, do ta humb pëlqimin e Allahut e nuk do të arrijë atë që për të ka flijuar pajtimin e Allahut, e që është pajtimi i njerëzve.

Njerëzve prej dijetarit dhe thirrësit u pëlqen që mos të merret me kritika ndaj tyre, por të mirret me kritika ndaj udhëheqësve, duke i demantuar gabimet dhe devijimet e tyre. Aqsa më shumë thirrësi dhe këshilltari të heqin dorë prej gabimeve që vlojnë në shoqëri, në tregje, në ekonomi, në sjelljet shtëpi-

ake e familjare etj., e mandej kufizon aktivitetet e tij duke i kritikuar udhëheqësit, do të jetë më i ngritur dhe më i lartë në sytë e njerëzve, do të cilësohet me trimëri dhe, më në fund, do të përfitojë duartrokitje të ashpra.

Ndërsa, ai i cili gjithë njerëzit, pa marrë parasysh shtresat dhe pozitat e tyre, i konsideron të barabarta, ngase duhet t'i urdhërojë kah e mira dhe t'i ndalojë nga e keqja, shumë shpejt do të mbushen mllëf për të dhe për qëndrimet e tij. Shumë prej tyre ankohen duke thënë: A nuk ka parë prej të këqijave të kësaj bote, përpos kësaj që po na kritikon? A nuk do të ishte më mirë që në vend që të kritikojë, të na i mbulojë të këqijat, pasi Allahu ka urdhëruar për mbulim?

Unë di në këtë qytet, ku disa prej dijetarëve i kanë kritikuar disa tregtarë që përdorin femrën për reklama propagandistike. Të gjithë tregtarët janë hidhëruar nga kjo kritikë. Di se në mesin e dijetarëve ka që kanë kundërshtuar harxhimet e shumta nëpër dasma dhe gëzime të llojllojshme. Autorët e këtyre veprave i refuzojnë me ashpërsi këto kritika. Po ashtu, prej dijetarëve kush i refuzon bidatet e xhamive dhe zbukurimet e shumta, duke i përkujtuar me ndalimin e Muhamedit a.s. dhe duke kërkuar prej organizatave të ndryshme që të jenë të realltë në këtë çështje. Mirëpo, ata nuk kanë pranuar, duke ua tërhequr vërejtjen që mos të përzihen në këto çështje. Prej dijetarëve, kush ua ka tërhequr vërejtjen grupacioneve të ndryshme, organizatave, institucioneve rreth disa gabimeve ose lëshimeve që kanë depërtuar tek ata, që duhet punuar me ato këshilla, që të gjitha i kanë refuzuar duke mos pranuar asgjë prej tyre.

Sikur që ata dijetarë dhe këshilltarë në vend se të merren me kësolloj kritikash, të merreshin me kritika ndaj udhëheqësve, do t'u mjaftonte dhe do të konsideroheshin si trima në sytë e këtyre shtresave dhe grupacioneve. Këshilltarë po, por duhet të marrin këshilla dhe udhëzime prej njerëzve.

Dijetarë po, por duhet t'u përmbahen udhëzimeve që ua diktojnë njerëzit. A nuk është ky dialog i pafrytshëm dhe fitneja depërtuese?!

POR, CILA ËSHTË ZGJIDHJA?

Zgjidhja është kur dijetari synon me punën e tij pëlqimin e Allahut xh.sh. Atëherë, ai do të jetë i lirë prej të gjitha gravitacioneve njerëzore, sado që të jenë të larta ose të ulëta. Atëherë, do të hipë në minberin që e ka caktuar Allahu xh.sh. për të. Prej tij i sheh të gjithë njerëzit të barabartë. Saherë që sheh të mira, i përkrah dhe ndihmon për të, pa marrë parasysh burimin e këtyre të mirave dhe saherë që sheh të këqija, i kritikon dhe këshillon për largim prej tyre, pa marrë parasysh burimin e këtyre të këqijave, për të bërë kapital të tij me atë që urdhëron ose ndalon dashurinë e gjithë robërve të Allahut duke i mëshiruar.

Për këtë punë, dijetari duhet të ketë parasysh hadithin e Muhamedit a.s. të cilin e transmeton Tirmidhiu nga Ajsheja r.a. ku thotë: "Kush i pajton njerëzit duke e hidhëruar Allahun, Allahu e le në duart e njerëzve, ndërsa kush i hidhëron njerëzit për ta pajtuar Allahun, Allahu ia kryen problemet e tij prej njerëzve".


Le ta dijë se kush thellohet në detërat e besimit, ndërpritët prej njerëzve dhe prej nevojës për ta, atëherë është lehtë për të që të mos interesohet përpos për pëlqimin e Allahut. Ndërsa ai që thellohet në detrat e kësaj bote dhe epsheet e saj, pa dyshim që ajo do ta pengojë prej Allahut ku mandej ai nuk interesohet pos për pëlqimin e njerëzve, sepse ai nuk sheh dikë tjetër përpos tyre dhe, më në fund, nuk do të arrijë diç që e bën të lumtur.

O Allah, na bën të lumtur me besim të pastër që të mos shohim në këtë hapësirë askënd përpos Teje, të mos shpresojmë asgjë tjetër përpos pajtimin Tënd dhe të mos frikësohemi përpos prej Teje. Amin.

**Përshtati nga arabishtja:
Naser Ramadani**

Format e Muzikës Fetare (5)

Mi'raxhije



MR.ABAS JAHJA

Në shkrimin e kaluar në mënyrë ilustrative përmendëm diç për këtë formë muzikore dhe thamë se për këtë temë do të flasim në një shkrim të veçantë.

Kjo formë e muzikës fetare nuk është një temë që mund të tejkalohet me disa fjalë, për shkak se kjo paraqet formën më të madhe, më të gjatë, më të komplikuar respektivisht është forma më artistike dhe më grandioze e muzikës fetare.

Fjala Mi'raxhije në kuptimin gjuhësor do të thotë: Shkallë, vendi i ngritjes, të ngriturit në qiell, por kjo fjalë është përdorur apostafat për të Dërguarin e Allahut f.p, Muhamedin a.s.

Sipas burimeve fetare Mi'raxhi tregon për ngjarjen e ngritjes së Pejgamberit a.s në sferat më të larta qiellore, e cila ngjarje ka ndodhur në vitin e nëntë të shpalljes së Kuranit famëlartë, respektivisht në natën e 27 të muajit Rexheb, Mu për këtë shkak edhe e tërë bota Islame e festoon dhe e madhëron këtë natë shumëw e madhe historike, për arsye se në këtë natë kanë ndodhur shumë ngjarje të jashtëzakonshme të historisë së njerëzimit.

Kur jemi duke folur për këtë formë muzikore padyshym që këtu na përkujtohet kompozitori i famshëm i historisë së muzikës fetare që jetoi në gjysmën e parë të shek XVIII, kryenejzeni dhe shejhi i Mevlevihanes së Gallatës " Kutbun-naji" Osman Dedeja. Këtë nofkë e mori për shkak se ishte virtioz i madh në instrumentin e Najit, nofkë e cila do të thotë: "më i larti, më i miri ose i pari i Nejzenëve.

Naji Osman Dedeja ishte një personalitet me aftësi dhe kapacitete shumë të larta muzikore. Kur thamë se kjo formë muzikore është forma

më e gjatë dhe më e komplikuar e muzikës fetare kishim parasyshë atë se për të bërë një kompozicion të tillë nevojitet kapacitet dhe dituri e madhe, jo vetëm në aspektin ekzekutues (praktik), por edhe njohja e teorisë së muzikës. Shkurt thënë ai në të njëjtën kohë e shkroi edhe tekstin edhe komponimin e tekstit.

Është interesant momenti i asaj se si lindi ideja për shkruarjen e Mi'raxhijes. Në një natë të Regaibit në Dërgahun e Mehmed Nasuhit në Yskydar ku ishin prezentw dijetarë dhe shejhlërë të ndryshëm, si Ali Alaudin efendiu, Abdullah Salahi efendiu, Sejid Mustafa efendiu dhe vetë Mehmed Nasuh efendiu, i cili dha një propozim duke thënë: "Si do të ishte sikurse të shkruhet një Mi'raxhije dhe të lexohet në netët e Mi'raxhit sikurse që është edhe Mevludi?" Të gjithë të pranishmit këtë propozim të Mehmed Nasuhit e pëlqyen dhe propozuan që këtë punë të madhe ta merr përsipër Osman Dedeja, i cili edhe e pranoi këtë propozim.

Për fat të mirë kjo vepër ka aritur të mbijetojë deri më sot kurse notat e kësaj nuk kanë përfunduar sikurse mevludi. Këtë kompozicion e ka botuar muzikologu i madh Subhi ezgin i cili vdiq në vitin 1962.

PJESËT E MIRAXHIJES

Kjo vepër voluminoze përbëhet prej gjashtë pjesëve dhe pjesës së lutjes-duasë. Çdo pjesë merr emrin "Haane" dhe secila pjesë lexohet me mekam të posaçëm duke filluar sipas radhitjes:

- Pjesa e parë me mekamin segah
- Pjesa e dytë me mekamin mustear
- Pjesa e tretë me mekamin dugah

- Pjesa e katërt me mekamin nevaa
- Pjesa e pestë lexohet me mekamet saba dhe husejni
- Pjesa e gjashtë lexohet me mekamin nishabur.

Duhet të theksojmë se pjesa e katërt e cila është e kompozuar me mekamin nevaa, për shkak se notat janë harruar nuk ka mbetur deri me sot.

Tevshihet të cilat lexohen në mesin e pjesëve janë në gjuhën Arabe dhe janë të shkruara nga ana e shejh Mehmed Nasuhit, ndërsa Tevshihu në gjuhën Perse, e cila lexohet para pjesës dhe është në mekamin husejni që është shkruar nga ana e mistikut të madhë Mevlana Xhelaludin Rumiut.

Mi'raxhija sipas traditës lexohej tre ditë me rradhë duke filluar një ditë para natës së Mi'raxhit, natën e Mi'raxhit dhe një ditë pas saj. Pra me fjalë tjera leximi ka zgjatuar tre ditë me rradhë. Në të shumtën e rasteve lexohej nga dy persona dhe rëndësi të madhe i kushtohej harmonisë dhe përputhjes së zërave të lexuesve. Tevshihet të cilat lexohen para pjesëve të Mi'raxhijes këndohen nga ana e korit të cilët janë të ulur para Kursisë. Në mes të pjesëve kori përsërit fjalën "Sal-lu Alejh", ndërsa në pjesët e fundit përsëritet fjala "Min-na Salah", në pjesën e lutjes-duasë në çdo strofë përsëritet fjala "Ikbel ja Muxhib".

Ka qenë traditë që gjatë leximit të Mi'raxhijes tw shpërndahet qumsht për të pranishmit sikurse që parktikohet gjatë leximit të mevludit, ndarja e sherbetit.

Në fund lirisht mund të konkludojmë se kjo formë muzikore paraqet një vepër shumë të madhe artistike, e cila me kompozimin e Naji Osman Dedes u pëlqye shumë nga muzicentët e famshëm të asaj kohe, njëherit u mirëpritë dhe u pranua edhe nga vetë masa. Kjo vepër pati refleksion të madh edhe te tarikatet e ndryshme, posaçërisht në rendin e mevlevive.

Përsa i përket praktikimit të leximit të Mi'raxhijes në vendet tona mund të themi lirisht se kjo vepër nuk lexohet te ne si vepër xhamije e as si vepër teqeje, sepse është një formë e gjate që kërkon parapërgatitje, pririje dhe njohje më profesionale muzikore, madje është vepër e rëndë për interpretim nga ana e antarëve. Në Turqi praktikisht interpretohet vetëm në disa mjedise shumë profesionale. Kjo vepër është interpretuar nga ana e kompozitorit të madh të këtij shekulli Ahmed Hatipoglu në bashkëpunim me korin e Radio Televizionit të Turqisë, i cili medium kishte bërë inçizimin dhe sponsorimin e dy kasetave.

URTËSITË E NJERËZVE TË MËDHEJ

Fjalë të urta nga Llukman Hakimi

"O biri im, kur të jesh në namaz ruaje zemrën tënde, kur të jesh në shtëpi të huaj ruaji sytë e tu, kur të jesh në mesin e njerëzve ruaje gjuhën tënde."



REXHEP ZIBERI

Në literaturën Islame njihet si Llukmani i urtë. Shumica e dijetarëve Islam janë të mendimit se ai nuk është Pejgamber por është njeri i urtë dhe një nga kuptimet e fjalës urtësi është të mund të dallosh të vërtetën dhe enigmën e materies dhe kjo është e mundur me anë të shfaqjes në zemër dritën hyjnore.

Zemahsheriu si shembull të urtësisë së Llukman Hakimit na përcjellë këtë ndodhi: "Një ditë Davudi a.s kërkoj nga Llukmani që të therte një dele dhe t'i sillte dy copa mishi nga vendi më i mirë i sajë. Llukmani e theri delen dhe i çoi Davudit gjuhën dhe zemrën e saj, pasi kaluan disa ditë Davudi a.s kërkoj të therte përsëri një dele dhe ti sillte dy copa mishi nga vendi më i keq i deles. Llukmani përsëri i dërgoi zemrën dhe gjuhën, kur Davudi a.s kërkoj të dinte shkakun Llukmani u përgjigj:

"Po të dalin të mira këto të dyja (zemra dhe gjuha) mund të dalin të tjera më të mira se këto, por po të jenë të këqija këto të dyja më të këqija se këto nuk mund të ketë!"

Katadeja thotë: "Kur Llukman Hakimi u la i lirë nga Zoti për të zgjedhë profetësinë apo urtësinë ai zgjodhi urtësinë. Kur u pyet për shkakun tha: Profetësia është një përgjegjësi e madhe, pata frikë se mos nuk do ta kryej dot si duhet."

Në një hadith të transmetuar nga Abdullah Ibni Omeri thuhet: "Llukmani nuk ishte profet, por një rob që adhuronte. Allahu i lartë e ruajt atë prej mëkateve. Ai meditonte shumë. Besimin e kishte të fortë. Allahun e donte, edhe Allahu e donte atë, Allahu i lartë i dhuroi atij urtësi."

Pa marrë parasysh polemikat e dijetarëve lidhur me të se a ishte Pejgamber, evlia ose njeri i devotshëm, më me rëndësi është se Kurani famëlartë e përmend emrin e tij dhe se Allahu fuqiptotë i ka dhënë mençuri dhe një sure e plotë është emëruar me emrin e tij.

NË SUREN LLUKMAN ALLAHU F.P PËR TË THOTË:

"Ne i dhamë Llukmanit urtësi e i thamë: Falëndero Allahun.

Kush falënderon, falënderon për vete, e kush kundërshton, ta dijë se Allahu nuk ka nevojë për asgjë, se Ai është vetvetiu i denjë për ç'do falënderim." (Lukman; 12)

Kur është pyetur se si arriti të bëhet aq i urtë e i mençur është përgjigjur me tre gjëra:

1.Me kryerjen e Amaneteve që merrja për sipër;

2.Duke e folur të vërtetën;

3.Duke mos iu kushtuar rëndësi gjërave që nuk më interesonin;

Lidhur me profesionin e tij në literaturën Islame hasen mendime të ndryshme se ka qenë bari, zdrukthëtar, rob etj. Ne në këtë rast do të përmendim disa nga këshillat që Llukmani ia drejtoi të birit e që jemi thellë të bindur se në kohën e sodit janë të dobishme dhe efektive për secilin prej nesh.

"Dhe kur Llukmani duke e këshilluar, birit të vet i tha: "O djali im, mos i përshkruaj Allahut shok, sepse idhujtaria është padrejtësia më e madhe"

"O djali im s'ka dyshim se edhe nëse ajo vepra peshon sa kokrra e lirit, e të jetë e fshehur në rrasë guri, ose në qiej apo në tokë, Allahu do ta sjellë atë, se Allahu është i butë dhe hollësisht i informuar."

"O djali im fale namazin, urdhëro për punë të mira, e ndalo nga të këqijat, përballo me durim çdo gjë që të godet, vërtetë këto janë nga çështjet më të preferuara."

"Dhe mos shtrembëro fytyrën tënde prej njerëzve, mos ec nëpër tokë kryelartë se Allahu nuk e do asnjë mendjemadh që shumë lavdërohet."

"Të jesh i matur në ecjen tënde, ule zërin tënd, se zëri më i egër është zëri i gomarit." (Llukman; 13-19)

Disa këshilla të Llukman Hakimit që janë të radhitura nëpër shumë vepra autoritative Islame:

O biri im, merre devotshmërinë për tregti që të të vjen fitimi pa investuar asgjë.



O biri im, prezanto në faljen e xhenazeve e jo nëpër ahengje, sepse Namazet e xhenazeve ta përkujtojnë ahiretin kurse ahengjet dunjanë.

O biri im, mos u bëj më i pafuqishëm edhe se gjeli i cili këndon herët në mëngjes e ti të flesh në shtrat.

O biri im, asnjëherë nuk jam penduar për heshtje, nëse të folurit është nga argjendi heshtja është nga ari.

O biri im, bëhu rob i çdo të mire e mos u bëj foshnje e asnjë të lige.

O biri im, mos mëso diç të re për deri sa nuk punon nga ajo që e din prej më parë.

O biri im, ruaju nga borxhi sepse borxhi të sjell nënçmim gjatë ditës dhe mërzit gjatë natës.

O biri im, kur të jesh në namaz rruaje zemrën tënde, kur të jesh në shtëpi të huaj ruaji sytë tuaj, kur të jesh në mesin e njerëzve ruaje gjuhën tënde.

O biri im, gjithmonë të jesh i gatshëm të dëgjosh, e jo gjithmonë të flasësh.

O biri im, nëse do të shoqërohesh me dikë në fillim hidhëroje, nëse vepron realisht, prano shoqërinë e tij, e nëse tenton të të hakmerret ruaju dhe largohu prej tij.

O biri im zgjidh shok të tillë që kur të ndahesh ti prej tyre, as ti ata, as edhe ata ty të mos të marrin nëpër gojë.

O biri im, ai që nuk mund të jetë zot i gjuhës së tij padyshim një ditë do të pendohet.

O biri im, ushtro gjuhën tënde me fjalët All-llahum-me gfirli, (O Zot më fal mua) sepse është një çast kur Allahu nuk e kthen lutjen papë.

O biri im, mos i këshillo njerëzit të jenë të devotshëm deri sa edhe vet të bëhesh i tillë, sepse përndryshe do të jesh si qiri që të tjerët i ndritë kurse vetë digjet dhe harxhohet.

O biri im, ti tregosh një çështje njeriut që nuk kupton, është më e vështirë se të lëvizësh një shkëmb që nuk lëviz, nga vendi.

O biri im harroi të mirat që i ke bërë tjetrit dhe harroi të këqijat që ti ka bërë tjetri ty.

Në gurin e unazës së Llukman Hakimit shkruante: "Fshehja e asaj që ke parë është më e dobishme se

Burimet e Buhariut në librin “Menakib el-Ensar”

Me fjalën ‘burime’ mendohen gjeneratat e transmetuesve, të cilëve autori i kësaj vepre (Buhariu) u referohet gjatë transmetimit të haditheve. Ata janë: as’habët, tabiinët, tebeitabinët, tebeietbait-tabinët dhe mësuesit e Buhariut



MR. SC. FAHRUDIN EBIBI (ENKAS PËR HËNA E RE)

A. AS’HABËT

As’hab llogaritet çdo individ nga radhët e muslimanëve, i cili e ka parë ose që e ka shoqëruar (që e ka përcjellë gjatë jetës së vet) Pejgamberin *sal-lall-llahu alejhi ves-selm*.¹ Të dalluar me transmetimet e tyre në “Menakib el-Ensar” prej gjeneratës së as’habëve janë tetë (8) e ata janë: Enes b. Maliku, Aisheja -nëna e muslimanëve, Abdullah b. Abbasi, Abdullah b. Omeri, Ebu Hurejreja, El-Berra b. Azib, Xhabir b. Abdullah, Abdullah b. Mes`ud. Në librin “Menakib el-Ensar” vërehet qartë se të dalluar me numrin e haditheve që kanë transmetuar nga gjenerata e as’habëve janë ata të cilët janë të dalluar me numrin e madh të haditheve që kanë transmetuar në përgjithësi në shkencën e hadithit, siç është Enes b. Maliku, Aisheja, Ebu Hurejreja, Abdullah b. Omeri etj. prandaj shtrohet pyetja: ç’është motivi i cili ka bërë që ky grup prej gjeneratës së as’habëve të dallohet nga as’habët e tjerë me transmetimin e numrit të madh të haditheve? Përgjigjja e kësaj pyetje do të ishte siç vijon:

* Për disa persona nga radhët e as’habëve Pejgamberi *alejhis-selam* kishte bërë lutje që ata të mos harronin, siç është rasti me Ebu Hurejren. Ebu Hurejreja iu ishte ankuar Pejgamberit *alejhis-selam* duke i thënë: “Vërtet unë po dëgjoj shumë hadithe prej teje, mirëpo, përsëri, po i harroj”. “Shtrije gunën tënde”, i tha Pejgamberi. Unë e shtrova gunën, pohon Ebu Hurejreja, dhe ai (Pejgamberi

alejhis-selam) me duart e tij hodhi diçka në të dhe tha: “Mbështilla me të!”, u mbështolla dhe pas kësaj më asgjë nuk kam harruar, thekson Ebu Hurejreja.²

* Disa prej as’habëve ishin shumë të fortë në të mbajturit mend, siç ishte Ebu Hurejreja.

* Pranimi i fesë Islame herët, ishte shkak që disa as’habë të ishin të dalluar me transmetimin e numrit të madh të haditheve, siç është Abdullah b. Omeri.

* Interesimi i madh i disa as’habëve për dituri ishte shkak që ata të dalloheshin nga të tjerët në transmetimin e haditheve. Arsye tjetër që ka shkaktuar që disa as’habë të ishin të dalluar në transmetimin e haditheve, ishte se ata vazhdimisht ishin me Pejgamberin *alejhis-selam* dhe në përcjellje të tij, siç është rasti me Ebu Hurejren, Enes b. Maliku, Abdullah b. Omerin dhe Abdullah b. Abbasin.

* Përcaktimi për shkencë dhe dituri dhe mësimi i haditheve nga ana e njerëzve pas vdekjes së Muhamedit *alejhis-selam*, gjithashtu edhe mosangazhimi i tyre me punë të tjera administrative, udhëheqëse etj., ishte shkak që disa prej gjeneratës së as’habëve të dalloheshin me një numër të madh të transmetimit të haditheve të Pejgamberit *alejhis-selam*.

* Jeta e gjatë e disa as’habëve pas vdekjes së Muhamedit *alejhis-selam* ishte shkak që disa as’habë kishin arritur të transmetonin shumë hadithe, siç ishte Enes b. Maliku, Ebu Hurejreja dhe Aisheja. Nga këta as’habë një numër i madh prej

gjeneratës së dytë (tabiinëve) kishin pranuar (mësuar) hadithe. Këto janë disa nga motivet më kryesore që disa as’habë të cilësoheshin si të dalluar për sa i përket numrit të haditheve që kanë transmetuar. Ndërkaq, numri i haditheve që kanë transmetuar as’habët e tjerë në librin “Menakib el-Ensar” është simbolik. Ndoshta mosplotësimi i kriterëve që u theksuan ka shkaktuar transmetimin e paktë të tyre haditheve.

Në vazhdim pason një biografi e shkurtër për secilin as’hab që është dalluar nga gjenerata e as’habëve me transmetimin e haditheve në librin “Menakib el-Ensar”, të radhitur sipas numrit të haditheve që ka transmetuar.

1. ENES B. MALIK

Ky është Enes b. Malik b. En-nadar b. Damdam. Prejardhja e tij përfundon tek Ibni Adi b. En-nexh-xhar. Mbiemërimi i tij është Ebu Hamza el-Ensar el-Hazrexhi.³ Sipas variantit tjetër, thuhet që mbiemërimi i tij është Ebu Nadër el-Medeni. Enesi ishte shërbëtor i të Dërguarit të Allahut xh.sh. Në një rast ai ka thënë: “Kur ka ardhur i Dërguari i Allahut në Medinë, unë isha dhjetë vjeç, ndërkaq kur ka vdekur ai, unë i kisha mbushur njëzet vjet”. Enesi gjatë tërë kësaj kohe e kishte përcjellë, respektivisht, pandërprerë e kishte shoqëruar Muhamedin *alejhis-selam* deri në vdekje. Enesit iu ishte parashtruar pyetja se a ka marrë pjesë në Bedër? ‘Si mund të mungoj nga Bediri?!’, është përgjigjur ai.

Historianët nuk e kanë llogaritur Enesin në mesin e atyre që kishin marrë pjesë në luftën e Bedrit, mirëpo e vërteta qëndron në atë se Enesi ka marrë pjesë, por ka qenë i ri, nuk ka luftuar, ka qëndruar te çadrat e ushtrisë muslimane.⁴

Hadithe ka transmetuar nga Muhamedi *alejhis-selam*, nga Ebu Bekri, Omeri, Othmani, Muadhi, Usejd b. Hudajri, Ebu Talha, nga nëna e vet Ummi Sulejm, nga Ubade b. Es-samit, nga Ebu Dherri, nga Ebu Hurejreja, nga Fatime Ez-zehra etj. Ndërkaq, nga Enesi kanë transmetuar hadithe rreth dyqind persona. Ndër më të njohurit janë: Hasanul Basriu, Ibni Sirini, Sha'biu, Ebu Kilabe, Mekhuli, Omer b. Abdul Azizi etj.⁵

Vlen të theksohet se Enes b. Maliku ka ditur të shkruante, përkatësisht, e ka përdorur shkrimin. Mu për këtë shkak se ai ka ditur të shkruante, Ebu Bekri në kohën e vet e kishte dërguar Enesin korrier zyrtar në Bahrein.

Qysh si i ri Enesi kishte shprehur dëshirë për dituri. Ai shpeshherë bijve të vet u thoshte: 'O bijtë e mi, regjistroni, shkruajeni diturinë'.⁶

Me sa duket, Enesi nxënësve të vet u diktonte hadithe dhe ata i regjistronin. Sipas disa transmetimeve, bëhet e qartë se Enesi ka pasur një numër të madh librash. Kur Enesi u tregonte njerëzve hadithe dhe kur numri i tyre ishte i madh, ai i prezantonte, respektivisht, i sillte librat dhe thoshte: "Këto janë hadithe që unë i kam dëgjuar dhe që i kam regjistruar nga i Dërguari i Allahut xh.sh. dhe që atij ia kam paraqitur".⁷

Enesi ishte shpërngulur nga Medina dhe ishte vendosur në Basra. Ai ishte as'habi i fundit që ka vdekur në Basra në vitin 93 h. rreth moshës njëqind e tre (103) vjeç.

2. AISHEJA - NËNA E MUSLIMANËVE

Aisheja është e bija e Ebu Bekër Es-siddikut. Nëna e Aishes quhej Ummi Ruman Binti Amir. Aisheja ka lindur katër ose pesë vjet pas shpalljes së Muhamedit për pejgamber. Mbiquhej Ummi Abdullah. Prej gjeneratës së

as'habëve Aisheja konsiderohet femra më e zgjuar. Pejgamberi *alejhis-selam* është fejuar me të kur ajo ishte në moshën gjashtë ose shtatëvjeçare. Ndërkaq, është martuar me të kur ajo i kishte mbushur nëntë vjet. Kur ka ndërruar jetë Muhamedi *alejhis-selam*, Aisheja kishte mbushur dybëdhjetë vjet. Aisheja e ka shoqëruar, përkatësisht, e ka përcjellë Pejgamberin *alejhis-selam* tetë vjet e pesë muaj.⁸

Aisheja ka transmetuar hadithe nga Pejgamberi *alejhis-selam*, Ebu Bekri, Omeri, Fatimeja, Sa'di etj.⁹ Musnedi i Aishes përmban në vete 2210 hadithe.¹⁰ S'ka dyshim që Aisheja ka ditur të lexonte, ndërkaq se a ka ditur ajo të shkruante është çështje diskutabile, mirëpo në disa transmetime potencohet se ajo ka ditur të shkruante. Sha'biu ka thënë: "Muaviu përmes një letre kishte kërkuar nga Aisheja që ajo t'i shkruante atij ndonjë hadith që ajo e kishte dëgjuar nga Pejgamberi *alejhis-selam*. Në përgjigjen e saj, i shkruan Muaviut këtë hadith: "E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut xh.sh: 'Vërtet, ai që vepron pa iu nënshtuar Allahut, lavdëruesi nga njerëzit atë do ta fyejë - do ta mallkojë".¹¹ Është e vërtetë, ndërkaq, që Aisheja ka pasur shkronjësit e vet, të cilët kanë shkruar për Aishen, siç ishte Urve b. Ez-zubejri dhe Zijad b. Ebi Sufjani.¹² Në librin "Menakib el-Ensar" Aisheja ka transmetuar një numër të konsiderueshëm hadithesh.

3. ABDULLAH B. ABBASI

Abdullah b. Abbas b. Abdulmutalib b. Hisham është cilësuar me një sërë epitetesh: Imam, dijetar i këtij ummeti dhe komentator-shpjegues i Kur'anit. Mbiquhej Ebul Abbas el-Kureshi el-Hashimi. Abdullah b. Abbasi është djalë i axhës (kushëri) i Pejgamberit *alejhis-selam*. Është as'habi i njohur dhe bir i as'habit të njohur, pra është djalë i Abbasit. Sipas disa transmetimeve kur ka ndërruar jetë Muhamedi *alejhis-selam*, Abdullah b. Abasi ka qenë trembëdhjetëvjeçar.¹³ Për Abdullah b. Abbasin Pejgamberi *alejhis-selam* i

ishte lutur Allahut: "O Zot, mësoja urtësinë".¹⁴ Gjithashtu është lutur: "O Zot, udhëzoje në fenë e vërtetë".¹⁵

Abdullah b. Abbasi ka transmetuar hadithe nga Pejgamberi *alejhis-selam* nga hulefai rashidinët, nga prindi i vet Abbasi, nga nëna dhe vëllai i vet el-Fadël, nga Mejmuneja (halla e tij), nga Ebu Hurejreja etj. Nga Ibni Abbasi kanë transmetuar hadithe shumë veta. Ndër më të njohurit janë: Abdullah b. Omeri, Tha'lebe b. el-Hakem, el-Musevir b. Mahreme (nga as'habët), Seid b. el-Musejjibi, Ikreme, Ataë, Tavusi, bijtë e Abdullah b. Abbasit Aliu dhe Muhamedi etj.

Abdullah b. Abbasi në kohën e vet ka regjistruar hadithet e Pejgamberit *alejhis-selam* dhe në këtë drejtim i ka nxitur edhe të tjerët.¹ Në kohën e vet Ali r.a. Ibni Abasin e kishte caktuar emir të Basrës, pastaj është tërhequr nga ai post para se të binte dëshmor Aliu r.a. Kah fundi i jetës ishte verbuar dhe në vitin 68 h. ka ndërruar jetë në Taif.

Në librin "Menakib el-Ensar" Buhariu në shumë kaptina ka paraqitur hadithe të transmetuara prej tij.

4. ABDULLAH B. AMRI

Ky është Abdullah b. Omer b. Hatab b. Nufejl el-Kureshi el-Adevi. Është i njohur si Ebu Abdurrahman el-Meki, pastaj është njohur edhe si el-Medeni. Ishte fekih i njohur nga gjenerata e as'habëve, i njohur si dijetar si në fushën teorike, po ashtu edhe në fushën praktike. Abdullahu e kishte pranuar fenë islame në vegjëli dhe bashkë me prindin e vet kishte migruar nga Meka në Medinë. Sipas një transmetimi tjetër, thuhet që Abdullahu ka migruar para prindit të vet. Për shkak të moshës së tij të re, i Dërguari i Allahut *sal-lall-llahu alejhi ves-selm* nuk e lejoi Abdullahun të merrte pjesë në luftën e Bedrit dhe të Uhudit. Në moshën e tij pesëmbëdhjetëvjeçare ishte i pranishëm në luftën e Hendekut. Po ashtu ka qenë i pranishëm edhe në marrëveshjen e njohur si "Bej'atur Ridvan". Më pas

Abdullahu kishte marrë pjesë në të gjithë betejat, luftërat, me të Dërguarin e Allahut *sal-lall-llahu alejhi ves-selm* dhe pas vdekjes së Muhamedit *alejhis-selam* kishte marrë pjesë në luftën e njohur në Jermuk, në çlirimin e Egjiptit dhe në luftërat në veri të Afrikës. Pejgamberi *alejhis-selam* e kishte lavdëruar Abdullahun dhe i kishte thënë: “Vërtet, Abdullahu është burrë i mirë”. Hadithe kishte transmetuar nga Pejgamberi *alejhis-selam*, nga prindi i vet, nga xhaxhai Zejdi, nga motra Hafseja, nga Ebu Bekri, Othmani, Ebu Dherri, Muadh b. Xhebeli, nga Aisheja etj. Ndërkaq, prej gjeneratës së as’habëve që kanë transmetuar hadithe nga Abdullahu janë: Xhabir b. Abdullah el-Ensari, Abdullah b. Abbasi. Gjithashtu, nga Abdullahu hadithe kanë transmetuar bijtë e vet: Bilalli, Hamza, Zejdi, Salimi dhe Abdullahu. Gjithashtu, hadithe prej tij kanë transmetuar: Nafiu, Salim Meula Omer, Urve b. Zubejri, Seid b. Musejibi, Mesruku, Atau, Muxhahidi etj.ⁱⁱ Abdullahu ka bërë regjistrimin e haditheve të Pejgamberit *sal-lall-llahu alejhi ves-selm*ⁱⁱⁱ dhe kishte libra të cilët i shfletonte, përkatësisht i lexonte.^{iv} Një njeri i kishte shkruar një letër Ibni Omerit dhe e kishte pyetur për diturinë (hadithet) dhe Ibni Omeri atij ia ktheu letrën.^v Shumë prej nxënësve të tij shkruanin hadithe nga Ibni Omeri, siç janë: Seid b. Zubejri, Ubejdilal b. Omeri dhe Nafiu.^{vi} Abdullah b. Omeri ka vdekur në Mekë, në vitin 73 h., tre muaj pas vrasjes së Abdullah b. Zubejrit. Sipas një varianti tjetër, thuhet që Abdullah b. Omeri ka vdekur në vitin 74 h., afërsisht në moshën 84-vjeçare. Buhariu në librin “Menakib el-Ensar” ka transmetuar një numër hadithesh nga Abdullah b. Omeri.

5. EBU HUREJREJA

Rreth emrit të këtij as’habi dhe emrit të prindit të tij ka shumë fjalë. Emri i tij i vërtetë dhe më i njohur, sipas shumicës së dijetarëve, është Abdurrahman b. Sahar Ed-dusi el-Jemani. Në periudhën paraislame emri i tij ka qenë Abdush-shems b.

Sahar, mirëpo kur ai e kishte pranuar Islamin, i Dërguari i Allahut *sal-lall-llahu alejhi ves-selm* i kishte vënë emrin Abdurrahman. Sipas variantit tjetër, thuhet se Muhamedi *alejhis-selam* i kishte dhënë emrin Abdullah. Ndërkaq, mbiemërimi i tij ishte Ebu Hurejre, me të cilin është popullarizuar, përkatësisht është shquar.¹⁶ Ka transmetuar shumë hadithe nga Pejgamberi *sal-lall-llahu alejhi ves-selm*. Gjithashtu, ka transmetuar nga Ebu Bekri, Omeri, Ibni Abbasi, Ubej b. Ka`bi, Usame b. Zejdi, Aisheja etj. Sa i përket nxënësve të cilët kanë transmetuar hadithe prej këtij, ata janë shumë, mbi tetëqind. Me sa duket, në fillim Ebu Hurejreja nuk ka pasur libra dhe ai nuk i ka regjistruar hadithet. Në një rast ai ka thënë: “Nuk ka asnjë shok i Pejgamberit që ka nxënë (që ka marrë) hadithe prej tij më shumë se unë, në përjashtim të Abdullah b. Amrit, i cili shkruante (regjistronte hadithe), ndërkaq unë nuk shkruaja”.¹⁷ Por, më vonë theksohet se ai i ka regjistruar, i ka shkruar hadithet dhe ka pasur transmetues që i kanë regjistruar hadithet të cilat Ebu Hurejreja i ka transmetuar, siç është Muhamed b. Sirini dhe të tjerët.¹⁸ Dijetarët kanë mendime të ndryshme rreth vitit të vdekjes së tij, mirëpo mendimi më i vërtetë është ai se Ebu Hurejreja ka vdekur në Medinë në vitin 59 h. Thuhet se ai ka vdekur në vitin 57 ose në vitin 58 h. diku rreth moshës 79-vjeçare. Megjithëse Ebu Hurejreja e kishte pranuar Islamin vonë, prapëseprapë transmetimet e tij janë të shumta dhe në librin “Menakib el-Ensar” Buhariu ka transmetuar disa hadithe nga Ebu Hurejreja.

6. EL-BERRA B. AZIB

El-Berra b. Azib b. el-Harith b. Adi el-Evsi ishte shok i Pejgamberit *alejhis-selam* dhe i biri i shokut të Muhamedit *alejhis-selam*. Mbiemërimi i tij ishte Ebu Ammar. Thuhet Ebu Amër ose Ebu Tufejl el-Medeni. Ka qenë fekih i madh. Shkoi në Kufë dhe atje ka vdekur në kohën e Mus`ab b. Zubejrit.¹⁹ Ka

transmetuar hadithe të shumta nga Pejgamberi *sal-lall-llahu alejhi ves-selm*, nga Ebu Bekri, Omeri, Aliu, Ebu Ejubi, Bilalli etj. Prej tij hadithe kanë transmetuar: Abdullah b. Zejd el-Hatmi dhe Ebu Xuhajfe, me të cilët ka qenë shok. Gjithashtu, nga el-Berrai hadithe kanë transmetuar bijtë e tij: Ubejdi, Rebiu, Jezidi dhe Luti. Po ashtu, hadithe prej tij kanë transmetuar: Ibni Ebi Lejla, Adij b. Thabiti, Ebu Is`haku etj. Ibni Hibbane ka thënë: “Për shkak të moshës së tij të re, Pejgamberi *sal-lall-llahu alejhi ves-selm* nuk e la të merrte pjesë në luftën e Bedrit”. Ka vdekur në vitin 71 ose 72 h., mbi 80 vjeç.²⁰ Në tubimet e el-Berrait nxënësit e vet regjistronin hadithe prej tij.²¹ Në librin “Menakib el-Ensar” Buhariu ka transmetuar nga el-Berrai tetë hadithe.

7. XHABIR B. ABDULLAH

Xhabir b. Abdullah b. Amër, Ebu Abdullah el-Ensari el-Hazrexhi, është shok i Muhamedit *alejhis-selam*, është fekih dhe myfti i Medinës në kohën kur jetoi. Në mesin e shtatëdhjetë vetave nga ensarët, ishte edhe ky me rastin e Besëlidhjes në Akabën e Dytë. Kishte dëshirë të merrte pjesë në luftën e Bedrit dhe të Uhudit, mirëpo prindi i vet e la në shtëpi që të kujdesej për motrat, ndërkaq ai vetë, respektivisht, babai i tij, doli në luftë.²² Pas vdekjes së prindit (Abdullahut), Xhabiri ishte i pranishëm në luftën e Hendekut, ishte i pranishëm në besëlidhjen e njohur si “Bej`atur Ridvan”, si dhe në të gjitha luftërat e tjera bashkë me Pejgamberin *alejhis-selam*. Hadithe ka transmetuar nga Pejgamberi *sal-lall-llahu alejhi ves-selm*, nga Ebu Bekri, Omeri, Aliu, Ebu Ubejd b. Xharrahi, Talha b. Ubejdullau, Muadh b. Xhebeli, Ammar b. Jasiri, Ebu Hurejreja, Ebu Seid el-Hudriu etj. Nga ky hadithe kanë transmetuar bijtë e tij: Abdurrahmani, Akili dhe Muhamedi. Gjithashtu, nga ky hadithe kanë transmetuar Seid b. Musejibi, Mahmud b. Lubejdi, Amër b. Dinari, Seid b. Mina, Talha b. Nafiu, Hasanul Basriu, Amir Esh-sha`biu etj. Ka jetuar një jetë të

gjatë, ndërsa kah fundi ishte verbuar. Sipas mendimit më të vërtetë, ai ka vdekur në Medine në vitin 78 h. dhe ky është as'habi i fundit që ka vdekur në Medine. Kur ka vdekur, ka qenë në moshën 94-vjeçare.²³ Xhabiri ishte prej atyre as'habëve që kanë ditur shkrimin dhe leximin. Nga Xhabiri hadithe kanë shkruar, respektivisht kanë regjistruar shumë veta. Ndër më të njohurit janë: Hasanul Basriu, Ebu Sufjani, Sulejman b. Kajsi, Ammar Esh-sh'abi, Abdullah b. Akili etj.²⁴ Në librin "Menakib el-Ensar" Buhariu ka transmetuar tetë hadithe nga Xhabir b. Abdullahu.

8. ABDULLAH B. MES`UDI

Ky është Abdullah b. Mes`ud b. Gafil dhe prejardhja e tij përfundon te Hudhejl b. Mudrike b. Ijas Ibni Mudar b. Nezari. Ishte i njohur si el-Imamul el-Bahr, fekih i këtij ummeti, Ebu Abdurrahman el-Hudheli el-Mekij.²⁵ Ishte prej të parëve që kishin pranuar Fenë Islame. Ka marrë pjesë në luftën e Bedrit dhe ka bërë dy migrimet. Për superioritetin e tij në Kur'an dëshmon vetë Pejgamberi *alejhis-selam* duke thënë: "Kur'anin, më

saktë drejtleximin e tij, merreni nga katër (persona): nga Abdullah b. Mes`udi - duke filluar me këtë, Salim Meula Ebi Hudhejfe, Muadh b. Xhebeli dhe Ubej b. Ka`bi".²⁶

As'habët e mëdhenj njohën meritat dhe pozitën e Abdullah b. Mes`udit në dituri. Kështu, në një rast, Omeri b. Hatabi përmes një shkrese, që ia kishte drejtuar popullit të Kufës, veç tjerash thotë: "Unë e kam dërguar deri te ju Ammarin emir, ndërsa Abdullah b. Mes`udin e kam dërguar si mësues dhe ministër. Këta dy janë nga shokët superiorë të Muhamedit *sal-lall-llahu alejhi ves-selm* dhe janë nga ata që kanë luftuar në Bedër. Ju dëgjojini këta dhe imitojini, ngase unë e vë Abdullahun në pozitë mbi veten time".²⁷

Një numër i madh transmetuesish kanë transmetuar hadithe prej tij. Nga as'habët që kanë transmetuar hadithe janë: Ebu Musa Esh`ariu, Umran b. Husajni, Ibni Abbasi, Ibni Omeri, Xhabiri, Ibni Zubejri, Ebu Seid el-Hudriu, Ebu Hurejreja etj. Nga tabiinët që kanë transmetuar hadithe nga ky janë: Alkameja, Ebu Vaili, Esvedi, Mesruku Ubejdeja, Kajsi, Ibni Ebi Hazimi etj. Të gjithë këta ishin nga tabiinët e mëdhenj.

Nëse kihet parasysh fakti që Abdullah b. Mes`udi e kishte pranuar Islamin herët, ishte gjithnjë me Muhamedin *sal-lall-llahu alejhi ves-selm* dhe e kishte përjetuar tërësisht periudhën e pejgamberllëkut. Interesimi i tij i madh për hadithet, aftësitë, fort të mbajturit mend, asketizmi në këtë botë, ishin faktorë që i kishin mundësuar Abdullah b. Mes`udit të pranonte, përkatësisht të mësonte, hadithe më shumë se të tjerët. Mirëpo, koha e shkurtër e jetës së tij pas Muhamedit *alejhis-selam* nuk i kishte mundësuar të transmetonte një numër të madh hadithesh, ashtu siç kishin transmetuar Ebu Hurejreja dhe të tjerë.²⁸

Abdullah b. Mes`udi lejonte të bëhej regjistrimi i haditheve. Për këtë vërtetojnë transmetime të shumta.²⁹ Abdullah b. Mesudi ka vdekur në Medine në vitin 32 h. në moshën mbi gjashtëdhjetëvjeçare. Sipas një mendimi tjetër, thuhet se ai ka vdekur në Kufë, mirëpo mendimi i parë është më i saktë. Në librin "Menakib el-Ensar" Buhariu ka transmetuar nga Abdullah b. Mesudi shtatë hadithe.

(Vazhdon)

¹ el-Buhari, Kitab Fedailus-sahabe, Bab Fi Fedaili As`habin-nebijj, f. 419.

² el-Buhari, Kitabul Ilm, Babu Hifdhil Ilm, hadithi nr. 119, f. 37.

³ Edh-dhehebi, Sijeru A`lamin-nubelaë, vëll. III, fq. 395-396. Muhamed b. Tahir,

Tedhkiretul Huffadh, vëll. I, f. 44 biografia nr. 23.

⁴ Edh-dhehebi, Sijeru A`lamin-nubelaë, vëll. III, f. 395 biografia nr. 62.

⁵ Po aty.

⁶ el-A`dhami, Dirasatun Fil Hadithin-nebevij, f. 100.

⁷ Po aty.

⁸ Shiko: Ibni Haxher, El Isabe, vëll. VIII, f. 16, biografia nr. 11407, Ibni Sa`d, Et-tabekatul Kubra, vëll. VIII, fq. 39-56, Edh-dhehebi, Sijeru A`lamin-nubelaë, vëll. II, f.135 biografia nr. 19, Muhamed b. Tahir, Tedhkiretul Huffadh, vëll. I, f. 27.

⁹ Edh-dhehebi, Sijeru A`lamin-nubelaë, vëll. II, 135, biografia nr. 19.

¹⁰ El-A`dhami, Dirasatun Fi Hadithin-neevij, f. 113.

¹¹ Musned Humejdi, vëll. I, f.139.

¹² El-A`dhami, Dirasatun Fi Hadithin-nebevij, fq. 113-114.

¹³ Muhamed b. Tahir, Tedhkiretul Huffadh, vëll. I, fq. 40-41, Edh-dhehebi, Sijeru A`lamin-nubelaë, vëll. III, fq. 331-359, biografia nr. 51, Ibni Haxher, El Isabe, vëll. IV, fq. 141-152, biografia nr. 4784.

¹⁴ el-Buhari, Kitab Fedailus-sahabe, Babu Dhikri Ibni Abbas r.a., hadithi nr. 3756, f. 740.

¹⁵ Po aty, Kitabul Ilm, Babu Vad`il Mai Indel Haxhe, hadithi nr. 143, f. 43.

¹⁶ Shiko: Ibni Haxher Tehdhib Et-tehdhib, vëll. XII, fq. 288-291, biografi nr. 1216, Edh-dhehebi, Sijeru A`lamin Nubelaë, vëll. II, fq. 578-631, biografi nr. 126, Ibnul Kajserani, Tedhkiretul Uffadh, vëll. I, fq. 32-37, biografi nr. 16, Ibni Haxher, El Isabe, vëll. VII, fq. 425-444, biografi nr. 10673.

¹⁷ el-Buhari, Kitab el-Ilm, hadithi nr. 113, f.36.

¹⁸ el-A`dhami, Dirasatun Fi Hadithin Nebevi, fq. 96-99.

¹⁹ Shiko: Ibni Haxher, Tehdhib Et-tehdhib, vëll. I, f. 372, biografi nr. 758.

²⁰ Edh-dhehebi, Sijeru A`lamin Nubelaë, vëll. III, f. 195.

²¹ el-A`dhami, Dirasatun Fi Hadithin Nebevi, f. 104.

²² Xhabir b. Abdullahu ka thënë: "Kam luftuar bashkë me të Dërguarin e Allahut *sal-lall-llahu alejhi ves-selm* në 19 luftëra, mirëpo nuk kam marrë pjesë në luftën e Bedrit dhe të Uhudit, sepse nuk më ka lejuar babai im. Më pas, pasi që u vra Abdullahu (prindi i Xhabirit), në asnjë luftë, për asnjë çast, nuk kam munguar pas të Dërguarit të Allahut *sal-lall-llahu alejhi ves-selm*". (Sahih Muslim, vëll. III, f. 1484, hadithi nr. 1813).

²³ Shiko: Edh-dhehebi, Sijeru A`lamin Nubelaë, vëll. III, fq. 189-194. Ibni Haxher, El-Isabe, vëll. I, fq. 434-435, biografi nr. 1027. Ibni Haxher, Tehdhibut Tehdhib, vëll. II, f. 37, biografi nr. 67.

²⁴ el-A`dhami, Dirasatun Fi Hadithin Nebevi, fq. 104-106.

²⁵ Shiko: Edh-dhehebi, Sijeru A`lamin Nubela, vëll. I, f. 461. Ibni Haxher, Tehdhibut Tehdhib, vëll. VI, fq. 24-25, biograf. nr. 43.

²⁶ Buhari, Kitab Menakib el-Ensar, Bab Menakib Ubej b. Ka`b r.a. hadithi nr. 3808 fq. 748-749.

²⁷ Edh-dhehebi, Sijeru A`lamin Nubela, vëll. I, f. 486.

²⁸ Muhamed Ebu Zehv, el-Hadithu Vel Muhaddithune, fq. 146-147.

²⁹ el-A`dhami, Dirasatun Fi Hadithin Nebevi, fq. 146-147.

ⁱ El A`dhami, Dirasatun Fi Hadithin-neevij, fq. 116-117.

ⁱⁱ Shiko: Ibnul Kajserani, Tedhkiretul Huffadh, vëll. I, fq. 37-40, biografi nr. 17. Edh-dhehebi, Sijeru A`lamin Nubelaë, vëll. III, f. 203. Ibni Haxher, El-Isabe, vëll. IV, fq. 181-188, biografi nr. 4837.

ⁱⁱⁱ el-A`dhami, Dirasatun Fi Hadithin Nebevi, f. 120.

^{iv} Nafiu ka thënë: "Me rastin kur Ibni Omeri donte të dilte në treg, shikonte, përkatësisht lexonte, në librat e vet". (Buhari, Et-tarihul Kebir, vëll. I, f. 325). v el-A`dhami, Dirasatun Fi Hadithin Nebevi, f. 120. v Po aty.

A jetojmë për ISLAMIN?

“Sytë e mi janë të ndjeshëm, kurse këmbët i kam të lehta, por unë do të jemë pranë teje o i Dërguari i Allahut!”

IDRIS TEWFIK*

A thua vallë jemi këmbëngulës në mbrotjen e emrit dhe mesazhit të të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.? Po, shumë lehtë e kemi që me zë të lartë të themi se jemi të gatshëm të vdesim për të Dërguarin, por vallë a thua jemi të gatshëm të jetojmë për të? Thirja me zë të lartë se e duam të Dërguarin nuk mjafton. A thua vallë e ndjekim Sunetin e tij me një dashuri të zjarrtë? A thua vallë ia kushtojmë të gjithë jetën mesazhit të islam?

Çfarë tregimi i mrekullueshëm!

Ishte një djalosh dhjetëvjeçarë që ndër parët e pranoi Islamit, ndërsa pas kësaj u bë njëri nga liderët dhe mbrojtësit më të mëdhenjë të Islamit. Ky është njëri nga katër kalifët e drejtë, emri i tij është Ali ibn Ebi Talib, ishte kushëri i të Dërguarit s.a.v.s. dhe dhëndër i tij, u martua me Fatimenë r.a.

Imam Aliu r.a. luftonte për Islamit, ishte këshilltarë i urtë dhe ithtarë besnik në vitet e hershme kur filloi mesazhi islam në Siujdhesën Arabike. Gjithashtu është me rëndësi të përmendim se në jetën e tij të hershme ka qenë anëtarë i shtëpisë së Pejgamberit s.a.v.s. Në një rast u shtri në krevatin e të Dërguarit për të dhënë jetën për të.

Aliu r.a. është lindur në vitin 599. Babai i tij ishte xhaxhai i të Dërguarit s.a.v.s. dhe anëtarë i fisit të njohur Kurejsh. Babai i të Dërguarit vdiq para se të lind

Muhammedi s.a.v.s., ndërsa më vonë i vdiq edhe e ëma, kurse edhe gjyshi deri sa akoam ishte fëmijë, kështu që kujdesin për të Dërguarin e mori xhaxhai i tij Ebu Talibi. Kur Muhammedi s.a.v.s. arriti moshën 25 vjeçare u martua me Hatixhenë r.a., ndërsa pesë vjet më vonë lindi djali i xhaxhait të tij Aliu r.a. Muhammedi s.a.v.s. u bë kujdestari i tij dhe do të ketë një ndikim të madh në jetën e tij më vonë.

Do të mund të shkruanim gjerësisht mbi jetën e Aliut r.a., për pranimin e Islamit nga ana e tij, pastaj për rolin e tij të madh që kishte deri në forcimin e Islamit. Do të shkruanim edhe për rolin e tij që e kishte pas vdekjes së të Dërguarit s.a.v.s., duke i ndihmuar me besnikëri kalifit të parë Ebu Bekrit r.a. dhe pasardhësve të tij para se ai tvetë ë marrë postin e kalifit. Mund të shkruajmë edhe për rolin e tij si kalif dhe mënyrën se si i mbajti të bashkuar muslimanët deri sa e vranë në moshën 62 vjeçare.

Mirëpo, për ne, në këtë rast, më e rëndësishme është udhëtimi i Imam Aliut r.a. në Islam dhe mënyra e marrjes mësim nga ky udhëtim, që të na ndihmojë të jemi muslimanë sa më të devotshëm dhe aktiv.

Gjëja e parë ku duhet ndalemi është fakti që Aliu deri sa ishte djalosh, për të kujdesej vetë i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe natyrisht u edukua në shtëpinë e tij. Kjo ia lehtësoi harxhimet Ebu Talibit i cili kishte një familje të


madhe. Por kjo kishte edhe ndikim tjetër. Pra djaloshi u edukua në një atmosferë lutjeje dhe absolutisht të pastër nga gjithçka. Edhe pse asokohe akoma nuk kishte filluar Shpallja (Vahji), Muhamedi s.a.v.s. ishte njeri i pastër dhe religjioz dhe në mesin e banorëve të Mekës ishte i njohur si *emin (besniku)*, ai e kishte shprehur të lutet dhe agjëroj. Djaloshi mësoi mirësinë nga kushëriri i tij, kurse mësoi edhe besimin me fjalët e tij.

Kur Aliu r.a. i mbushi 10 vjet, Muhamedit s.a.v.s. iu shpallën ajetet e para. Duke e parë të Dërguarin e Allahut dhe Hatixhenë r.a. duke u falur, djaloshi i habitur pyeti se çfarë janë duke vepruar.

“E madhërojmë Allahun, Zotin e Vetëm” - iu tha, kurse Muhammedi s.a.v.s. në mënyrë shumë të thjeshtë ia sqaroi Islamit. Me një urtësi që rallë e gjejmë në një moshë të tillë Aliu r.a. u përgjigj se duhet të mendoj për atë që kishte parë dhe dëgjuar. Mëngjesin tjetër erdhi me një vendim të pa luhatur dhe pranoi Islamit.

“Sytë e mi janë të ndjeshëm, kurse këmbët i kam të lehta, por unë do të jemë pranë teje o i Dërguari i Allahut!”

Pra, djaloshi jo vetëm që u rrit në shtëpinë e të Dërguarit s.a.v.s. por edhe personalisht mori vendimin për pranimin e Islamit. Nuk e bëri këtë menjëherë kur iu prezantua, ashtu siç do ta bënë këto shumica e fëmijëve të moshës së tij, por e pranoi Islamit me zemrën dhe



mendjen e vet. A thua vallë neve na duhet një shembull i një djaloshi dhjetëvjeçarë, që të na mësoj ta bëjmë islamit përditshëm tonën dhe të shqiptojmë shehadetin me zemrën dhe mendjen tonë, e jo vetëm me gojën tonë?

Pasi që e pranoi Islamit, Aliu u bë i guximshëm dhe luftëtarë i madh në mbrotjen e tij. Në një rast rrezikoi vetë jetën duke u shtrirë në shtratit e të Dërguarit s.a.v.s. për ta penguar kurthin e mekasve që donin ta vrisnin Muhammedin s.a.v.s., tërë këtë me qëllim që i Dërguari të

mund të dal i sigurt në rrugë për në Medinë. Aliu r.a. ishte njëri ndër luftëtarët më aktiv në luftën e Bedrit, kurse mori pjesë gati në të gjitha luftërat e të Dërguarit s.a.v.s. i Dërguari s.a.v.s. në mënyrë publike lavdëroi Aliun dhe ia dha dorën e vajzës së tij të shtrenjtë Fatimesë r.a.

A thua vallë jemi këmbëngulës në mbrotjen e emrit dhe mesazhit të të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.? Po, shumë lehtë e kemi që me zë të lartë të themi se jemi të gatshëm të vdesim për të Dërguarin, por vallë

a thua jemi të gatshëm të jetojmë për të? Thirja me zë të lartë se e duam të Dërguarin nuk mjafton. A thua vallë e ndjekim Sunetin e tij me një dashuri të zjarrtë? A thua vallë ia kushtojmë të gjithë jetën mesazhit të Islamit?

Pas pranimit të Islamit udhëtimi i Aliut të vogël si musliman sapo kishte filluar. Ai, çdo ditë, gjatë gjithë jetës së tij do të mësojë se çka do të thotë Islami. Shumë lehtë e kemi ne të shqiptojmë me gojën plotë *se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Tij*, por ta jetojmë këtë deklaram është diçka krejt tjetër... Gjithë jetën e tij Aliu r.a. u rrit si musliman, u bë rob i Allahut, jo vetëm me fjalë, por edhe në mënyrën se si kaloi jetën e tij.

Edhe ne, gjithashtu, duhet të jetojmë si musliman çdo ditë, pa marrë parasysh se a kemi lindur si musliman apo më vonë jemi bërë, duhet që çdo ditë të luftojmë dhe të jetojmë si muslimanë. Secili me zë të lartë mund ta thotë Shehadetin (Dëshminë), të gjykoj sulmet ndaj Islamit, të argumentoj qëndrimet e gabuara të njerëzve apo t'iu flas të tjerëve se si duhen të sillen.

Pra, ne duhet të përpiqemi maksimalisht që të jetojmë si muslimanë të vërtetë, të angazhuar në adhurim dhe mirësi ndaj besimtarëve dhe shumë të kujdesshëm në fjalë dhe prioritet apo detyrë jetësore ta kemi vetë shembëlltyrën e të Dërguarit të Allahut, Muhammedit s.a.v.s., kurse shembullin e një djaloshi dhjetëvjeçar siç ishte Imam Ali ibn Talibi r.a. ta marim si mësim dhe të na ndihmoj, nëse do Allahu për t'iu bërë rob të devotshëm të Tij.


*** Idris Tewfik është shkrimtar britanez i cili para disa viteve pranoi Islamit. Para kësaj ka qenë zyrtarë i arsimit religjioz në shkollë të ndryshme në Britani të Madhe dhe klerik romano-katolik. Aktualisht jeton në Egjipt.**

Burimi: readingislam.com / islambosna.ba

Shqiptarë: Arsim Dauti

Shqiptarët, në valët e krizës morale

Tradita dhe zakoni i ri, jeta allafranga shpesh na bën të shohim veten gojëhapur nga një ngjarje e re që s'e kishim pasur zakon ta pësonim: një vajzë vrau vete me motiv dashurie; një djalë gjendet i pajetë në rrugë nga doza e madhe e drogës; dhëndrit i ik nusja nga banketi dhe i kthehet dashnorit; një grua i lë fëmijët dhe ik te miku i burrit; shefi bën dashuri me sekretaren; nxënësja në dashuri me profesorin; dy të rinj dhunojnë shoqen... Frazja vulgare që të trondisin!



AHMED M. MEHMEDI

Shoqëria shqiptare ka kohë që është përballur me një valë të furishme të krizës morale. Kjo fillimisht ka nisur me ndryshimin e vlerave morale dhe zëvendësimin e tyre me „vlera“ të reja, të cilat shoqëria shqiptare i përfitonte nga kontaktet me popujt e Evropës Perëndimore gjatë kohës së Krizës Lindore dhe më pas, kohë kjo kur bëheshin përpjekje të vazhdueshme të forcave perëndimore për heqjen e shtetit islamik nga skena politike, ekonomike dhe ushtarake ndërkombëtare dhe futjen e shoqërisë islame nën pushtetin e shoqërive dhe shteteve perëndimore. Ndryshimet e reja politike, ekonomike dhe ushtarake me vete tërhoqën edhe ndryshimet kulturore.

Kultura evropiane e asaj kohe ishte një përzierje zakonesh, traditash, shprehish, stilesh, idesh, përshtypjesh e sjelljesh, që kishin lindur nga përplasjet mes dogmës morale krishtere të ndjekura nga kisha dhe ideve filozofike që i paraqisnin në shoqëri drejtime dhe mësim filozofike të cilat filluan të paraqiteshin nga koha e humanizmit dhe renesansës evropiane, të frymëzuara nga filozofia greko-helene, e cila në planin moral, ashtu si edhe në atë ontologjik e antropologjik, nuk kishte për bazë tjerët veçse përshtypje, pikëpamje dhe përvoja individuale të formuara nga zhvillimet e një shoqërie

politeiste me zhvillim primitiv ideor, ku njerëzit njiheshin për zota!

Me ndryshimet ideore dhe kulturore që solli humanizmi dhe renesansa, në Evropë u shkatërruan edhe ato vlera që kishte arritur t'i mbillte krishterimi si fe e lindur nga mësimi i drejtë i Zotit të shpallur në Inxhil (Ungjill) dhe, kështu, humanizmi e bën njeriun sërish zot si dikur në antikë, pas përpjekjeve shekullore të krishterimit për ta ruajtur atë njeri, edhe pse vetë krishterizmi e ka pasur rëndë këtë, pasi vetë ai e njeht njeriun për zot dhe këtë dyzim e bëri mësim themelor të vet duke ngritur kështu teorinë e trinitetit.

Me triumfin e ushtrive perëndimore në arenën ndërkombëtare, shoqëria evropiane me një kulturë krishtero-antike ngrihet në shoqëri prodhuese vlerash të cilat përmes sundimit do të barten edhe te kombet e mundura në luftë.

„En-Nasu ala dini mulukihim“, thotë një thënie arabe: Njerëzit janë në fenë e mbretërve të tyre. Kështu, të ngelur të mundur, popujt islamë (njerëzit), ndër ta edhe shqiptarët, filluan të përvetësonin „fenë“ (kulturën) e mbretërve të tyre të rinj.

Lufta për rrëzimin e kalifatit përmes përpjekjes për pavarësim nga pushteti i tij, pastaj shekullarizimi i shtetit të ri, ndërrimi i alfabetit, përvetësimi i kulturës, stileve dhe sjelljeve evropiane, ndryshimi i modelit të familjes dhe format e reja të jetesës, të gjitha këto paraqesin

nismën e zhytjes shqiptare në valët e krizës morale me të cilën përballlet sot.

Kultura evropiane nuk e përfshiu popullin shqiptar të tërin njëkohësisht. Atë më herët e përvetësoi pjesa e popullit që mbetën brenda kufijve të shtetit të pavarur shqiptar të 1912-tës, i cili u ngrit sipas modelit perëndimor. Pastaj e gjejmë atë në Kosovë, Mal të Zi, vise tjera shqiptare dhe, më në fund, edhe në Maqedoni.

Sot të gjithë shqiptarët - flasim për muslimanët si pjesë dërrmuese e kombit, kanë përvetësuar aq tepër kulturën evropiane, sa që është rëndë të flasësh për përkatësinë e tyre ndaj kulturës së tyre origjinë, kulturës islame.

Kodi moral „çdo gjë islame është morale dhe çdo gjë joislame është amorale“ tashmë është hequr nga bindjet e shumicës muslimane dhe në vend të kodit moral islam, ata kanë përvetësuar, si të thuash, një kod moral të sajuar nga vetë njeriu përmes motiveve individuale, dëshirave, kënaqësive, lakmive e synimeve si elemente që përbëjnë tërësinë e epshit të njeriut.

Kjo nuk është një rastësi. Ngritja e njeriut në pozitën e krijimit të vlerave vjen si zhvillim normal i një procesi të gjatë që ka filluar, ashtu siç është bërë zakon të quhet, që me kthimin e njeriut në qendër të vëmendjes në kohën e paraqitjes së humanizmit dhe të renesansës në Evropë, që s'ishte tjetër vetëm se

përpjekje për çlirim nga prangat kishtare dhe kthim në antikë, e cila njihet për nga liria e shturur njerëzore dhe mospranimi i asnjë autoriteti mbinjerëzor, siç ndodh në shoqëritë të cilat në krye të tyre kanë Zotin.

Vlerat e larta islame: besimi i paluhatshëm në Allahun si qenie absolute - Zot i çdo gjëje dhe sundimtar i pakontestueshëm i çdo gjëje në hapësirë, shenjtëria e të cilit meriton dashurinë më të madhe, respektin, droen, adhurimin e vazhdueshëm dhe kujtimin e pandërprerë, sakrificën e më të çmuarës, përuhlen dhe gjunjzimin e plotë; dashuria e Muhamedit a.s., vulës së të dërguarve dhe më të zgjedhurit të tyre, ndjekja e mësimin, modelit dhe shembullit që ai paraqiti gjatë jetës, imitimi i stilit të tij, kujtimi i pandarë për të, flijimi, lufta për të, ëndrra e takimit me të, ngjallja e Sunnetit të tij, dëshira e flaktë e takimit me të; dashuria ndaj familjes dhe shokëve të tij, ndjekja e shembullit të tyre në shkriren për Allahun dhe Muhamedin a.s.; vlerat e larta njerëzore: dashuria ndaj njeriut, respekti, nderimi, drejtësia, fisnikëria, besnikëria, bujaria, toleranca, butësia, modestia, mirëkuptimi, faqebardhësia, turpi dhe nderi, të gjitha këto janë bërë histori e harruar për shqiptarin sot.

Njeriu ynë sot e fyen Zotin, e përbuz fjalën dhe porosinë e tij, nëpërkëmb mësimin e tij, nënçmon ligjin e tij, shan dhe tall të dërguarit e tij. Gjithçka të Zotit e vë në lojë, në skenë, e vë në satirë. Shqiptarët sot mbyten në valët e krizës morale, marrin frymat e fundit zhytur në detin e nxirë të jovlerave: urrejtjes ndaj çdo gjëje pos vetes, mospërfilljes, përbuzjes, mendjemadhësisë, mosrespektit, gënjeshtërisë, mashtrimit, zilisë, tradhtisë, shturjes, kurvërisë, bixhozit, alkoolizmit, narkomanisë e vetëvrasjes. Të gjitha këto ndodhin para syve dhe veshëve tanë, aty mu para këmbëve tona. Çdo ditë dhe në çdo vend dhe - të gjithë heshtin!

Intelektualët tanë si të dehur nga valët zbatimëse të zërit melankolik të thëllënzave të reja pa pendla dhe

muzikës joshëse që përhaset me lëkundjet e trupave të tyre të rinj, i buzëqeshin jetës së re. Duartokasin për spektaklin e ri. Të bëjnë të mendosh sikur festojnë ditën e re, ditën e ëndërruar nga mësuesit tyre tanimë të vdekur, të cilët me aq pasion u kishin folur për këtë ditë: ditën e lirisë!

Hoxhollarët, si të lodhur nga përsëritja e shpeshtë e rrahjes së kësaj çështjeje, të duken si të plogësht e të bezdisur e disa, madje, edhe vetë futen në ndryshimin e ri.

Prindërit, të ngarkuar nga kërkesat e jetës, të vënë në vrap pas ëndrrave të largta të tyre, fëmijët ia kanë besuar shoqërisë dhe rrugëve të saj: kushdo, kudo, sido le ta gjejë veten!

Në këso rrethanash, në nismën tonë të përvetësimit të kulturës evropereëndimore, filluam gëlltitjet e para të fryteve të saj të hidhura. Tradita dhe zakoni i ri, jeta al-lafranga shpesh na bën të shohim veten gojëhapur nga një ngjarje e re që s'e kishim pasur zakon ta pësonim: një vajzë vrau vete me motiv dashurie; një djalë gjendet i pajetë në rrugë nga doza e madhe e drogës; dhëndrit i ik nusja nga banketi dhe i kthehet dashnorit; një grua i lë fëmijët dhe ik te miku i burrit; shefi bën dashuri me sekretaren; nxënësja në dashuri me profesorin; dy të rinj dhunojnë shoqen... Frazë vulgare që të trondisin!

Ditëve tona këto ngjarje janë të sh-

peshta. Ato të shqetësojnë. Të helmojnë zemrën. Të thyejnë shpirtin. Të bëjnë të zhgënjehesh nga shoqëria dhe të bëhet sikur ajo të bën dhunë psikike me çrregullimin e vet. Të bën të ndihesh i huaj ndaj saj. Të dyshosh në çdokënd. Dhe, kështu ndoshta na vjen edhe sëmundja e tëhuajësimit evropian që dikur vetëm e lexonim te Alber Kami!


Cila është zgjidhja? Zgjidhja është vetëm një: rilindja islame. Rilindja islame është alternativa e vetme e daljes nga kriza morale në të cilën është duke u zhytur njeriu shqiptar sot. Ajo nënkupton mobilizim të gjerë popullor për kthim në sistemin islam të jetesës, që fillimisht do të fillonte me ndërtimn e një gjenerate te re mendimtarësh, të cilët do ta paraqisnin dhe prezantonin idenë e Rilindjes në të gjitha nivelet e popullit derisa të arrihej pjekuria popullore për përvetësimin e saj, që nënkupton vetëdije islame e cila do ta shtyjë popullin në kërkesa të vazhdueshme për ndryshime rrënjësore në zhvillimin kombëtar.

Pa një rilindje të këtillë, përpjekjet dhe orvatjet për zhvillim islam të shoqërisë, si alternativë e shpëtimit nga kriza shoqërore, do të kenë ndikim anësor, joserioz dhe shpesh mund të jenë në shërbim të zhvillimeve ditore, pa arritur të shprehin idenë për ndryshimin e tyre.



E kush mund të jetë më mizor se shkatërruesit e tyre...

“Xhami ndërtojnë dhe ngrenë vetëm ata që i besojnë Allahut, ditës së gjykimit, që falin namazin dhe që japin zeqatin e që nuk i frikësohen askujt pos Allahut; të tillët do të jenë të udhëzuar (në rrugë të drejtë)” (Teube:18)



ZELIJE ZIBERI

Siç shohim nga ajeti në fjalë, Allahu f.p. lavdëron ata besimtarë që brengosen dhe punojnë për xhami, që ndërtojnë dhe ngrenë xhami, që i rindërtojnë dhe i gjallërojnë xhamitë, që kujdesen dhe i mirëmbajnë xhamitë.

Islami nuk është fe personalitetesh, por e të gjithë besimtarëve që jetojnë në një shoqëri, ndërsa për të qenë kjo shoqëri e fuqishme, domosdo që ata të lidhen fort për njëri-tjetrin. Lidhje të cilën e potencon edhe Kur’ani famëlartë: “Besimtarët janë vëllezër...” (Huxhurat:10)

Njëra ndër gjërat elementare që mban gjallë lidhjet vëllazërore dhe që rregullon jetën shoqërore të besimtarëve në Islam pa dyshim se është edhe Xhamia. Dhe, jo rastësisht Allahu f.p. i lavdëroi ata besimtarë që kujdesen për xhamitë në të gjitha aspektet.

Mësuesi i njerëzisë për këtë kategori besimtarësh tha: “Kush ndërton xhami në emër të Allahut, atij Allahu f.p. do t’ia ndërtojë një xhami të njëjtë në xhenet.”

Besimtari asnjëherë nuk mund të jetojë në një shoqëri ku nuk ekziston xhamia, sepse zemra e tij është e lidhur për xhaminë. Pikërisht për këtë, edhe në xhenet, përpos shumë të mirave të tjera që do t’i gëzojë, do ta ketë edhe atë kënaqësi që të ketë afër edhe xhaminë, të cilën do t’ia ndërtojë krijuesi Absolut, Allahu f.p.

KUPTIMET E FJALËS XHAMI

Në Kur’anin famëlartë në lidhje me xhamitë hasen këto dy shprehje: **Mesxhid**, që është marrë nga



shprehja sexhde, që në gjuhën shqipe do të thotë të përkulesh, të bësh sexhde, ndërsa mesxhid nënkupton vendin në të cilin bëhet sexhdeja. Fjala *mesxhid* në Kur’an përmendet 22 herë. Është thënë se shprehja mesxhid ka kuptimin e faltores pa minare dhe në të falen vetëm pesë namazet ditore e jo edhe namazi i xhumasë dhe i Bajrameve.

Bejtullah, që do të thotë shtëpi e Allahut f.p., është quajtur kështu për t’ia treguar famën dhe respektin që ka xhamia.

Fjala *xhami* në literaturën islame haset prej kohës së Omerit r.a., i cili kishte urdhëruar që përpos mesxhideve të shumta që ndodheshin, të ndërtohet edhe një xhami qendrore, ku do të falej namazi i xhumasë.

Fjala *xhami* është shprehje e gjuhës arabe dhe në gjuhën shqipe do të thotë *vend tubim*. Është marrë nga shprehja *xhemea*, që do të thotë tubim. Në jurisprudencën islame me fjalën xhami nënkuptojmë vendin ku falen të gjitha llojet e namazeve, duke përfshirë namazet ditore, namazin e xhumasë, namazet e Bajrameve dhe vendi ku edukohet dhe mësohet populli.

XHAMIA, VEND BASHKIMI

Xhamitë janë vendet më të dashura të Allahut f.p. Ato janë kopshte të Xhenetit. Ato janë vende që përforcojnë besimin e besimtarëve, që e shtojnë dashurinë mes tyre dhe, në të njëjtën kohë, janë vende që nuk njohin grada, benificione dhe pozicione të atyre që radhiten në radhët e saj.

Ata që zbukurojnë xhamitë më së

miri janë vetë pjesëmarrësit dhe falësit e namazeve nëpër xhami, sepse mësuesi i njerëzisë na mësoi se namazi i falur në xhami, bashkë me besimtarët, është për 27 shkallë më i vlefshëm se namazi që falet në shtëpi.

Ubejdullah ibni Umer një natë pati një mysafir në shtëpinë e tij dhe i erdhi vështirë që ta linte vetëm në shtëpi e vetë të dilte për të falur namazin e jacisë në xhami. Pas një kohe mysafiri i shkoi, ndërsa ky menjëherë doli të kërkonte ndonjë xhami ku do të mund të gjente ndonjë xhematë i cili ende nuk e kishte falur namazin e jacisë, në mënyrë që ta falnin bashkë.

Tregon Ubejdullahu dhe thotë: E kërkoja thujse tërë qytetin e Basrës, por nuk gjeta dot xhematë dhe më në fund u ktheva në shtëpi, bëra analogji me hadithin e Pejgamberit a.s. dhe e fala namazin e jacisë 27 herë, dhe rashë në gjumë. Atë natë pushë në ëndërr sikur garoja me kuaj me disa shokë dhe assesi t'i arrija shokët që i kisha para meje, ndërsa një shok imi ktheu kokën e më tha: 'O Ubejdullah, mos u mundo, se kot e ke; nuk mund të na arrish, sepse ne e falëm jacinë në xhami me xhematë, ndërsa ti e fale vetë, në shtëpi!'

XHAMIA, ÇERDHE ARSIMIMI PËR TËRË BOTËN

Xhamia paraqet institucionin më të vjetër arsimor në botë. Në të Mësuesi i njerëzisë mësoi gjenerata të cilat katërmbëdhjetë shekuj radhazi ishin prijësit e botës.

Në xhami ligjëroheshin të gjitha shkencat fetare dhe ato profane, aty bëheshin dhe mësoheshin planet dhe strategjitë e ndryshme për fitoret e mëdha të besimtarëve. Xhamia në fillim të paraqitjes së Islamit luajti rol jashtëzakonisht të madh. Ajo luajti rolin e një universiteti të pakonkurrencë në historinë e arsimit dhe jo rastësisht fjala universitet në gjuhën arabe është nxjerrë nga fjala xhami, ndërsa universitetet më të mëdha në botën islame në fillim ishin xhami, ndërsa me kalimin e kohës ato u

shndërruan në universitete më të mëdha botërore, siç janë p.sh. Xhamiu Ezher - Universiteti i Ezhherit, i cili në arkivin e vet ruan mbi nëntë milion tituj shkencorë dhe numëron mbi nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë studentë; Xhamiu Zejtun - Universiteti i Zejtunit e shumë të tjerë.

Po këtë rol xhamia e luajti edhe pas periudhës së Hulefai Rrashidive, në kohën e themeluesve të medhhebeve, ku shkollat fillestare të quajtura mejtepe ishin prezente gati në çdo xhami apo mesxhid. Këtu fëmijët mësonin të shkruajnë dhe të lexojnë, ndërsa mësuesi i parë quhej Mukatib. Pas këtij mësimi, fëmija dërgohej në xhami, në mësim të mesëm dhe të lartë, ku mësuesi mbante ligjëratat publike.

Ligjëruesi ulej në një kënd të xhamisë e rreth tij tuboheshin nxënësit, të cilët me vëmendje e dëgjonin mësuesin e tyre, shënonin dhe mbanin në mend. Kjo ishte aq më mirë, sepse diskutohej dhe bëheshin pyetje apo i mbronin pikëpamjet e medhhebeve të tyre. Disa prej këtyre shkollave quheshin sipas dijetarit të xhamisë, si "rrethi i nxënësve të Ebu Is'hakut", "Shiraziut" në xhaminë e El-Mensurit në Bagdad, kurse autoriteti i shkollës varej nga shkalla e dijetarit dhe numri i nxënësve.

Po këtë rol xhamia e luan edhe në vendin tonë edhe sot e kësaj dite, sepse në të sot mësohet pedagogjia parashkolllore, shkolllore dhe ajo andragogjike. Aty mësohen si fillestarët, të rinjtë, ashtu edhe të moshuarit; në të brenda një viti, vetëm gjatë ligjëratave të xhumave dhe teravive, ligjërohen më së paku tetëdhjetë orë mësim, duke mos përfshirë manifestimet dhe organizimet e ndryshme të interpretuesve fetarë brenda vitit.

XHAMITË GJATË HISTORISË

Xhamia e parë e ngritur në rruzullin tokësor është Qabeja në Mekë. "Shtëpia (xhamia) e parë e

ndërtuar për njerëz, është ajo që u ngrit në Bekë (Mekë), e dobishme e udhërrëfyese për mbarë njerëzimin" (Ali Imran:96)

Fjala Ka'be (Qabe) në gjuhën shqipe do të thotë kub, sepse është ndërtuar në formë të kubit. Atë e ndërtoi Ademi a.s. me ndihmën e disa melaqeve. Edhe pse ekzistojnë mendime nga historianët se është ngritur edhe para Ademit nga ana e disa melaqeve ose pas tij, nga ana e Ibrahimit a.s. Por, realiteti është se atë e ndërtoi Ademi a.s. edhe atë kur ai gaboi dhe hëngri nga pema që ia kishte ndaluar Allahu f.p. Ai u pendua për gabimin e bërë dhe pasi që u rrotullua shtatë herë rreth Arshit të Krijuesit Absolut, atëherë krijuesi Absolut i tha: 'Do të ta fal, por me kusht që të zbresësh në tokë dhe të ndërtosh një shtëpi, Qabenë, që edhe pasardhësit e Ademit kur të gabojnë, të kenë ku t'i drejtohen Allahut për falje'. Edhe gjeneza e rrotullimit, të tavafit, shtatë herë qëndron në rrotullimin e Ademit a.s. shtatë herë rreth Arshit të Allahut f.p. për t'i falur gabimin që bëri.

Një xhami tjetër, e cila është e lidhur ngushtë me Qabenë, është Bejtul Ma'muri, e cila u ndërtua në kohën e Nuhit a.s., ndërsa pas vërshimit të ujit në kohën e Nuhit a.s., Allahu f.p. atë e ngriti në qiellin e katërt dhe në mënyrë vertikale kjo xhami është në të njëjtën vijë me Qabenë. Pikërisht për këtë lidhje vertikale, sipas Kurtubiut, në vijën qiellore mbi Qabe asnjëherë nuk fluturojnë shpezët, përpos disa rasteve kur nga grumbulli i shpezëve që janë duke fluturuar në qiell të gjithë i ikin kësaj vije, përpos ndonjëres prej tyre dhe sipas hulumtimeve dhe analizave që janë bërë, është vërtetuar se ato shpezë më parë kanë qenë të sëmura dhe me fluturimin e tyre mbi Qabe janë shëruar.

Këtë xhami, sipas Imam Gazaliut, i cili e përmend në veprën 'Ihja...', vetëm brenda një dite e bëjnë tavaf shtatëdhjetë mijë melaqe dhe këtyre melaqeve, që veç më e kanë bërë tavafin, më nuk do t'u vijë radha për të bërë tavaf tjetër deri në ditën e gjykimit, për shkak të numrit të

madh të melaqeve që presin radhë për të bërë tavaf.

Një xhami tjetër, që është mjaft me rëndësi të përmendet, është edhe Mesxhidul Aksaja, zanafilla e së cilës ndërlihet me Davudin a.s.

Davudi a.s. ishte ai i cili filloi ndërtimin e saj, ndërsa atë e përfundoi Sulejmani a.s., që të dy pejgamberë të Allahut f.p.

Pejgamberi a.s. për vlerën e namazit në këtë xhami thotë se namazi i cili falet në këtë xhami, është i barabartë me faljen e pesëqind namazeve nëpër xhamitë tjera, përpos Qabesë dhe xhamisë së Pejgamberit a.s. në Medine.

Këtë xhami, atyre që u pengon të përmendurit e Allahut dhe arsimimi i muslimanëve, shpeshherë tentuan ta rrënonin. Hera e fundit ishte tentativa me mjete shpërthyes arkeologjike! Këtë e hetuan të mençurit dhe e ndaluan. Fatkeqësisht, këtë fat nuk e patën edhe xhamitë tona, të cilat me gjithë minaret e tyre u rrënuan me lëndë të ndryshme shpërthyes.

Armiqtë e Islamit dhe të muslimanëve pas shumë studimeve kishin parë se xhamia është burimi i të arriturave të muslimanëve dhe i rizgimit të vetëdijes islame, andaj me çdo kusht tentuan dhe tentojnë t'i fshijnë nga faja e dheut. Një konstatim i këfillë mund të konkludohet dhe të vërtetohet nga agresionet e fundit mbi muslimanët në këto troje. Vetëm gjatë agresionit serb mbi Bosnjë janë shkatërruar mbi 618 xhami, ndërsa në Maqedoni gjatë vitit 2001 u dëmtuan dhe u rrënuan mbi 57 xhami.

"E kush mund të jetë më mizor se ai që në xhamitë e Allahut pengon të përmendet emri i Tij (të bëhet ibadet) dhe përpiqet për shkatërrimin e tyre..." (Bekare:114)

Këta të gjerë harruan se nga xhamitë dhe minaret e tyre nuk vijnë porosi të tjera pos porosive të paqes, harmonisë dhe arsimimit. Ndërkaq, ata që shkatërruan dhe dëshirojnë t'i shkatërrojnë xhamitë, duhet ta kenë të qartë se janë duke shkatërruar çdo normë edukative-arsimore dhe njerëzore.

Muslimanët, gjithnjë me busull

Islami kërkon paqe dhe Kur'an i kërkon që çdo musliman i vërtetë të jetë një simbol i paqes dhe të punojë për të mbrojtur të drejtat themelore të njeriut. Nëse një barkë ka brenda nëntë kriminelë dhe një njeri të pafajshëm, Islami nuk lejon që barka të fundoset për të ndëshkuar nëntë kriminelët, duke dhunuar kështu të drejtat e një personi të pafajshëm. Islami i respekton të gjitha të drejtat individuale dhe deklaron qartë që asnjëri nuk mund të dhunohet, edhe nëse kjo është në interes të komunitetit



TAXHUDIN HAMIDI

Dinamika e të menduarit islam gjithnjë ka qenë e inklinuar rreth proklamimeve të hapta dhe thirrjeve me vokabularin preciz për bashkëjetesë, tolerancë, paqe dhe drejtësi. Mësimet e fesë islame nuk shohin një fushëveprim më të përshtatshëm përpos bastionit me aspirata për liri dhe përpjekje për çlirim kombëtar. Mjafton të përkujtojmë pohimin e atdhetarit të mirënjohur, hafëz Ali Korça. Ai nënvizon se nacionalistët persë, të angazhuar në rilindjen persiane, himnizuan traditat e lashta të popullit të tyre si reaktion ndaj sundimit të huaj, si mesazh për rivendosjen e pavarësisë së atdheut. 28

Kështu, ata e vunë atë në shërbim të zgjimit të popullit, për ta ngritur atë në luftë për vetëvendosje e shmangie të paternalizmit. Motive të këtij lloji gjenin - çka është e natyrshme - një jehonë të fuqishme në mjedisin shqiptar të kohës. Kur bëhet fjalë për lidhje kulturore shqiptare-orientale, nuk duhet të kemi parasysh vetëm lidhjet e thjeshta e suplente, por dhe marrëdhëniet e ndërsjella. Me korrespondencë reciproke. Kjo, për faktin që shqiptarët nuk qenë thjesht konsumatorë, admirues të kësaj kulture, të këtij sistemi dhe të arritjeve të tij. Shumë përfaqësues të intelegjencies shqiptare të kohës dhanë ndihmesën e tyre të ndjeshme në përhapjen e kësaj kulture. Në konstelacion me iniciativat pozitive, në drejtim të veprimtarisë së Muhamedit a.s. para shpalljes së Kur'anit. Muhamedi a.s. është thirrur në unionin për mbrojtjen e të dobët në luftë kundër agresionit.

Pas shpalljes së Kur'anit, Muhamedi a.s. vazhdoi punën e unionit për mbrojtjen e të dobëtve, mirëpo tash si obligim fetar. Në dispozitat e fesë islame qëndron një numër i madh i teksteve ligjore që përkohë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Feja islame citatet e përmendura në lidhje me të drejtat e njeriut nuk i përmend si këshilla etike, por pikërisht si përcaktime ligjore. Dhe, krahas tyre vendosi garanci të nevojshme për implementimin e tyre. Nëse i qasemi kom-

paracionit në lidhje me tekstet ligjore rreth të drejtave të njeriut dhe tekstit për të drejtat ndërkom-bëtare të njeriut, do të vërejmë se forma e imperativit nuk është e sh-pallur me përcaktimë ligjore. Mirëpo, këto tekste ndërkom-bëtare janë formuluar në nivel të rekomandimeve, të cilat nuk kanë garanci ligjore si në planin ndërkombëtar, ashtu edhe në atë kombëtar. Transparenca e Muhamedit a.s. vërehet shumë lehtë. Këtë ai e bëri ndaj të krishterëve të Etiopisë dhe ndaj pushtetarit të tyre. Ka qenë kjo që në fillim – që në mëngjesin e Is-lamit, në periudhën kur politeistët ashpërsuan aksionet ndaj musli-manëve të pambrojtur dhe të dobët. Pas krijimit të kësaj gjend-jeje, Muhamedi a.s. i dërgoi porosi pushtetarit të krishter për të kërkuar prej tij mbrojtjen e musli-manëve të dobët, të cilëve u urd-hëroi strehim, duke u thënë: “Në atë vend gjendet pushtetari i cili nuk lejon që mbi të dobëtit të ushtrohet dhunë.” Nëse do të ko-mentojmë këtë fenomen, edhe më tej nuk do të gjenim epilog.²⁹

Mirëpo, do të ishte mirë që këtë lëndë të rrumbullakoni në mënyrë inkluzive, me një parim inkognit, ku thuhet: Feja islame të tjerët asnjëhere nuk i analizojnë si një tërësi, qoftë si fe, si komb a si civilizim. Historia islame në mënyrë studiozoe bën distink-sionin mes çifutëve autoktonë dhe çifutëve të importuar nga Liqeni Kaspik në Palestinë dhe këta tani kontrollojnë politikën hegje-moniste në shtetin Izraelit ndaj palestinezëve autoktonë.

Muhamedi a.s. nuk nguroi fare të ilustronte rendin shoqëror në llogari të vajzës së tij. Muhamedi a.s. thotë: “Nëse vajza e Muhamedit, Fatimja, bën kundër-vajtje të shkallës kleptomane (të vidhte – shën. ynë), do t’ia prisja dorën.” Në sistemin shariatik ose në pushtetin islam masa e drejtë-sisë ndahej mbi këtë parim, duke besuar që i dobëti prej jush kon-siderohet më i forti, derisa t’i kthe-het e drejta e tij. Tani mund të

konkludojm se qendra e fuqisë së vetme në fenë islamë është drejtësia.³⁰

Në filozofinë e legjislacionit islam, fuqia e vetme që qëndron para tërë botës është drejtësia, prandaj dhe muslimanët gjithnjë kanë lundruar me busull. Nuk duhet t’i ngjajmë Kristofer Kolom-bos: ai kur u nis, nuk e dinte se ku shkonte; kur arriti, nuk e dinte se ku kishte qenë. Pra, Islami kërkon paqe dhe Kur’ani kërkon që çdo musliman i vërtetë të jetë një simbol i paqes dhe të punojë për të mbrojtur të drejtat themelore të njeriut. Nëse një barkë ka brenda nëntë kriminelë dhe një njeri të pafajshëm, Islami nuk lejon që barka të fundoset për të ndëshkuar nëntë kriminelët, duke dhunuar kështu të drejtat e një personi të pafajshëm. Islami i respekton të gjitha të drejtat indi-viduale dhe deklaron qartë që as-njëri nuk mund të dhunohet, edhe nëse kjo është në interes të komu-nitetit. Kur’ani deklaron që kush merr një jetë pa të drejtë, ka marrë, si rrjedhim, jetën e të gjithë njerëzimit. Gjithashtu, Muhamedi a.s. deklaron që një musliman është një njeri që nuk duhet të dëmtojë as me duar dhe as me gjuhë.³¹

Të përkujtojmë periudhën os-mane, plot 520 vjet. Gjatë kësaj periudhe kurrë nuk ka munguar toleranca dhe respekti ndaj objek-teve fetare. Osmanët, përveç asaj që e kanë sjellë civilizimin, në masë të madhe edhe e kanë ruajtur edhe atë që kanë gjetur në këto hapësira. Shembulli i Ohrit me ru-ajtjen e një numri aq të madh të kishave dhe ndërtimin e objekteve të reja fetare, është tipik se inter-aksioni mes kulturave dhe et-nikumeve të ndryshme gjithnjë ka qenë i paranishëm në këtë nën-qiell.

Por, për fat të keq, me tërheqjen e osmanëve në Anadoll, në vitin 1912, ka filluar rrënimi sistematik i gjithë asaj që ka qenë osmane, përkatësisht civilizimi islam. Prof. dr. Kosta Ballabnov, historian i

artit, për periudhën osmane nxjerr në shesh edhe faktet se në atë peri-udhë nuk është prekur asnjë kishë ortodokse apo krishtere nga ana e osmanlinjve, ndërsa rrëfimet e ndryshme për atë se civilizimi islam erdhi dhe rrënoi gjithçka që ishte ndërtuar, nuk janë të vërteta. Në kohën e Perandorisë Osmane kanë bashkëjetuar 120 popuj të ndryshëm. Të gjithë kanë jetuar në një harmoni dhe asnjëri nuk ka pasur ndonjë problem me ndonjë tjetër përta përkatësisë na-cionale apo fetare. Në atë kohë kanë qenë në shënjestër vetëm veprat jo të mira dhe jonjerëzore.

Roli i historianëve sot nuk është në dobi të njerëzimit. Historianët, fatkeqësisht nuk janë realë dhe nuk e thonë të vërtetën. Të gjithë mundohen që historinë ta adapto-jnë dhe ta përshtatin për interesat tyre kombëtare.³²

Kjo situatë indoktrinuese e his-torianëve nuk duhet të plogështojë vullnetin e historianëve të denjë e dinjitozë. Në asnjë mënyrë nuk duhet të gjunjëzohemi para shan-tazheve që dëshirojnë të na nxjer-rin nga realiteti historik.

Duhet të bazohemi në parimin: “Unë ruaj rregullin; rregulli më ruan mua.” Për në fund, me ke-qardhje potencojmë paaftësinë e BE-së për të menaxhuar politikat stabilizuese në Ballkan. Ish-për-faqësuesi i lartë për Bosnjë e Herce-govinën nga viti 2006 deri në vitin 2007, Kristian Shvarc Shiling, i cili ka adresuar kritika të ashpra në adresë të BE-së për shkak të për-jashtimit të Bosnjës e Hercegovinës dhe të Kosovës nga procesi i liber-alizimit të vizave, në një intervistë për gazetën gjermane “BILD” ka vlerësuar se “heqja e vizave për Serbinë, është turpi me i madh i BE-së deri më tani.”³³

Veprimi i BE, definitivisht, mo-tivon aktorët që kryen gjenocidin më të përgjakshëm pas Luftës së Dytë Botërore në Bosnjë e Herce-govinë dhe në Kosovë, vende ku koekzistenca është siguruar përmes sulmeve ushtarake të NATO-s.

(Vazhdon)

Xhamia dhe roli i saj në shoqërinë islame

Gjatë historisë xhamia shërbeu si objekt fetarë, qendër shkencore, por edhe si vend për zgjidhjen e problemeve shoqërore që ne sot e quajme parlament. Xhamia është institucion, dhe ajo duhet të kuptohet edhe si vend ku formohen personalitete të pastërta njerëzore, sepse ajo është shtyllë kryesore që e orienton njeriun kah përsosshmëria e shpirtit dhe personalitetit



NGA: MR. LUTFI NEXHIPI

Gjatë gjithë historisë së ekzistimit njeriu çdo herë ka pasur nevojë për fatore apo vend ku do t'i lutej Zotit. Në botë mund të gjenden vende apo qytete pa bedena, pa qytetërim, pa letërsi e teatër, mirëpo asnjëherë nuk është dukur ndonjë qytet pa tempuj fetarë e pa njerëz që në një farë forme i përuhlen Zotit. Ka pasur dhe edhe sot gjenden turma njerëzish pa shkencë, pa art e filozofi, por asnjëherë nuk ka pasur shoqëri pa fe.

Me shpalljen e Islamit si fe dhe sistem i jetës, u vunë edhe themelet e shoqërisë së shëndoshë. Që në fillim të theksojmë se akti i parë i Muhammedit a.s. pas shpërnguljes në Medine, ishte ndërtimi i një xhamie. Xhaminë e parë Muhammedi a.s. e ndërtoi në qytetin e quajtur Kuba afër Medinës, e më vonë edhe Medine. Me këtë akt u tregua se muslimanët patjetër duhet të posedojnë një vendtubim që do të shërbejë edhe për kryerjen e obligimeve fetare.

Gjatë historisë Islame, xhamia luajti rol mjaft të rëndësishëm. Besimtari musliman asnjëherë nuk ka mundur ta paramendojë ekzistencën e vet pa xhami. Xhamia ishte dhe do të jetë qendra shpirtërore e besimtarëve musliman. Ajo është qendër kryesore e Ummetit. Xhamia është nyja ku gërshetohen dy botërat: bota fizike dhe ajo shpirtërore. Në islam, xhamia nuk luan vetëm rolin shpirtëror, sikundër kisha në krishterizëm, por, roli i saj është me dimensione shumë më të gjera dhe të natyrave të ndryshme.

Xhamia është institucion, dhe ajo duhet të kuptohet edhe si vend ku formohen personalitete të pastërta njerëzore, sepse ajo është shtyllë kryesore që e orienton njeriun kah përsosshmëria e shpirtit dhe personalitetit. Në të, ka vend si për të varfërin ashtu edhe për të pasurin, të gjithë njerëzit, aty janë të barabartë të gjitha kategoritë dhe nivelet, përparësia është vetëm për nga devotshmëria.

Njerëzit çdo herë kanë anuar kah ajo që të afrohen pranë njëri-tjetrit, të shkëmbejnë mendime dhe të bisedojnë rreth çështjeve të ndryshme. Në të kaluarën e gjithë kjo bëhej në xhami. Me një fjalë xhamia i tubon njerëzit, i bashkon dhe i edukon. Aty mund të hyjnë njerëz të të gjitha etniteteve, ngjyrave dhe racave. Ajo i bashkon të gjithë popujt. Xhamia nuk bën përjashtim dhe diskriminim të njerëzve, sepse një gjë të tillë rreptësisht e ndalon Islami.

ROLI I XHAMISË PËRGJAT HISTORISË

Gjatë kohës së Muhammedit a.s. xhamia luajti një rol të rëndësishëm. Siç theksuam edhe më lartë, vepra e parë e Muhammedit a.s. pas hixhretit ishte ndërtimi i një objekti ku do t'i tubojë besimtarët për punët e tyre që kanë të bëjnë me bashkësinë, si dhe për kryerjen e obligimeve të tjera fetare. Si xhami e parë në sipërfaqen e tokës është ajo në Mekë, e quajtur el-Mesxhidul haram për të cilën flet edhe Libri i Allahut -Kur'ani:

"Shtëpia (xhamia) e parë e ndër-

tuar për njerëz është ajo që u ngrit në Bekë (Mekë), e dobishme dhe udhërrëfyese për mbarë njerëzimin". (Ali Imran, 96)

Këtu vlen të theksojmë edhe xhaminë e njohur në Jerusalem e quajtur Mesxhidu Aksa apo Bejtul Makdis, e njohur në historinë islame si vend prej ku Muhammedi a.s. shkoi në Mi'raxh. Pasi që për besimtarët muslimanë falja e pesë kohëve të namazit u bë obligim i domosdoshëm, i njëjti në fillim kryhej duke u drejtuar kah Mesxhidu Aksaja sepse ajo ishte drejtimi apo Kibleja kah e cila duhej të drejtoheshin muslimanët, por, pas gjashtëmbëdhjetë muajve apo me saktësisht në muajin Sha'ban të vitit II të hixhretit, Allahu i Madhëruar shpalli ajetin: *"Ne shumë herë po shohim kthimin e fytyrës tënde kah qielli, e Ne gjithqysh do të drejtojmë ty në drejtim të një kibleje (Qabja) që ti e do atë. Pra kthehu anës së xhamisë së shenjtë (Qabes) dhe kudo që të jeni (o besimtarë) kthehuni ka ajo anë.....* (El-Bekare 144). Me këtë ajet kur'anor Allahu obligon Muhammedin a.s., por edhe gjithë besimtarët tjerë që gjatë faljes së namazit të kthehen kah Mesxhidul harami - Mekka. Kështu vazhdon sot e kësaj dite ku muslimanët gjatë faljes së namazit kthehen kah Qabeja e cila gjendet në Mekë.

Roli i xhamisë është shumëdimensional. Këtë e vërteton edhe fakti se menjëherë pas ngritjes së xhamisë në Medine, Muhammedi a.s. së bashku me besimtarët tjerë përgatiti edhe një kushtetutë e cila nuk u shkrua kund

tjetër pos në xhami.

Nga kjo kuptojmë se gjatë historisë xhamia shërbeu si objekt fetar, institucion shkencor, por edhe si vend për zgjidhjen e problemeve shoqërore që ne sot e quajmë parlament. Në xhami tuboheshin njerëzit për të mësuar dituri të disiplinave të ndryshme. Xhamia ishte institucioni që ofroi njerëzimit personalitete me arsimim dhe vizion të pastër. Xhamia ishte ajo që njerëzimit i dha figura të shquara fetare e udhëheqëse si: Ebu Bekrin, Omerin, Othmanin, Aliun, Bilalin, Ajshen, Ibën Abasin dhe shumë të tjerë. Kjo ishte një gjeneratë e tërë me një vizion të pastër islamik. Të gjithë këta ishin nxënës të edukatorit më të madh të historisë së njerëzimit- Muhammedit a.s. Historia asnjëherë nuk shënoi një vend apo një qendër prej nga kanë dalë dijetarë dhe emisarë të denjë dhe të ndritur, siç ishte rasti me xhaminë e Muhammedit a.s. Po nga këta nxënës të kësaj xhamie (institucioni shkencor) u përhap edhe kultura dhe qytetërimi islam

XHAMIA ZEMËR E SHOQËRISË

Për dallim nga tempujt fetarë të besimeve tjera, si në krishterizëm, hebraizëm, budizëm etj., të cilët ndërtohen larg vendbanimeve, në praktikën islame xhamitë ndërtohen sa më afër njerëzve dhe në qendër të vendbanimeve. Gjatë zhvillimit të qytetërimet Islam, çdoherë xhamitë janë ngritur në zemrën e vendbanimeve. Kjo ishte një praktikë që aplikohet nga koha e Muhammedit a.s. Ai urdhëroi që xhamia të ndërtohet në qendër të vendbanimit në Medinë. Kjo vazhdoi edhe gjatë periudhave të mëvonshme historike. Pra, karakteristikë e qyteteve islame është që në qendër të qytetit të ndërtohet xhami. Xhamia është ajo e cila ka të bëjë me njerëzit dhe me shoqërinë, prandaj ato edhe çdoherë ngriteshin në qendër të vendbanimeve, qyteteve, fshatrave, aty ku lëvizja e njerëzve është më e madhe dhe më e gjallë. Aty mund të mbahen ligjëratat të lëmive të ndryshme, tribuna shkencore, gara

në dituri të ndryshme etj. Aty afër xhamisë apo nën një kulm me xhaminë formoheshin edhe shkolla të posaçme, siç u ndërtuan në Tunizi (universiteti Zejtun, i cili po ashtu ekziston pranë xhamisë së madhe), në Kajro themelimi i xhamisë El-Ez'her, ku në kuadër të xhamisë është ndërtuar edhe universiteti ku zhvillohen edhe lëndë të ndryshme shkencore, po ashtu raste të ngjashme kemi në Bagdad, Damask, Stamboll etj.

XHAMITË DHE PËRKUJDESJA NDAJ TYRE

Allahu i Lartmadhërisëm për ndërtimin e xhamive në Kur'anin Famëlartë thotë:

"E drejta e përkujdesjes së xhamive të Allahut është vetëm e atij që i ka besuar Allahut dhe ditës së fundit e që e falë namazin, jep zeqatin e nuk i frikësohet askujt pos Allahut. Të tillët do të jenë të udhëzuarit". (Et -Teube, 18)

Kur'ani në mënyrë të thuktë tregon dhe e ndërlihd ndërtimin e xhamive së bashku me besimin në Allahun, besimin në Ditën e Fundit, faljen e namazit, dhënien e zeqatit dhe frikën vetëm nga Allahu.

Përkujdesja ndaj xhamive mund të jetë në disa mënyra, siç është nisma për ndërtimin e tyre, organizimi i punës, pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në ndërtim, ndihma materiale, morale etj.

Në një rast Muhammedi a.s. ka thënë: *"Ndërtesat me të dashura për Allahun janë xhamitë"*.

Në fund të theksojmë së besimtari çdoherë duhet të jetë ai i cili preferon, nxitë dhe përkrah ndërtimin e xhamive si dhe objekteve të tjera arsimore, të cilat çdo herë do të jenë të dobishme për njerëzit. Nga kjo arsye në mbarë rruzullin tokësor u ngritën xhami dhe objekte të mëdha, të cilat i shërbyen njerëzve.

Sot, xhami të mëdha ekzistojnë edhe në qendrat më të medha të qytetërimet perëndimor siç janë në Paris, Londër, Hamburg, Vjenë, Berlin, Romë, Zagreb, Milano, Nju Jork, Uashington si dhe në qytete tjera të Amerikës, Australisë etj.



Shpërbërja e helmit



DR. MAHIR ISEINI

Alkoolizmi kronik - Kjo formë helmimi vjen pas marrjes së përsëritur të alkoolit në sasi jonormale. Prognoza e tij është e pafavorshme, sepse mund të shkojë drejt alkoolomanisë. Alkoolomania është forma më e rëndë e alkoolizmit. Alkooli për këta persona bëhet një nevojë e vërtetë. Këta alkoolikë nuk dehen menjëherë, por gjenden në ndikimin e rëndë të alkoolit.

Alkooli është helm neurotoksik, helm gastrohepatik, kardiak, duke shkaktuar dëmtime në sistemin nervor, gastrite dhe hepatit toksik. Ai është një helm për qelizën e miokardit, duke i dhënë helm miokardit. Ai vepron mbi gjëndrat e brendshme, duke shkaktuar amenore, impotencë dhe atrofi të gjëndrave. Vepron mbi metabolizmin, duke e prishur atë. Për shembull, metabolizmin e gluceideve dhe të vitaminës B dhe është bazë e polineuriteve, hepatiteve, cirozës, etj.

Eliminimi i alkoolit në sasi të vogla bëhet direkt nga pulmonet (mushkëritë) 5 % dhe nga veshkat 3 %. Eliminimi dhe oksidimi i alkoolit ngadalësohet kur ai merret sërish ose kemi insuficiencë të funksioneve të heparit. Në familjet e alkoolikëve kronikë mund të hasen dështime të shpeshta, lindje prematurë, lindje fëmije me debilitet ose epilepsi.

Rreziqet nga konsumimi i alkoolit janë të shumëfishta, fizike dhe psikike. Alkooli është helm dhe si i

atillë e ngarkon trupin tonë me detyrë të detoksikimit (shpërbërjes) të helmit-alkoolit. Ky proces kryesisht kryhet në mëlçi. Kapaciteti i mëlçisë për detoksikim është mjaft i madh, por nëse me konsumimin e alkoolit teprohet, atëherë mëlçia dëmtohet. Paraqitet sëmundja, e cila quhet cirozë e mëlçisë, e cila karakterizohet me vdekjen e qelizave normale të mëlçisë dhe me zëvendësimin e tyre me qeliza të indit lidhor, që janë të pavlefshme për funksionimin e mëlçisë. Dëmet fizike janë të pranishme në të gjitha organet, posaçërisht në tru dhe në nerva.

Ndryshimet psikike (i ashtuquajtur delirium tremens) janë tepër të rënda dhe përfshijnë ndryshime të personalitetit të alkoolikut, i cili fillon të dyshojë në çdokënd dhe në çdo gjë që përfundimisht mund të shkaktojë vrasje ose vetëvrasje nga ana e alkoolikut. Te personat e ndjeshëm, edhe sasi më të vogla të alkoolit shkaktojnë nekrozë (vdekje) të qelizave të sistemit nervor, si dhe të organeve të tjera (lukth, zorrë, mëlçi etj.). Hulumtimet bashkëkohore kanë vërtetuar se edhe sasi të më të vogla të konsumuara të alkoolit gjatë shtatzënisë mund të shkaktojnë dëmtime të rënda të frytit që gjenden në trupin e nënës. Paraqitet e ashtuquajtura "sindromë alkoolike fetale", e karakterizuar me dëmtime fizike ose psikike (ose të dyja në kombinim) të foshnjës. Vajzat janë më të rrezikuara, pasi enzima e metabolizmit të alkoolit është në sasi të

Nuk është e vërtetë se alkooli shkaktonte pasoja vetëm tek individët që e tepronë; ai shkaktonte pasoja edhe tek ata që pijnë më pak e më rrallë. Sikur nuk është e vërtetë se pasojat e alkoolit fillojnë pas konsumimit. Pasojat e çdo të lige fillojnë që nga momenti kur individ mendon të shërbehet me të, prej kur individ fillon dhe vendos të humbë kohë me të, sepse me këtë e dëmton veten, familjen, i sjell telashe edhe shoqërisë, etj.

përgjysmuar te femra, krahasuar me te mashkulli, kështu që toksikimi nga alkooli është i dyfishtë.

Një e dehur rrëfen: "Unë jam e dehur që po e marr veten. Rënia ime morale nisi kur fillova të pi. Për pak, do ta humbisja punën - 27 vjet punë, në komunë; do ta humbisja për shkak të rakisë. E humba respektin e njerëzve, sepse u bëra e papërgjegjshme. Nuk shkoja në punë, gjithnjë isha e përgjumshme. Shefja më tha se duhej të mjekohe-sha, ose do të më pushonin nga puna. Mbete pa punë, por ajo që ishte më e rëndësishme, humba dashurinë e djalit. Dua t'i dërgoj një mesazh djalit tim: nëna e tij mund të jetë e varur nga alkooli, mirëpo nuk do ta harrojë kurrë. Do të jepja edhe jetën për të; nëse ai më lë, jeta ime s'ka më kuptim. Ai është i vetmi që më jep forcë. Por, mendoj se ai po më harron".

Një vajzë e një të dehurë: "Qëkur kam kuptuar, nëna ime ka qenë e sëmurë. Kur isha fëmijë, nuk kisha nënë, nuk kisha as gjatë adoleshencës. Nëna ime ishte gjithmonë e dehur, prandaj na la dhe babai. Ishim pesë fëmijë dhe nëna na dha te të tjerët, që të na rrisnin. Ajo zgjodhi këtë mënyrë jetese dhe zgjedhja e saj ishte pija. E di që ka shumë njerëz që kanë të njëjtin problem. Dua t'ju them juve, që jeni fëmijët e tyre, që t'i doni, të mos hiqni dorë prej tyre dhe të mos ju vijë turp për ta. Ata janë të sëmurë, e nëse nuk gëzojnë dashurinë dhe përkrahjen tuaj, nuk do të shërohen

kurrë. Nënë, dua të them se të dua shumë. Edhe pse nuk kam arritur të mbështetem te ti gjatë gjithë këtyre viteve, të dua shumë. E di që dashuria ime mund të të nxjerë nga kjo gjendje. Kur nëna ime e kuptoi që vëllai im po vdiste dhe se shkak i vdekjes ishte mënyra e jetesës që kishte zgjedhur ajo, alkooli, atëherë ajo vendosi e tha: "Nëse djali im shpëton, nëse arrin të shmang këtë rrezik, do të mjekohem e s'do të pi më". Po e ndihmojmë, sepse e dimë që e ka vështirë, ka kriza, mirëpo përpiqet. Arrin të mos pi tërë ditën. I them: "Nënë, ne besojmë se edhe ne do të jetojmë si familje e vërtetë".

Nuk është e vërtetë se alkooli shkakton pasoja vetëm tek individët që e teprojnë; ai shkakton pasoja edhe tek ata që pijnë më pak e më rrallë. Sikur nuk është e vërtetë se pasojat e alkoolit fillojnë pas konsumimit. Pasojat e çdo të lige fillojnë që nga momenti kur individ i mendon të shërbehet me të, prej kur individ fillon dhe vendos të humbë kohë me të, sepse me këtë e dëmton veten, familjen, i sjell telashe edhe shoqërisë, etj. E sa i përket dhënies fund të dëmeve, këtë e di vetëm i Gjithëdijshmi. Pra, bëhet fjalë për pasoja të shumta, të llojllojshme e të rrezikshme.

Pasojat e alkoolit kryesisht nda-

hen në: shëndetësore dhe sociale.

Në shëndetin e njeriut kryesisht dëmtohen:

1. Organet e trupit (mëlçia, lukthi, enët e gjakut);
2. Sistemi nervor; dhe
3. Shëndeti psikik i njeriut.


Ç'është e vërteta, nuk mbetet gjë pa u dëmtuar. Në lidhje me këtë dr.Rizo Kapetanoviq thotë: "Mendoj që në organizëm nuk ka asnjë organ të cilin alkooli nuk e dëmton."

Meqë alkooli dëmton shëndetin, d.m.th. organizmi i njeriut nuk është i përgatitur të ushqehet me të, nuk e kërkon dhe nuk ka nevojë, pra konsumatori në fillim e dhunon organizmin e vet, futet në lojën që për një kohë të shkurtër e bën të jetë i dhunuar nga alkooli - bie në varësi. Kurse, në anën tjetër, ai shkakton pasoja në personalitetin e individit, në moral, inteligjencë dhe gjithashtu konsumatorin e pajis me cilësi të shumta negative.

Pavarësisht prej kësaj, kush me vullnet e kush pa të, kësaj rruge të rrezikshme e cila vazhdimisht ndëshkon rëndë, është duke u ecur me të madhe, rrugë kjo të cilën nëse nuk mund ta mbyllim, duhet bërë çmos që së paku ta ngushtojmë.

Mendimet bashkëkohore mbi alkoolizmin janë se kjo është një sëmundje komplekse. Alkoolizmi zakonisht zhvillohet gjatë viteve.

Shenja më e hershme e alkoolizmit mund të jetë nevoja e pacientit që alkoolin ta ketë çdo herë në afërsi: ai/ajo don që çdoherë në shtëpi ose në vendin e punës të jetë i sigurt se ka rezerva të alkoolit. Kjo ndikon fort në zgjedhjen e shoqërisë së pacientit (se me cilin do të shoqërohet alkooliku), që do të thotë se gjasat janë të mëdha që ky person të zgjedhë për shoqëri persona me shprehi të njëjta ose të ngjashme për konsumim të alkoolit. Në fillim alkooliku mund të paraqet tolerancë më të madhe për alkool, duke konsumuar (pirë) sasira më të mëdha alkooli e duke shprehur efekte më të pakta negative se të tjerët. Alkooliku fillon gradualisht të pijë gjithnjë e më tepër, duke e rrezikuar mirëqenien e vet. Alkooli bëhet më i rëndësishëm në jetë: më i rëndësishëm se familja, se obligimet e punës, se reputacioni, se shëndeti fizik. Personi e humb kontrollin mbi pirjen e alkoolit dhe bëhet gjithnjë e më i pasigurt, varësisht se sa alkool do të pijë (nëse fillon të pijë) ose a do të mund të abstenojë (të ndalë pirjen) nëse vendos ta lë atë. Mund të paraqitet varshmëri fizike, e cila shpie në konsumim të alkoolit gjatë tërë ditës, me qëllim që të evitohen efektet e pakëndshme nga abstenimi (mospirja).



Turkey is always ready to help IRCM



THE PRESIDENT MEETS DEPUTY AMBASSADOR OF SPAIN IN MACEDONIA

IRCM against discrimination

Town Square should not be taken as a division, but rather to unite people. Politics should not interfere in religious relations – it was said during the meeting of h. Sulejman ef. Rexhepi with Mrs. Maria Angeles Garcia de Lara.



This is the message that emerged after the meeting that held on 9.03.2010 (Tuesday) when IRC chairman, Reis-ul-ulemaja, h. Sulejman ef. Rexhepi, visited Spain Embassy and meet with the deputy ambassador of Spain in Skopje, Mrs. Maria Angeles Garcia de Lara.

In this very significant meeting was discussed the status of Muslims in Macedonia, development processes and interfaith relations for the last concern of the project "Skopje 2014", where the mosque Burmali have been overlooked, and for ignoring the requirements of the IRC and Skopje over the Muftinies with the mosque in the town square. Also, it was discussed for the religious objects in Prilep, Bitola and IRCM property (vakuf) in the territory of Macedonia. All what was said has stirred the souls of Muslim citizens and the situation is strained to the extent that can break even a religious conflict.

Meeting for Burmali-Mosque, Reis-ul-ulemaja, h. Sulejman ef. Rexhepi, has indicated in the table all the problems facing the Islamic spiritual institution in the country, referred to Mrs. Maria de Lara that IRC is discriminated against by the excess of central and local levels.



"Muslims in Llazhec still don't have any right to, or being allowed to build the mosque for the people of this village. Although the majority of residents are Muslim, they remain deprived of the right to have the facility to perform their religious duties and religious prayers daily. Another problem is Yeni Mosque in Bitola, the reconstruction of which is also not allowed. As absurd to be higher, Yeni Mosque continues to be the only mosque in the world that the owner it becomes the State. The constitutional right to manage the mosques in the RM

has only the Islamic Religious Community.

To be clear on this, it should be noted that the mosques in Islamic countries Section manages only vakuf and not the state. At the same time, also must be noted mosque in Prilep, which after nine years of burning remains vivid evidence of the "Crystal Night" on Islam. According to authorities, the reason is that the memories or Karpallak are still fresh, which remains as the most banal reason so far," said the head of the IRC to deputy ambassador to Spain in Skopje, Mrs. Maria de Lara. And this is

the way they do with the rest property of the IRC vakuf throughout the country. The next problem was Kapan-Ann, Suli-Ann, Ibni Pajko, etc... The biggest oddity is that the Kapan – Ann first was returns to Skopje Myftini and the same was taken with no right. Another concern, which also focused more Reis-ul-Ulema of the IRC, was the case of Burmali-Mosque, which is discriminated by the contentious project, a project that, even though the public is implemented by the municipality center, it continues to retain the seal of the Government of Gruevski. "We also have no answer why it is not part of the Detailed Urban Plan (DUP) when that mosque was known in centuries as the Balkan Beauty, said ef. Rexhepi, showing to the Mrs. Maria de Lara all the activities that IRCM has taken so far about the involvement of the Burmal-iMosque at the DUP of Municipal Center. This meeting was addressed by IRC criticized the Prime Minister Gruevski, who despite the fact that the Reis-ul-Ulema asked explicitly call a meeting of religious and political leaders, he still stays silent.

Deputy Ambassador of Spain in Skopje has expressed regret about the issues taking place in Macedonia, from the square "Skopje 2014", IRC properties in Skopje and throughout the country, then the case of religious buildings in Bitola and Prilep, which not been resolved even after so long.

"The government of R. Macedonia should fairly represent all religious communities and not make any distinction between them; much less discrimination against any one religious community, because every day the situation is tensioned and the same can have a very different future - inter-religious conflict, has advised Mrs. Maria de Lara. She also expressed her dissatisfaction with the project "Skopje 2014".

"The issue of this project is very concerned party. Town Square should not be taken as a division, but rather to unite peoples and cultures. Disagreements should be overcome through dialogue and that is the only form of communication, has mentioned Mrs. Maria de Lara after the meeting with IRCM head, h. Sulejman ef. Rexhepi, accompanied by its Secretary General, Afrim ef. Tahiri and h. Jakup ef. Selimovski.

IRCM LEADER, MEETS THE REPRESENTATIVES OF THE AMERICAN EMBASSY IN SKOPJE

We are not abandoning the Burmali Mosque

The government should take a decision to launch the reconstruction of the Burmali Mosque in Skopje Square and thus to end the Government practice of incorrect presentation of historical value and also the state to take care of all religious communities equally, was the requests that the Reis-ul-Ulema Sulejman ef. Rexhepi presented to Americans

In 09. 03. 2010 (Tuesday) the head of the IRCM held a meeting with representatives of the American Embassy in Skopje, mr. David Burger and Mrs. Jenifer Bosworth, to whom was also expressed the revolt for discriminatory policy that is practiced by the state.

American representatives expressed their views in this policy address, which, according to IRCM assessment, there are basically breaking religious and ethnic relations in Macedonia.

The government should take a decision to launch the reconstruction of the Burmali Mosque in Skopje Square and thus to end the Government practice of incorrect presentation of historical value and also the state to take care of all religious communities equally, was the requests that the Reis-ul-Ulema Sulejman ef. Rexhepi presented to Americans.

IRC Chairman Sulejman ef. Rexhepi, suggested to the U.S. Embassy in Skopje that the Prime Minister Nikola Gruevski has sought to organize a meeting of party leaders in the country, with the aim of lessening the religious tensions that have been risen recently. The meeting, according to IRCM head would be the only way to avoid escalation of interethnic and inter-religious relations in Macedonia.

"However - said Rexhepi, today we have nothing concrete from the Government and political parties".

David Burger and Jenifer Bosworth applied that they are

carefully following the current situation and the various reactions that come with the introduction of these projects.

"We always wanted the same look, for the state to promote equal treatment to all religions", said the Americans, who also repeated the position of U.S. Ambassador in Skopje mr. Philip Reeker, who commented that "decisions on such projects and the use of such funds shall be taken-decided by all citizens."

While the head of the IRCM continues to meet with foreign ambassadors in the country and public dismay about the fragile situation created, in the Municipal Center Council works continue to be "five to twelve" - as in Wednesday's session was not discussed about IRC initiative to rise the Burmali Mosque in downtown Skopje. This was disclosed by the chairman of the Municipal Center, Vladimir Todorovic, who added that this old initiative will be put in the agenda in the upcoming sessions.

"Very soon will be on the agenda. Once I tried to put in, but SDUM advisers refused to accept the agenda, arguing that they were not prepared and asked for written material. I've said that you would not have written material for an initiative which will have to examine and which will have to debate. This will not be tomorrow, but certainly one of the next sessions, announced the day before Vladimir Todorovic.

ISRAELI AMBASSADOR VISITS IRCM

Peace is everyone's goal

Islamic Religious Community leader, Reis-ul-Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi, hosted the Israeli ambassador in Skopje, Mr. David Cohen, in the chairmanship of the IRCM with whom they had an official meeting. Since the Ambassador Cohen is appointed as Ambassador to Macedonia, Albania and Bosnia, well knew the circumstances of the region.

However, Reis-ul-Ulemaja H. Sulejman ef. Rexhepi made a short brief and closer announces to the latest developments in the Republic of Macedonia, bringing the common assertion that these developments have access as one religious and one nation, negatively affecting ethnic relations and religious relation in our country.

"Despite all the previous actions that are not in favor of coexistence, we as Muslim community and Islam are staying in deep thought and our belief is that multi-ethnicity and multi-confessional country should be treated as



wealth for everyone," said among others Reis-ul-Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi, who also expressed disappointment about the problems facing the Palestinian people in the Middle East, stressing out that all these problems there affect the feelings of all Muslims, because Mesxhid el Aksan is

a sanctuary mosque for all Muslims and also sought clarification from Dear Ambassador on thinking how to overcome all those problems there.

On the other hand, Ambassador David Cohen lamented the current situation in Macedonia and noted that the State he represents will always be

PRESS CONFERENCE

STOP discriminatory and Islamophobic policy

On 26.03.2010 the Muftini of IRC Skopje held a press conference for printed and electronic media at Bridgestone, at the Mihrabi place, and in front of a large number of media, the spokesman of the Muftini of IRC Skopje, mr. Skender Buzaku said:

Dear media representatives, Muftini of Skopje today is not by chance in this place, near the holy Mihrab which our predecessors have raised Islam.

However, some time before this element of Islam was plagued by anti-Islam vandalism structure arguing that they were not aware that what are they doing.

Today, the same object, even though is returned, he looks more

like a governmental "SPOMENIK" (monument) with Slavic elements, rather than actually Mihrab that was built along with the stone bridge.

On the left side of the river Vardar is vakuf (property) of Ibni Pajko for which we are still in judicial proceedings for the return of the same. But even though we have the same positive decision from the government's administrative tribunal with a deep vandalism and not respecting the court of the country, and retaken most of this land and now builds the Macedonian Philharmonic.

Few days before Prime Minister stated that "nobody has the right to build something in a foreign land, so we ask: how he gave itself the right to commence the construction of the

Macedonian Philharmonic Orchestra in the Skopje IRC Muftini vakuf?

But, in terms of building Ibni Pajko have a very controversial decision because in the same states that we just turn the first floor, while the other floors in the apartment which has not returned to us, on the grounds that they were being sold by natural persons state.

That is why we ask, what is giving to the State the legal right to sell the property and assets that are not in their belongings?

Attention, those who do experiments with Vakuf, which finds padrejtësojnë people curse and wrath of God but of men.

On the right side of the river Vardar was Burmal Mosque, now it is just in the heart and mind of the people, whose voice is facing deaf ear to the Mayor mentor whose center is the Prime Minister Gruevski.

Therefore, how could we ask the prime minister of the Old Skopje Charshia considered valuable for all

close to our country to help overcome difficulties.

However, regarding problems in the Middle East, Ambassador Cohen gave a presentation before the Reis-ul-Ulema and short history and coexistence among Jews and Muslims for centuries. Regarding the problems that the State of Israel have with the Palestinian side, Ambassador Cohen acknowledged that many issues are indeed complex and that this requires more effort to resolve the Palestinian issue, stressing that several times since the nineties onwards, many times have been close to the Peace deal, but, unfortunately, some acts of violence damaged the process. Recent State of Israel has undertaken measures to help the peace process in the Middle East, aiming to help the legitimate Palestinian government, because ultimately, the Muslim population has always been close to the Jewish population, even in the past, Islam has been the most tolerant religion toward Hebraism.

citizens of Macedonia, which are competent state bodies and institutions and support that the Municipality of Cair, to then have to ask the citizens who live outside Cair municipality, and the square of the capital called "Macedonia" to decide only the municipality of Centre-Skopje.

We are the premier daily closing Burmali Mosque, so your immediate obligation is to turn as soon as the property of IRC Muftini Skopje.

I do suggest that this is one of the penultimate steps of the IRC Muftini Skopje which make calls to say STOP discriminatory and Islamophobic policy, which shakes the foundations of multi-religious and multiethnic state.

So once again we urge you to pronounce in public for all these problems that were born as a result of your hypocritical policy. To face the truth.

MEETING REXHEPI-DAVUTOGLLU

Turkey is always ready to help IRCM

On 26.03.2010 in the presidency of the IRCM, Reis ul Ulema, H. Sulejman ef. Rexhepi held meeting with Minister of Foreign Affairs of Turkey, Mr. Ahmet Davutoglu, and informed originally with everything that is related to IRC and facing the Macedonian Muslims.

H. Sulejman ef. Rexhepi informed the Minister Davutoglu for the discrimination being exercised against the muslims from the current government and favoring the Macedonian Orthodox Church by the Prime Minister Gruevski. "We do not want the government to be eligible, but to be equal to others, the Constitution speaks to us that religion is separate from the state, while the present government favors and privileges Orthodox Church."

Rexhepi informed about the work of returning the IRCM property, religious objects in Skopje, Bitola, Prilep, East Macedonia and etc., and this is discrimination that can not be accepted as such unique cases in the World because mosques are being managed by State Macedonia. He condemned all over the project "Skopje 2014" which is overlooked Burmali Mosque and the square of Skopje called 'Makedonija' is presented as the only place to be a society that is inconsistent with constitutional norms and principles of multiculturalism. Macedonia is a multiethnic and multi-

religious country and that this character should be preserved, and policies that are contributing to the demolition exercise premier interfaith and interethnic relations in Macedonia.

IRCM Chairman Sulejman ef. Rexhepi, acknowledged the Minister Davutoglu that for the problems facing IRCM Muslims, he also informed all diplomatic choir in country. IRC is affected by current policies, this was also confirmed by the Report of U.S. Department of State.

On the other hand Minister Davutoglu expressed concern about this being the case IRC and Muslims in Macedonia, where he witnessed unfair treatment because he had visited several cities in the country, among whom he saw the closure of the Yeni mosque in Bitola, where the Minister could not been able to go inside to see this mosque. Even against all this, he "ordered that there should be social tolerance because it is the tolerance state. He also stressed that Turkey is always ready to help IRC in its legal requirements to run institutions, and its historic debt is to protect the cultural heritage of the Ottoman period."

Reis ul Ulema and Minister Davutoglu made a gift exchange. In sign of respect and honor shown by the Minister for the IRCM and all Muslims in the Macedonia, the President Rexhepi gave a framed picture of Burmali mosque.



